



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVES
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2010

P R I S H T I N Ě , Q E R S H O R 2 0 1 1

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2010

PËRMBAJTJA

Fjalë hyrëse	11
Fjala hyrëse e Guvernatorit	13
Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit	15
Struktura organizative e BQK-së	17
1. Përmbledhje ekzekutive	19
2. Mjedisi i jashtëm ekonomik	21
2.1. Ekonomia botërore	21
2.2. Evropa Juglindore	23
3. Ekonomia e Kosovës	25
3.1. Sektori real	25
3.1.1. Produkti i brendshëm bruto	25
3.1.2. Çmimet	26
3.1.3. Tregu i punës	27
3.2. Sektori fiskal	28
3.2.1. Të hyrat buxhetore	28
3.2.2. Shpenzimet buxhetore	29
3.3. Sektori financiar	30
3.3.1. Karakteristikat e përgjithshme	30
3.3.2. Sistemi bankar	31
3.3.3. Kompanitë e sigurimit	46
3.3.4. Fondet pensionale	48
3.3.5. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar	48
3.4. Sektori i jashtëm	49
3.4.1. Llogaria rrjedhëse	50
3.4.2. Llogaria kapitale dhe financiare	56
4. Mbikëqyrja e institucioneve financiare	59
4.1. Licencimi dhe metodologjia	59
4.1.1. Licencimi	59
4.1.2. Metodologjia	63
4.2. Mbikëqyrja bankare	63
4.3. Mbikëqyrja e sigurimeve	69
4.4. Mbikëqyrja e pensioneve	73
5. Shërbimet e siguruar për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun	75
5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme	75
5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive	78
5.3. Menaxhimi i mjeteve	81

5.4. Sistemi ndërbankar i pagesave-----	84
5.5. Regjistri i kredive-----	88
5.6. Aktivitetet në fushën e statistikave dhe analizave ekonomike-----	89
6. Zhvillimet e brendshme-----	92
6.1. Kontrolli i brendshëm-----	92
6.1.1 Kontrolli, implementimi i buxhetit dhe analizat operacionale-----	94
6.2. Burimet Njerëzore-----	94
6.3. Aktiviteti Ligjor i BQK-së-----	96
6.4. Menaxhimi i financave dhe i teknologjisë së informacionit-----	96
7. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar-----	98
7.1. Marrëveshjet ndërkombëtare-----	98
8. Pasqyrat financiare të BQK-së-----	101
9. Shtojca statistikore-----	141
10. Referencat-----	151

LISTA E SHKURTESAVE

AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka për Biznes
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (angl. Consumer Price Index)
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
ECB	Banka Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank)
EJL	Evropa Juglindore
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman (angl. Herfindahl-Hirschman Index)
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (angl. Imports Price Index)
KEK	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës
KMB	Komercijalna Banka
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTPL	Sigurimi i Auto-Përgjegjësisë
NLB	Nova Ljubljanska Banka
NPL	Kreditë Joperformuese (angl. Non Performing Loans)
OJSHEF	Organizata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PCB	Procredit Bank
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë-Përqindje
PPI	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (angl. Producer Price Index)
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës

RBK	Raiffeisen Bank of Kosovo
REER	Norma Reale Efektive e Këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate)
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity)
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

LISTA E FIGURAVE

1. Ndryshimi vjetor i euros ndaj SFR, GBP dhe USD	23
2. Rritja reale e PBB-së	25
3. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	26
4. Indeksi i Çmimit të Konsumit, importit, prodhimit dhe çmimet globale të ushqimit.....	27
5. Struktura e asetëve të sistemit financiar sipas sektorëve	30
6. Kërkesat neto të sektorit financiar.....	31
7. HHI për asete, kredi dhe depozita	31
8. Kontributi në rritjen e asetëve të sistemit bankar sipas kategorive	33
9. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve	34
10. Struktura e kredive	34
11. Struktura e kredive sipas industrisë	35
12. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit	35
13. Struktura e depozitave sipas sektorëve	36
14. Struktura e depozitave të afatizuara sipas maturitetit	37
15. Mesatarja lëvizëse 12 mujore e normave të interesit	38
16. Treguesit e performancës së sistemit bankar	39
17. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar	40
18. Asetet likuide	41
19. Struktura e kredive sipas klasifikimit.....	41
20. Gjithsej kreditë dhe NPL-të	42
21. NPL-të sipas sektorëve	42
22. NPL-të dhe provizionet.....	42
23. Kapitalizimi i sistemit bankar	43
24. Gjithsej kapitali i sistemit bankar	44
25. Gjithsej kapitali dhe kapitali rregullativ	44
26. Struktura e asetëve të kompanive të sigurimit	46
27. Primet e shitura dhe dëmet e paguara	47
28. Çmimi i aksionit të TKPK-së	48
29. Struktura e investimeve të Trustit	48
30. Asetet e IMF-ve	49
31. Bilanci i llogarisë rrjedhëse	50
32. Kategoritë kryesore të strukturës së eksporteve	51
33. Kategoritë kryesore të strukturës së importeve.....	51
34. Importet sipas BEC-it.....	52
35. Struktura e eksporteve sipas partnerëve tregtarë.....	52
36. Struktura e importeve sipas partnerëve tregtarë	53
37. Llogaria e shërbimeve.....	53
38. Bilanci i llogarisë së të ardhurave	54
39. Vlera e dërgesave të emigrantëve të pranuar në Kosovë	55
40. Transferet rrjedhëse	55

41. Llogaria financiare-----	56
42. Investimet e huaja direkte në Kosovë dhe rritja ekonomike në eurozonë-----	56
43. Struktura e IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik -----	57
44. Investimet e huaja direkte sipas vendit të origjinës -----	57
45. Vlera e aseteve në sistemin bankar -----	65
46. Trendi i kredive në sistemin bankar-----	65
47. Trendi i depozitave në sistemin bankar -----	66
48. Furnizimi me para të gatshme -----	75
49. Pranimi i parave të gatshme-----	75
50. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denonimeve -----	75
51. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve-----	75
52. Kartëmonedha euro të pranuar sipas denominimeve -----	76
53. Monedha euro të pranuar sipas denominimeve -----	76
54. Eksporti i parave të gatshme -----	77
55. Importi i parave të gatshme -----	77
56. Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi -----	77
57. Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar-----	77
58. Furnizimi me kartëmonedha të reja-----	77
59. Proporcioni me kartëmonedha të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara -----	77
60. Vëllimi i transaksioneve vendore ardhëse -----	79
61. Vlera e transaksioneve vendore ardhëse -----	79
62. Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse -----	79
63. Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse -----	79
64. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	80
65. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse -----	80
66. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse -----	80
67. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse -----	80
68. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së-----	80
69. Raporti i investimeve të BQK-së-----	81
70. Mesatarja mujore e ofruar nga bankat korrespondente për portfolion e BQK-së -----	81
71. Evoluimi i EONIA-së gjatë vitit -----	83
72. Numri i transaksioneve në SEKN -----	84
73. Vlera e transaksioneve në SEKN -----	84
74. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN -----	85
75. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN -----	85
76. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre-----	85
77. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre -----	85
78. Numri i kartelave të debitit -----	87
79. Numri i kartelave të kreditit-----	87
80. Numri i terminaleve ATM -----	87
81. Numri i i terminaleve POS-----	87
82. Numri i certifikatave të gjeneruara -----	88

83. Numri i kredive të raportuara në baza mujore-----	88
84. Numri i kërkimeve në baza mujore për vitin 2010-----	89
85. Numri i raporteve të detajuara -----	89
86. Struktura e kualifikimit të punonjësve të BQK-së-----	94
87. Struktura gjinore në BQK-----	95

LISTA E TABELAVE

1. Norma e rritjes së PBB-së botërore -----	21
2. Numri i institucioneve financiare-----	30
3. Rrjeti i sistemit bankar-----	32
4. Struktura e asetëve të sistemit bankar-----	33
5. Struktura e detyrimeve të sistemit bankar-----	36
6. Bilanci i suksesit -----	39
7. Rreziku i likuiditetit -----	46
8. Bilanci tregtar i Kosovës -----	51
9. Aktiviteti i licencimit të bankave, 2006-2010-----	61
10. Aktiviteti i licencimit të kompanive të sigurimit, 2006-2010 -----	61
11. Aktiviteti i licencimit të fondeve pensionale, 2006-2010 -----	61
12. Aktiviteti i regjistrimit të institucioneve mikrofinanciare dhe jo bankare financiare -----	62
13. Aktiviteti licencues i ndërmjetësuesve të sigurimit -----	62
14. Aktiviteti i regjistrimit të agjensioneve të transferit të parave -----	62
15. Aktivitetet e regjistrimit të zyrave të këmbimit të valutave-----	62
16. Ekzaminimet e institucioneve financiare gjatë vitit 2010 -----	64
17. Ekzaminimet “on-site” të zhvilluara gjatë vitit 2010 -----	69
18. Bruto primi i shkruar -----	70
19. Aktivitetet e sistemit të sigurimeve në Kosovë -----	71
20. Niveli i likuiditetit në sistemin e sigurimeve të Kosovës-----	71
21. Vlera e transaksioneve sipas llojeve kryesore të tyre -----	78
22. Vlera e transaksioneve sipas llojeve kryesore të tyre -----	88
23. Përcaktimi i fushave të auditimit në bazë të riskut për tri vitet e fundit-----	93
24. Trajnimet e ndjekura gjatë vitit 2010-----	95

Fjalë hyrëse

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që t'jua prezantoj Raportin Vjetor të vitit 2010, i cili paraqet një raport gjithpërfshirës, që përfshin zhvillimet më të rëndësishme në ekonominë e Kosovës, duke përfshirë sektorin real, fiskal, financiar dhe të jashtëm. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, sikurse edhe çdo detyrë tjetër, edhe informimit të publikut të gjerë i kushton një vëmendje të posaçme dhe pikërisht kjo është edhe arsyeja kryesore përse stafi i BQK-së hartimin e Raportin vjetor e bën me një përkushtim të veçantë, duke u munduar që për çdo vit të futen risi dhe të dhëna të reja që shpjegojnë dhe shpalosin të gjitha funksionet e rëndësishme që i kryen ajo. Edhe Raporti Vjetor i viti 2010 ka risi në krahasim me raportin e vitit të kaluar dhe gjithashtu ka edhe më shumë të dhëna, që janë konsideruar se janë të rëndësishme për publikun e gjerë.

Në vitin 2010 ekonomia botërore shënoi një rritje vjetore prej rreth 5%, që tejkaloi parashikimet paraprake të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ndërsa kjo rritje në radhë të parë ishte si rezultat i rritjes ekonomike në SHBA dhe Japoni, rritjes së prodhimit industrial, stabilizimit të tregjeve financiare dhe rritjes së vëllimit të tregtisë botërore.

Në vendet e Evropës Juglindore në vitin 2010 fillojnë të vërehen shenjat e para të këndelljes, edhe pse aktiviteti ekonomik ishte ende i brishtë dhe i pabalancuar në mes të vendeve të EJJL-së. Në vitin 2010 në këto vende vërehet rritje e eksporteve, pas rënies drastike që u shënuar në vitin 2009 dhe si rezultat i kësaj, të gjitha vendet e EJJL-së shënuar rënie të deficitit tregtar, gjë që shkaktoi edhe rënie të deficitit në llogarinë rrjedhëse, përpos Kosovës.

Ekonomia e Kosovës në vitin 2010 shënoi rritje reale të Produktit të Brendshëm Bruto prej 4.0%, ndërsa vlera nominale e PBB-së ishte 4.2 miliardë euro. Për dallim nga viti 2009, kur rritja ishte realizuar kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve publike dhe rënies së çmimeve, në vitin 2010 rritja ishte si rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve në sektorin privat. Gjatë vitit 2010 u shënuar një rritje mesatare e çmimeve prej 3.5%, që ishte kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore.

Problem serioz për Kosovën edhe në vitin 2010 vazhdon të mbetet niveli i lartë i papunësisë, që vlerësohet rreth 45%, natyrisht këtu duhet marr parasysh edhe faktin se një përqindje e popullsisë në moshë të punës nuk hyn fare në tregun e punës. Natyrisht se këtu duhet pasur parasysh edhe nivelin mjaft të lartë të pjesëmarrjes së sektorit joformal, kështuqë megjithatë kjo përqindje duhet të jetë më e vogël. Këtë problem e vështirëson edhe më tepër struktura e re e moshës së popullsisë së Kosovës, pasi që një numër i punëkërkuesve të rinj për çdo vit i shtohet Kosovës, ndërsa numri i vendeve të reja të punës që krijohet brenda një viti është i ulët.

Sektori financiar i Kosovës nuk vazhdoi me rritje sikurse vitet e mëparshme, kryesisht për shkak të rritjes më të ngadalshme të sistemit bankar, që ka pjesëmarrjen më të madhe në kuadër të sektorit financiar. Rritja e aseteve të bankave ishte rreth 11%, kryesisht si rezultat i kreditimit dhe investimeve në letra me vlerë. Ngadalësimi i kredidhënies nga ana e bankave ka ndikuar që bankat ta orientojnë një pjesë të investimeve jashtë vendit, kryesisht në letra me vlerë. Rritja e investimeve në letra me vlerë ishte edhe rezultat i rimëkëmbjes së tregjeve financiare ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe. Në strukturën e kredive dominuan kreditë për ndërmarrjet (mbi 70%), kurse në kuadër të ndërmarrjeve pjesa më e madhe e kredive u shfrytëzua nga ndërmarrjet tregtare (mbi 50%).

Gjatë vitit 2010 pati një rritje të depozitave në krahasim me vitin 2009 (rritja vjetore 11%), por megjithatë më të ngadalshme se në vitin paraprak. Në strukturën e depozitave

dominojnë depozitat e ekonomive familjare me mbi 67% (rritja prej 7% në krahasim me vitin paraprak), ndërsa depozitat e ndërmarrjeve kishin pjesëmarrjen prej 27 %.

Përkundër sfidave me të cilat u ballafaqua Banka Qendrore e Kosovës, ajo arriti të ruajë stabilitetin financiar të vendit dhe ishte si gjithmonë proaktive në marrjen e masave të shumta për të siguruar stabilitetin financiar. Edhe gjatë vitit 2010 është rritur shpeshtësia e raportimit në vend (on-site) dhe jashtë (off-site), në mënyrë që të përcillen nga afër të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë dhe duke e përmbushur kështu edhe njërin nga funksionet më të rëndësishme të BQK-së- ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit.



Prof.Dr.Gazmend Luboteni

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore

Fjala hyrëse e Guvernatorit

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2010 vazhdoi të shënojë rritje, mbështetur kryesisht në rritjen e konsumit dhe të investimeve. Përmirësimet në ekonominë globale patën ndikim të rëndësishëm në rritjen e eksporteve të Kosovës dhe të dërgesave nga emigrantët. Presionet inflacioniste në rrafshin global u reflektuan edhe në ekonominë e Kosovës, si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë sonë nga importet. Pavarësisht rritjes së eksporteve, deficitit tregtar vazhdon të mbetet tepër i lartë gjë që shtron nevojën për gjetjen e një modeli më të qëndrueshëm të rritjes dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Sektori financiar i vendit vazhdoi me trendin e rritjes. Treguesit kryesorë të shëndetshmërisë financiare flasin për një qëndrueshmëri të lartë të sistemit bankar në Kosovë. Duke arritur në 59.7 përqind të PBB-së, asetet e sistemit bankar ishin ndër kontribuuesit kryesor në financimin e konsumit dhe të investimeve në vend. Ndonëse ende e lartë, shkalla e koncentrimit të sistemit bankar vazhdoi me trendin e saj rënës. Në të njëjtën kohë, industria e sigurimeve u karakterizua zvogëlim të tarifave për policat kufitare si dhe ngritje të shkallës së kompensimit të dëmeve. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës shënoi rritje të çmimit për njësi të aksioneve si dhe kthim më të mirë nga investimet. Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e financave janë bërë hapa konkret drejt krijimit të infrastrukturës moderne për tregun e letrave me vlerë.

Krahas sigurimit të stabilitetit të sektorit financiar, BQK-ja vazhdoi me ngritjen e cilësisë së shërbimeve të saja për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun. Është rritur cilësia e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha euro, ndërsa është bërë elektronizimi i plotë i urdhërpagesave për klientët kryesorë të BQK-së. Gjithashtu, është rritur vëllimi dhe vlera e pagesave ndërbankare, ndërsa është funksionalizuar Këshilli Kombëtar i Pagesave. Investimi i mjeteve të BQK-së është bërë në suaza të sigurisë së lartë, likuiditetit të mjaftueshëm dhe kthimit të arsyeshëm në investime. Në kuadër të projektit për zhvillimin e mjedisit afarist, Regjistri i kredive ka filluar me projektin e avancimit të informacionit kreditor gjë që pritet të rezultojë me reduktim të rrezikut kreditor dhe rrjedhimisht edhe të normave të kamatave në kredi.

Në vitin 2010, Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin e ri mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me çka janë shtuar detyrat dhe përgjegjësitë e BQK-së në sigurimin e stabilitetit financiar dhe atij makroekonomik në vendin tonë. Gjithashtu, ky vit përshkohet edhe me aprovimin e ligjit mbi sistemin e sigurimit të depozitave si dhe inicimin e plotësimeve dhe përpilimit të ligjeve tjera me rëndësi për sektorin financiar (ligji mbi bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, ligji mbi sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, ligji mbi sistemin e pagesave, etj.) të cilat pritet të aprovohen në vitin 2011. Ky avancimi i kornizës ligjore të sektorit financiar është në linjë me përpjekjet për përmirësimin e mjedisit afarist dhe gjenerimin e investimeve të reja si nga investitorë të jashtëm ashtu edhe të brendshëm.

Në fushën e statistikave, është filluar për herë të parë me raportim të statistikave të bilancit të pagesave në FMN në baza tremujore, ndërsa në fushën e analizave ekonomike e financiare duhet veçuar përpilimin e 'stres testit' për sistemin bankar, përpilimin mujor të indikatorëve të paralajmërimit të hershëm dhe përpilimin dhe publikimin e numrit të parë të Raportit të Stabilitetit Financiar për Kosovën. Puna kërkimore e punonjësve të BQK-së u shpërblye për herë të dytë me çmimin prestigjioz "Olga Radzyner" për hulumtuesit e rinj. Të gjitha këto flasin për kompetencë të lartë të punonjësve të BQK-së në komunikimin e punës sonë para institucioneve dhe publikut vendor dhe ndërkombëtar.

Nisur nga fakti se BQK-ja kryesisht reflekton punonjësit e saj, menaxhmenti do të vazhdojë të mbështes fuqishëm dedikimin dhe nivelin e lartë të kompetencës së punonjësve të cilët, krahas Bordit të BQK-së dhe Bordit ekzekutiv, patën rol kyç në sigurimin e punës cilësore dhe efikase madje edhe në kushtet e krizës menaxheriale nëpër të cilën kaloi BQK-ja gjatë vitit 2010.

Unë falënderoj të gjithë punonjësit e BQK-së për kontributin e tyre të çmuar gjatë vitit 2010. Pikërisht ky dedikim është ai që më bën edhe më të sigurt se bashkarisht do të menaxhojmë me sukses sfidat që i kemi përpara.



Gani Gërguri

Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit

Bordi i Bankës Qendrore

Sipas Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore janë: Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori.

Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga Guvernatori, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit në përputhje me nenin 79, paragrafi 2 të Ligjit për BQK-në dhe tre (3) anëtarë joekzekutivë, ndërsa kompetencat dhe detyrat e këtij Bordi janë të definuara me nenin 35 të Ligjit për BQK-në. Më 31 dhjetor të vitit 2010, Bordi i Bankës Qendrore përbëhej nga këta anëtarë:

Gazmend Luboteni, kryetar i Bordit të Bankës Qendrore

Lulzim Ismajli, Drejtor i Thesarit (anëtar i Bordit të Bankës Qendrore)

Sejdi Rexhepi, anëtar i Bordit të Bankës Qendrore

Mejdi Bektashi, anëtar i Bordit të Bankës Qendrore.

Prej datës 26 korrik 2010, Gani Gërguri, zëvendësguvernator për funksione bankare qendrore, shërben në cilësinë e ushtruesit të detyrës së Guvernatorit.

Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Guvernatori, i cili është kryesues, si dhe nga zëvendësguvernatorët dhe është i ngarkuar me zbatimin e politikave të Bankës Qendrore dhe të operacioneve të saj. Më 31 dhjetor të vitit 2010, Bordi Ekzekutiv përbëhej nga këta anëtarë:

Z. Gani Gërguri, zëvendësguvernator për funksione bankare qendrore dhe u.d Guvernator prej 26 korrik 2010.


Z. Nexhat Kryeziu, zëvendësguvernator për mbikëqyrje të institucioneve financiare.

Komiteti i auditimit emërohet nga Bordi i Bankës Qendrore në përbërje prej tre anëtarësh: dy anëtarë joekzekutivë të zgjedhur nga radhët e Bordit të Bankës Qendrore dhe një anëtar ekspert i jashtëm kompetent në fushën e kontabilitetit ose të auditimit. Më 31 dhjetor të vitit 2010, Komiteti i Auditimit përbëhej nga këta anëtarë:

Gazmend Luboteni, kryetar i Bordit të Bankës Qendrore.

Sejdi Rexhepi, anëtar i Bordit të Bankës Qendrore.

Struktura organizative e BQK-së: 31 dhjetor 2010



1. Përmbledhje ekzekutive

Viti 2010 mund të konsiderohet si vit i përmirësimit të ekonomisë globale, gjë që reflekton efektin pozitiv që kishin intervenimet financiare të institucioneve të vendeve të prekura nga kriza për tejkalimin e pasojave të krizës globale. Ekonomia globale në vitin 2010 shënoi një normë reale të rritjes prej 5.0 përqind. Përmirësimi i performancës së ekonomisë u reflektua edhe në aktivitetin tregtar i cili në nivel global shënoi normë të rritjes prej 11.4 përqind, krahasuar me rënien prej 11.0 përqind në vitin 2009. Si rezultat i këtyre përmirësimeve, kryesisht të gjeneruara nga vendet në zhvillim, edhe ekonomitë e vendeve të Evropës Juglindore (EJL) shfaqën shenjat e para të përmirësimit, por problematike për këto vende (EJL) vazhdon të jetë kërkesa e brendshme e cila nuk ka treguar shenja solide të rikuperimit, gjë që mund të pengojë rritjen e qëndrueshme ekonomike për këto vende.

Ekonomia e Kosovës vazhdoi të ketë normë pozitive të rritjes ekonomike edhe gjatë vitit 2010. Vlerësimet tregojnë për një rritje reale të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) prej 4.6 përqind në vitin 2010, ndërsa, për dallim prej vitit 2009, kur gjeneratori kryesor i rritjes ishte sektori publik, gjatë vitit të kaluar sektori privat konsiderohet të ketë qenë kontribuuesi kryesor në rritjen ekonomike. Norma mesatare e inflacionit në vitin 2010 ishte 3.5 përqind, ndërsa presionet inflacioniste ishin më të theksuara në pjesën e dytë të vitit 2010. Sikur edhe në vitet e kaluara, inflacioni në Kosovë ishte kryesisht rezultat i rritjes së çmimeve për produktet ushqimore, të cilat kanë shënuar rritje në nivel global dhe, si rezultat i mbështetjes së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe, ngritja e çmimeve në nivel global është reflektuar mjaft shumë edhe në ekonominë e Kosovës.

Sektori financiar i Kosovës vazhdoi me stabilitet dhe rritje edhe gjatë vitit 2010. Vlera e asetëve të këtij sektori në vitin 2010 arriti në 3.2 miliardë euro, që paraqet një normë të rritjes prej 13.7 përqind krahasuar me vitin 2009. Asetet e sistemit bankar vazhdojnë të përfaqësojnë pjesën më të madhe të sektorit financiar, me një pjesëmarrje prej 77 përqind në gjithsej asetet e këtij sektori, ndërsa fondet pensionale, me pjesëmarrje prej mbi 15 përqind në gjithsej asetet e sektorit financiar, përfaqësojnë sistemin e dytë financiar për nga pjesëmarrja në gjithsej asetet e sektorit financiar. Depozitat dhe kreditë, si komponentët kryesorë të bilancit të gjendjes së sistemit bankar, gjatë vitit 2010 shënuan normë të rritjes prej 11.0 përqind përkatësisht 13.2 përqind. Rritja e kredive gjatë vitit 2010 ishte më e lartë se sa në vitin 2009, ndërsa norma e rritjes së depozitave u ngadalësua. Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të ketë shkallë të lartë të koncentrimin të tregut, ku tri bankat më të mëdha menaxhojnë 77.4 përqind të gjithsej asetëve të sistemit bankar. Sidoqoftë, shkalla e koncentrimin në tregun bankar vazhdon të ndjekë trend rënës. Sistemi bankar i Kosovës edhe në vitin 2010 kishte nivel të lartë të qëndrueshmërisë, me tregues të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 18.7 përqind. Gjatë këtij viti, pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë e sistemit bankar shënoi rritje, duke arritur në 5.9 përqind. Megjithatë, shkalla e mbulimit të kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë vazhdon të jetë e lartë.

Bilanci i pagesave vazhdon të karakterizohet me deficit të lartë në llogarinë rrjedhëse, ndërsa, llogaria kapitale dhe financiare vazhduan të kenë bilanc pozitiv. Raporti ndërmjet deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe PBB-së, në vitin 2010, ishte 16.6 përqind, që paraqet nivel relativisht të ngjashëm me vitin 2009. Niveli i lartë i deficitit tregtar (45.8 përqind e PBB-së) paraqet shkaktarin kryesor të deficitit të llogarisë rrjedhëse në Kosovë. Në vitin 2010, ekonomia e Kosovës shënoi një rritje të eksporteve prej 77.8 përqind, përderisa importet u rritën me 10.8 përqind. Mirëpo, pesha më e lartë e importeve në gjithsej vlerën e mallrave të tregtuara bëri që deficitin tregtar në vitin 2010 të thellohet, përkundër rritjes më të theksuar të eksporteve. Sidoqoftë, rritja më e lartë e eksporteve gjatë kësaj periudhe

ndikoi në rritjen e shkallës së mbulueshmërisë së importeve me eksporte në 13.7 përqind. Bilanci pozitiv në llogarinë e të ardhurave dhe transfereve rrjedhëse ka vazhduar të kontribuojë në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në kuadër të llogarisë kapitale dhe financiare, u regjistrua një rritje më e theksuar në kategorinë e “investimeve tjera”, përdërisa rritje shënuan edhe investimet e huaja direkte.

BQK-ja ka vazhduar së zbatuari praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e licencimit, rregullativës dhe mbikëqyrjes së institucioneve financiare. Në këtë kontekst janë bërë investime të theksuara drejt avancimit të mbikëqyrjes së bazuar në profilin e rrezikut në sektorin financiar si dhe është shtuar shkalla e bashkëpunimit me bankat qendrore dhe autoritetet përkatëse mbikëqyrëse të vendeve si Turqia, Gjermania, Austria, Sllovenia, Mali i Zi, etj.

Në lëmin e funksioneve tradicionale të bankës qendrore, BQK-ja me një sukses të theksuar ka kryer rolin e saj të agjentit fiskal dhe të bankierit të qeverisë, duke avancuar proceset që kanë të bëjë me transaksionet e llogarive, menaxhimin e mjeteve financiare, sistemet ndërbankare të pagesave dhe furnizimin e ekonomisë në kohë dhe me denominime adekuate të kartëmonedhave dhe monedhave në euro. Në kuadër të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN), gjatë vitit 2010, u shënuar rritje e konsiderueshme si në vëllim ashtu edhe në vlerë të transaksioneve të pagesave.. Rreth 3.9 milionë transaksione me një vlerë të përgjithshme prej 4.66 miliardë euro u kanalizuan përmes SEKN-së gjatë vitit 2010.

Gjithashtu, gjatë vitit 2010, në bashkëpunim me USAID-in janë bërë përgatitjet për avancimin e mëtejshëm të regjistrimit të kredive me qëllim të reduktimit të asimetrisë së informacionit në fushën e kredidhënies.

Siguria e mjeteve mbetet shtylla kryesore në Politikën e Investimeve të BQK-së. Falë analizës së kujdesshme të profilit të rrezikut të institucioneve dhe vendeve me të cilat janë investuar mjetet në bilancin e BQK-së është siguruar jo vetëm likuiditeti i duhur, por edhe kthim i arsyeshëm nga mjetet e investuara. Krahas Thesarit, në vitin 2010 është arritur marrëveshje për investime me maturitete të caktuara edhe me depozitorë tjerë të mëdhenj të BQK-së. Komiteti i investimeve i BQK-së si dhe ai i likuiditetit i përbashkët me Thesarin kanë vlerësuar rregullisht bankat korrespondente me qëllim të sigurimit të plotësisht të kriterëve të kërkuara me politikën e investimeve të BQK-së.

Krahas auditimit standard të paraparë me planin vjetor të Shefit të Auditimit të Brendshëm (ShAB), në vitin 2010 janë bërë edhe raporte të veçanta mbi ecuritë e investimeve si në tregun e parasë ashtu edhe në atë të letrave me vlerë. Gjithashtu, sipas aranzhmanit “Stand-By” janë audituar rregullisht llogaritë qeveritare të mbajtura në BQK si dhe është zgjeruar spektri auditues edhe në fushën e mbikëqyrjes financiare dhe atë të teknologjisë së informacionit.

2. Mjedisi i jashtëm ekonomik¹

2.1. Ekonomia botërore

Sipas vlerësimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), ekonomia botërore shënoi një rritje vjetore prej 5 përqind në vitin 2010 (Tabela 1). Rritja e realizuar tejkalon për 0.75 pikë-përqindje (pp) parashikimet paraprake të FMN-së (mesi i vitit 2010). Ky ndryshim kryesisht ishte rezultat i ndikimit pozitiv që patën rritja ekonomike në SHBA dhe Japoni, rritje kjo në masë të madhe si rezultat i nivelit më të lartë të konsumit të brendshëm gjatë tremujorit të katërt të vitit 2010. Ndikim pozitiv në rritjen e ekonomisë globale kishte edhe rritja e prodhimit industrial, stabilizimi i tregjeve financiare si dhe rritja e vëllimit tregtar në nivel botëror. Mirëpo, rikuperimi i ekonomisë botërore vlerësohet të mos ketë qenë i balancuar, duke marrë për bazë intensitetin dhe shtrirjen gjeografike, ku vendet në zhvillim vazhdojnë të karakterizohen me ritme më të larta të rritjes ekonomike në krahasim me vendet e zhvilluara.

Sipas vlerësimeve të FMN-së, në vitin 2010 rritja ekonomike për vendet e zhvilluara arriti në 3 përqind. SHBA-të shënuan një rritje ekonomike prej 2.8 përqind, që kryesisht rezultoi nga rritja e konsumit të brendshëm dhe kontributi pozitiv i tregtisë, pasi që eksportet vazhduan të rriten më shpejtë se sa importet. Rritje të PBB-së në vitin 2010 shënoi edhe Eurozona në shkallë 1.7 përqind, përkundër problemeve të shumta buxhetore në disa nga vendet anëtare. Në kuadër të vendeve të zhvilluara, Japonia me një normë prej 3.9 përqind shënoi rritjen më të lartë ekonomike në vitin 2010. Përmirësimi i aktivitetit ekonomik në vendet e zhvilluara kryesisht është mbështetur në rritjen e investimeve, eksporteve dhe konsumit të brendshëm.

Tabela 1. Norma e rritjes së PBB-së botërore, në përqindje

Përshkrimi	2009	2010	2011*
PBB-ja botërore	-0.5	5.0	4.4
Vendet e zhvilluara	-3.4	3.0	2.4
SHBA	-2.6	2.8	2.8
Eurozona	-4.1	1.7	1.6
Japonia	-6.3	3.9	1.4
Mbretëria e Bashkuar	-4.9	1.3	1.7
Vendet në zhvillim	2.7	7.3	6.5
Rusia	-7.8	4.0	4.8
Kina	9.2	10.3	9.6
India	6.8	10.4	8.2

Burimi: FMN (2011)

* Parashikimet

Sa i përket vendeve në zhvillim, rritja ekonomike vazhdon të jetë më e fuqishme. Për vitin 2010, sipas FMN-së ekonomitë e vendeve në zhvillim u rritën mesatarisht për 7.3 përqind, ku vendet aziatike dhe disa nga vendet e Afrikës së mesme dhe jugore prijnë me norma më të larta të rritjes ekonomike. Rritjen më të lartë e regjistroi India (10.4 përqind), pasuar nga Kina me 10.3 përqind. Rritja ekonomike në këto vende në vazhdimësi është mbështetur

¹ Zhvillimet në ekonominë botërore dhe Evropën Juglindore janë të bazuara në publikimet: Business Monitor International (2010), ECB (2010), European Commission (2010), (2011), Eurostat (2010), IMF (2010), (2011) dhe World Bank (2010).

nga politikat ekonomike stimuluese monetare dhe fiskale, niveli i lartë i konsumit të brendshëm dhe hyrja e kapitalit nga jashtë.

Gjatë vitit 2010, politikat fiskale sidomos në vendet e zhvilluara, ishin të orientuara në konsolidimin e shpenzimeve buxhetore, të cilat shënuan rritje rekorde si rezultat i përpjekjeve për të sanuar dhe parandaluar krizën financiare. Përkeqësimi i financave publike ishte më i theksuar në Eurozonë, ku disa prej vendeve anëtare po përballen me norma të larta të deficitit buxhetor.

Vendet si Irlanda dhe Greqia, në pamundësi për të rifinancuar borxhin publik u detyruan të kërkojnë ndihmë nga vendet tjera si dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare. Në kuadër të përpjekjeve për parandalimin e thellimit të krizës buxhetore, në maj të vitit 2010, vendet e BE-së u përcaktuan për themelimin e Mekanizmit për Stabilitetin Financiar Evropian. Në mënyrë që ky mekanizëm të jetë funksional, vendet e BE-së, Banka Qendrore Evropiane (BQE) dhe FMN-ja ndanë një shumë prej 750 miliardë euro, të destinuara për tejkalimin e krizave të mundshme buxhetore. Po ashtu, shumica e vendeve anëtare të Eurozonës kanë filluar reformat e thella fiskale duke e bazuar konsolidimin fiskal në dy rrafshë: zvogëlimin e shpenzimeve buxhetore ose një balancim në mes të zvogëlimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve. Sidoqoftë, konsolidimi fiskal në disa nga vendet e Eurozonës përmes zvogëlimit të shpejtë të shpenzimeve qeveritare mund të sjellë pasoja tjera për ekonominë e këtyre vendeve, duke ngadalësuar rritjen ekonomike dhe duke rritur papunësinë.

Spektori financiar në nivel global vazhdoi të shënojë rezultate pozitive gjatë vitit 2010, me një mbështetje të theksuar nga politikat monetare ekspansioniste. Aktiviteti i bursave gjatë këtij viti u karakterizua me trend rritës dhe po ashtu kreditimi si në sektorin financiar ashtu edhe në sektorin real vazhdoi të shënojë rritje edhe pse me norma më të ulëta në krahasim me periudhën para shfaqjes së krizës financiare. Mirëpo, problemet e vendeve të Eurozonës me borxhin publik ndikuan në rritjen e pasigurisë së investitorëve në tregjet financiare. Normat e larta të deficitit buxhetor në disa nga vendet e Eurozonës kanë ndikuar negativisht në rangimin kreditor të këtyre vendeve dhe, si rrjedhojë risku i primeve për fletëobligacionet dhe garancionet e fletëobligacioneve (*angl. Credit Default Swaps: CDS*) shënoi rritje të konsiderueshme. Primet për fletëobligacionet e vendeve si Irlanda dhe Greqia ishin deri në 5 pp më të larta sesa ato të Gjermanisë që karakterizohen me nivelin më të ulët të riskut. Veç kësaj, për të stabilizuar dhe kthyer besimin në tregjet financiare, në maj të vitit 2010, BQE-ja vendosi për herë të parë në historinë e saj të intervenojë në tregjet e fletëobligacioneve, duke blerë fletëobligacione shtetërore dhe private me qëllim që të ndikojë në zvogëlimin e kostos së borxhit dhe rritjen e likuiditetit në treg. Ky veprim i BQE-së u prit me mjaft optimizëm nga investitorët sepse duke neutralizuar turbulencat që kishin kapluar tregjet evropiane, këto masa ndikuan që tronditjet financiare të kishin ndikim më të kufizuar.

Norma bazë e interesit në Eurozonë vazhdoi të jetë 1.0 përqind, nivel ky i caktuar në maj të vitit 2009, kur BQE vendosi të zvogëlojë këtë normë nga niveli prej 2.0 përqind sa ishte para fillimit të krizës. Gjithashtu, norma marginale e huadhënies dhe depozitave mbeti e pandryshuar në 1.75 përkatësisht 0.25 përqind.

Të pandryshuara mbetën po ashtu normat e financimit të vendosura nga Rezerva Federale e SHBA-ve, të cilat vazhduan të qëndrojnë në intervalin 0.00 - 0.25 përqind. Ndërsa, normat e interesit në tregun ndërbankar gjatë vitit 2010 shënuan rritje, ku mund të veçohet EURIBOR tremujor që arriti në 1.02 përqind (0.712 përqind në dhjetor 2009) dhe LIBOR tremujor që arriti në 0.749 përqind (0.605 përqind në dhjetor 2009).

Në fund të vitit 2010, norma vjetore e rritjes së indeksit të çmimeve në SHBA ishte 1.5 përqind, ndërsa bazuar në të dhënat e publikuara nga EUROSTAT-i, në dhjetor 2010, norma vjetore e rritjes së indeksit të çmimeve për eurozonën ishte 2.2 përqind.

Për sa i përket performancës së tregjeve financiare, bursat në SHBA dhe Japoni u karakterizuan me rritje të performancës. Në

dhjetor 2010, indeksi i tregjeve të aksioneve në SHBA (*Standard&Poor's 500*) dhe ai japonez (*Nikkei 225 Stock Average Index*) shënuan ngritje prej 11.8 përkatësisht 0.84 përqind krahasuar me dhjetor 2009. Ndërsa, indeksi i tregjeve të aksioneve që përfshinë bursat evropiane (*Dow Jones Euro Stoxx*) shënoi rënie prej 2.82 përqind në krahasim me dhjetor 2009.


Në fund të vitit 2010, krahasuar me vitin paraprak, euro shënoi zhvlerësim të theksuar kundrejt valutave kryesore globale (Figura 1). Norma e këmbimit me dollarin amerikan dhe funtën britanike shënoi një zhvlerësim vjetor prej 9.5 përqind (në 1.322 USD/EUR) përkatësisht 5.7 përqind (në 0.848 GBP/EUR). Ndërsa, rënien më të theksuar në vitin 2010 euro e regjistroi kundrejt frankës zvicerane, duke u zhvlerësuar për 14.7 përqind (në 1.281 SFR/EUR).

2.2. Evropa Juglindore

Dy vjet pas fillimit të krizës globale financiare, vendet e Evropës Juglindore² kanë filluar të shfaqin shenjat e para të rikuperimit të aktivitetit ekonomik. Sidoqoftë, duhet të theksohet se përmirësimi i aktivitetit ekonomik ende është i brishtë dhe nuk është i balancuar në mes të vendeve të EJL-së. Përmirësimi i ekonomisë globale gjatë vitit 2010, posaçërisht rikuperimi i ekonomive të vendeve të BE-së, rezultoi në rritje të eksporteve për vendet e EJL-së. Megjithatë, këto ekonomi vazhdojnë të përballen me nivele më të ulëta të kërkesës së brendshme krahasuar me periudhën para krizës, gjë që është reflektuar në rritjen e papunësisë si dhe aplikimin e politikave më konservative në kredidhënie nga ana e bankave. Gjatë vitit 2010, shumica e vendeve të EJL-së raportuan rritje pozitive të PBB-së dhe sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian, rritja mesatare e PBB-së për gjithë rajonin ishte 1.7 përqind.

Në vitin 2010, eksportet e vendeve të EJL-së filluan të këndellen nga rënia drastike që përjetuan gjatë vitit 2009. Rritja e konsumit të brendshëm posaçërisht në vendet e BE-së, të cilët janë partnerët kryesorë tregtar për vendet e rajonit, ndikoi që shumica e këtyre vendeve të raportojnë rritje dyshifrore të eksporteve. Si rezultat, të gjitha vendet e EJL-së, përveç Kosovës, raportuan rënie të deficitit tregtar, që shkaktoi edhe rënie të deficitit të llogarisë rrjedhëse.

Figura 1. Ndryshimi vjetor i euros ndaj SFR, GBP dhe USD



Burimi: BQE (2011)

² Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Rumania, Serbia dhe Shqipëria.

Gjatë vitit 2010, të gjitha vendet e EJJ-së raportuan bilanc negativ buxhetor. Sidoqoftë, raporti ndërmjet deficitit buxhetor dhe PBB-së shënoi rritje vetëm në Serbi, duke arritur në 4.5 përqind (4.3 përqind në 2009) dhe në Kroaci 5.7 përqind (4.1 përqind në 2009).

Vendet tjera, me masat e ndërmarra për të konsoliduar sektorin fiskal, arritën me sukses të zvogëlojnë deficitin buxhetor. Gjatë vitit 2010, vendet si Kosova, Bosnja e Hercegovina, Serbia dhe Rumania nënshkruan marrëveshje me FMN-në për të siguruar mbështetje financiare. Veç kësaj, në vitin 2010, Shqipëria dhe Serbia emetuan letra me vlerë për të financuar buxhetin në vlerë prej 300 përkatësisht 199 milionë euro. Borxhi publik në vendet e EJJ-së shënoi rritje në vitin 2010, duke arritur normën mesatare prej 43 përqind nga 41 përqind e PBB-së sa ishte në vitin 2009. Nivelin më të lartë të borxhit publik në vitin 2010 e kishte Shqipëria, me një normë prej 61.9 përqind të PBB-së (60.6 përqind në 2009), pasuar nga Mali i Zi me 49.4 përqind (43.5 përqind në 2009) dhe Bosnja e Hercegovina me 43 përqind të PBB-së (39.1 përqind në 2009).

Efektet e krizës financiare si dhe rënia ekonomike në vendet e EJJ-së gjatë vitit 2009 ndikuan mjaft shumë në rritjen e papunësisë, e cila vazhdoi të ketë nivel të ngjashëm edhe gjatë vitit 2010. Prej vendeve me normën më të lartë të papunësisë mund të veçojmë Kosovën (rreth 45 përqind), Bosnjën e Hercegovinën (rreth 43.2 përqind) dhe Maqedoninë (rreth 31.7 përqind).

Për sa i përket valutave të vendeve të EJJ-së, leku shqiptar u zhvlerësua kundrejt euros për 1.2 përqind, duke arritur në 138.8 ALL/EUR, ndërsa dinari serb u zhvlerësua ndaj euros për 10.6 përqind duke arritur në 106.7 RSD/EUR. Kuna kroate (7.39 HKR/EUR) dhe denari maqedon (61.5 MKD/EUR) gjatë kësaj periudhe ishin më stabile ndaj euros.

3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Sektori real

Ekonomia e Kosovës vazhdoi me trendin rritës edhe gjatë vitit 2010, duke shënuar një normë reale të rritjes më të lartë se sa në vitin 2009. Përmirësimi i performancës së ekonomisë globale në vitin 2010 u reflektua edhe në ekonominë e Kosovës, duke ndikuar që sektori privat të jetë bartësi kryesor i rritjes ekonomike. Sistemi bankar i Kosovës kishte rol mjaft të rëndësishëm për financimin e konsumit dhe investimeve në vend. Një tjetër kontribuues mjaft i


rëndësishëm për financimin e konsumit në vend ishin edhe dërgesat e emigrantëve, të cilat po ashtu shënuan rritje si rezultat i përmirësimeve në ekonominë e zhvilluara. Përkundër rritjes së vazhdueshme ekonomike, prodhimi vendor vazhdon të jetë në nivel mjaft të ulët, duke bërë kështu që ekonomia e vendit në masë të madhe të mbështetet në importin e mallrave nga jashtë, gjë që në vazhdimësi ka shkaktuar norma të larta të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Përkundër lehtësirave për zhvillimin e tregtisë, të krijuara nga përdorimi i valutës euro si dhe nga nënshkrimi i marrëveshjes për tregti të lirë CEFTA (angl. *Central Europe Free Trade Agreement: CEFTA*), Kosova vazhdon të ketë probleme në zhvillimin e tregtisë së lirë me vendet e rajonit si Serbia dhe Bosnja e Hercegovina – vende këto që nuk po e implementojnë marrëveshjen në fjalë kur është në pyetje Kosova. Megjithatë, tregtia e Kosovës me vendet tjera shënoi trende mjaft pozitive gjatë vitit 2010, sidomos tek eksportet për shkak të rritjes së kërkesës në ekonominë globale.

Sfida kryesore për ekonominë e vendit vazhdon të jetë norma e lartë e papunësisë. Anketa e Fuqisë Punëtore e ESK-së (2009) vlerëson se norma e papunësisë në ekonominë e Kosovës në vitin 2009 ishte rreth 45 përqind e fuqisë punëtore. Bazuar në trendin aktual të rritjes ekonomike dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës në ekonominë e Kosovës, mund të konsiderohet se norma e papunësisë nuk pritet të zvogëlohet dukshëm në periudhën afatmesme.

3.1.1. Produkti i brendshëm bruto³

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) i Kosovës gjatë vitit 2010 vlerësohet të ketë regjistruar një normë reale të rritjes prej 4.0 përqind. Vlera nominale e PBB-së në vitin 2010 ishte 4.2 miliardë euro (FMN, 2011). Për dallim nga viti 2009, kur sektori qeveritar ishte kontribuesi kryesor i rritjes ekonomike, në vitin 2010 kontributi kryesor i atribuohet rritjes së konsumit dhe investimeve të sektorit privat. Pjesëmarrja e konsumit privat në gjithsej konsumin në Kosovë gjatë vitit 2010 ishte 84.2 përqind krahasuar me 83.7 përqind në vitin 2009. Sektori privat dominon edhe për sa i përket strukturës së përgjithshme të investimeve në vend, me një pjesëmarrje prej 66.0 përqind në gjithsej investimet, ndërsa investimet e sektorit publik kanë një pjesëmarrje prej 34.0 përqind. Krahasuar me vitin

Figura 2. Rritja reale e PBB-së



Burimi: FMN (2011), dhe ESK (2010a)

³ Burimi i të dhënave për PBB-në është Fondi Monetar Ndërkombëtar, World Economic Outlook, Prill 2011.

paraprak, pjesëmarrja e investimeve publike në gjithsej investimet ka shënuar rënie të lehtë.


Rritja e konsumit të sektori privat dhe publik ndikoi që konsumi i përgjithshëm në Kosovë të shënojë rritje më të theksuar në krahasim me vitin paraprak. Norma reale e rritjes së konsumit të përgjithshëm në vitin 2010 ishte 3.3 përqind (0.9 përqind në vitin 2009). Zhvillime pozitive në vitin 2010 u shënuan edhe për sa i përket nivelit të përgjithshëm të investimeve, të cilat shënuan rritje reale prej 7.8 përqind (9.8 përqind në vitin 2009). Investimet e sektorit privat shënuan një rritje reale prej 5.9 përqind në vitin 2010, krahasuar me 2.2 përqind në vitin paraprak. Rritja e investimeve të sektorit privat është rezultat i rritjes së investimeve vendore si dhe rritjes së IHD-së. Investimet e sektorit publik gjithashtu kontribuan në rritjen e investimeve në vend, megjithëse norma e tyre e rritjes ishte më e ulët sesa në vitin 2009. Norma vjetore reale e rritjes së investimeve publike në vitin 2010 ishte 11.7 përqind, për dallim prej vitit 2009 kur këto investime kishin një normë vjetore të rritjes prej 29.0 përqind (FMN, 2011).

Si rezultat i vëllimit mjaft të lartë të importeve në krahasim me eksportet, bilanci tregtar vazhdon të ketë ndikim negativ në PBB-në e Kosovës. Thellimi i deficitit tregtar në Kosovë për 4.5 përqind gjatë vitit 2010 bëri që ndikimi negativ i deficitit tregtar në PBB gjatë këtij viti të jetë më i lartë në krahasim me vitin 2009. Përkundër nivelit të ulët, eksportet e Kosovës në vitin 2010 shënuan normë të lartë të rritjes duke arritur në nivelin më të lartë në periudhën e pasluftës. Rritje shënuan edhe importet e Kosovës nga jashtë, gjë që mund reflektojë rritje të kërkesës së brendshme në Kosovë, krahasuar me vitin 2009 kur importet kishin shënuar rënie.

3.1.2. Çmimet

Pas një viti të karakterizuar me deflacion, presionet inflacioniste në nivel global bënë që edhe ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2010 të shënojë rritje të inflacionit, posaçërisht gjatë gjysmës së dytë të vitit (Figura 3). Indeksi i çmimeve të konsumit (*angl. Consumer Price Index: CPI*) gjatë vitit 2010 shënoi rritje mesatare vjetore prej 3.5 përqind, ndërsa, rritja vjetore në fund të vitit (dhjetor 2010 krahasuar me dhjetor 2009) arriti në 6.6 përqind.

Figura 3. Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor



Burimi: ESK (2011)


Ndikimin kryesor në rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve gjatë vitit 2010 e kishte rritja e çmimeve të produkteve ushqimore, që njëkohësisht paraqesin komponentin më peshën më të madhe në shportën e konsumatorit në Kosovë. Rritja mesatare vjetore e këtyre çmimeve gjatë vitit 2010 ishte 4.7 përqind. Ndikim në rritjen e çmimeve kishte dhe ngritja e çmimeve për banim dhe shërbimet publike si rryma, uji, ngrohja, etj.

Lëvizjet e çmimeve në Kosovë në masë të madhe shkaktohen nga lëvizjet e çmimeve të importeve si pasojë e varshmërisë së lartë të ekonomisë së vendit në importin e mallrave nga jashtë. Në vitin 2010, norma mesatare vjetore e rritjes së Indeksit të Çmimeve të Importeve (*angl. Imports Price Index: IPI*) ishte 6.0 përqind.

Në anën tjetër, indeksi i çmimeve të prodhimit në Kosovë (*angl. Producer Price Index: PPI*) gjatë vitit 2010 ishte më stabil, duke shënuar rritje vjetore prej 2.1 përqind (mesatarja dhjetor 2010-dhjetor 2009).

Duke u bazuar në lëvizjet aktuale të çmimeve të produkteve ushqimore dhe derivateve të naftës si dhe bazuar në parashikimet për lëvizjet e çmimeve në nivel global, presionet inflacioniste pritet të jenë të pranishme në ekonominë e Kosovës edhe gjatë vitit 2011.

Figura 4. Indeksi i çmimit të konsumit, importit, prodhimit dhe çmimet globale të ushqimit



Burimi: ESK (2011)

Burimi: ESK (2011)

3.1.3 Tregu i punës

Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore të ESK-së, në vitin 2009, norma e papunësisë në Kosovë ishte 45 përqind⁴ dhe si e tillë paraqet sfidën më të vështirë për ekonominë e Kosovës. Si rezultat i strukturës së re të popullsisë së Kosovës, një numër i madh i të rinjve hyjnë në tregun e punës për çdo vit, ndërsa numri i vendeve të reja të punës që krijohen brenda një viti është i ulët. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), gjatë viteve 2004-2010, mesatarisht 25,000 persona në vit janë regjistruar si punëkërkues të rinj, ndërsa numri mesatar i vendeve të reja të punës të lajmëruara në MPMS për çdo vit ishte rreth 7,500.

Numri i punëkërkuesve të regjistruar, bazuar në të dhënat e MPMS-së, në vitin 2010 u zvogëlua në 335,260, që paraqet një rënie vjetore prej 1.1 përqind. Struktura e punëkërkuesve të regjistruar dominohet nga punëkërkuesit e pakualifikuar (63.6 përqind), të pasuar nga punëkërkuesit me kualifikim të mesëm (34.6 përqind), ndërsa punëkërkuesit me kualifikim universitar përbëjnë vetëm 1.8 përqind të gjithëj punëkërkuesve të regjistruar. Struktura e punëkërkuesve sipas gjinisë paraqitet e balancuar, ku rreth 47 përqind prej tyre i takojnë gjinisë femërore. Papunësia në Kosovë ka kryesisht karakter afatgjatë, ku më shumë se 90 përqind e punëkërkuesve kanë qenë të papunë për një periudhë më të gjatë se 12 muaj. Kjo e bën problemin e papunësisë në Kosovë edhe më shqetësues për shkak të rrezikut të degradimit të kapitalit njerëzor, gjë që zvogëlon edhe më tutje gjasat e punësimit për të papunët si dhe zvogëlon produktivitetin e përgjithshëm të fuqisë punëtore në vend.

Edhe pse të dhënat mbi punësimin në Kosovë janë mjaft të kufizuara, vlerësohet se rreth 80 përqind të të punësuarve janë të punësuar në sektorin privat. Në anën tjetër, sektori publik gjithashtu paraqet një punëdhënës të rëndësishëm, ku janë të punësuar rreth 20 përqind e gjithëj të punësuarve në Kosovë. Punësimi përmes ndërmjetësimit të MPMS-së, në vitin 2010, u karakterizua me nivel më të ulët sesa në vitin e kaluar. Numri i të punësuarve përmes ndërmjetësimit të MPMS-së në vitin 2010 ishte 6787, krahasuar me 7239 të punësuar në vitin 2009.

⁴ Në mungesë të të dhënave për vitin 2010, statistikat e tregut të punës janë paraqitur duke u bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore të vitit 2009.

3.2. Sektori fiskal

Buxheti i Kosovës në vitin 2010 u përmbyll me deficit prej 93.2 milionë euro, krahasuar me 85.5 milionë euro deficit në vitin 2009. Raporti ndërmjet deficitit buxhetor dhe PBB-së në vitin 2010 arriti në 2.2 përqind.

Në vitin 2010, Kosova për herë të pari hyri në aranzhman financiar me FMN-në. FMN i miratoi Kosovës kredinë e parë 'Stand-By-Arrangement' në vlerë prej 108.9 milionë euro (SDR 92.6 milionë), e cila është ekuivalente me 157 përqind të kuotës së Kosovës në FMN.⁵ Ky aranzhman kishte për qëllim adresimin e nevojave buxhetore dhe sipas marrëveshjes, FMN-ja parashihet të shpërndajë kredinë e aprovuar në buxhetin e Kosovës në gjashtë këste, përgjatë një periudhe prej 18 muajve. Gjatë vitit 2010, Kosova ka tërhequr këstin e parë në vlerë prej 22.1 milionë euro, ndërsa pesë këstet tjera do të varen prej rishikimeve tremujore të zbatimit të programit. Si pjesë e programit, Qeveria e Kosovës është paraparë t'u përmbahet rekomandimeve të FMN-së, që kryesisht kanë të bëjnë me racionalizimin e shpenzimeve buxhetore dhe rritjen e efikasitetit në administratën publike. Pas aprovimit të programit me FMN-në janë paraparë të shfrytëzohen edhe donacione buxhetore dhe kredi nga institucione tjera ndërkombëtare.

3.2.1. Të hyrat buxhetore

Në vitin 2010 të hyrat buxhetore ishin 1.17 miliardë euro, apo për 2.8 përqind më të larta se sa në vitin 2009. Raporti i të hyrave buxhetore dhe PBB-së në vitin 2010 arriti në 27.9 përqind, që paraqet nivel më të ulët se sa mesatarja e rajonit në vitin 2009 (34.2 përqind).

Të hyrat e mbledhura në kufi vazhdojnë të dominojnë strukturën e të hyrave buxhetore, të cilat në vitin 2010 përfaqësuan 59.3 përqind të gjithsej të hyrave. Në vitin 2010, të hyrat neto të mbledhura nga tatimet në kufi arritën vlerën prej 699.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.3 përqind (5 përqind rritje vjetore në 2009). Në rritjen e vëllimit të të hyrave kufitare ka ndikuar edhe rritja e importeve, të cilat në vitin 2010 shënuan rritje prej 10.8 përqind (0.4 përqind në vitin 2009). Në kuadër të tatimeve të mbledhura në kufi, TVSH e mbledhur në kufi përbën kategorinë më të madhe (30.7 përqind), e cila në vitin 2010 arriti vlerën prej 361.3 milionë euro. Një kategori tjetër e rëndësishme e të hyrave kufitare përbëhet nga të hyrat nga akciza (përfshirë edhe akcizën në duhan), të cilat në vitin 2010 arritën vlerën prej 232.4 milionë euro apo 19.7 përqind të gjithsej të hyrave të mbledhura në kufi. Krahasuar me vitin 2009, të hyrat nga akciza shënuan rritje prej 12.4 përqind.

Të hyrat neto nga tatimet vendore në vitin 2010 shënuan vlerën prej 194.2 milionë euro (rritje vjetore prej 6.9 përqind). Në kuadër të tatimeve vendore, pjesa më e madhe përbëhet nga TVSH e mbledhur brenda vendit (48.9 përqind e gjithsej të hyrave nga tatimet vendore), që në vitin 2010 arriti vlerën prej 95 milionë euro. Në krahasim me vitin 2009, të hyrat nga TVSH e mbledhur brenda vendit shënuan një rritje prej 25.3 përqind. Po ashtu, në vjeljen e tatimeve vendore mund të ketë ndikuar edhe implementimi i arkave fiskale në Kosovë. Arkat fiskale, për herë të parë kanë filluar të instalohen në biznese në mars të vitit 2010. Në vitin 2010, janë instaluar rreth 12,000 arka fiskale. Kategori tjetër e rëndësishme në kuadër të tatimeve vendore janë të hyrat nga korporatat, me pjesëmarrje prej 26.7 përqind në gjithsej të hyrat vendore. Të hyrat nga kjo kategori, shënuan vlerën prej 51.9 milionë euro në vitin 2010, që paraqet një rënie vjetore prej 6.3 përqind. Të hyrat nga tatimi në paga (i mbajtur në burim) arritën vlerën prej 44.2 milionë euro (22.8 përqind e gjithsej të hyrave vendore), duke shënuar një rritje vjetore prej 12.8 përqind. Një kategori

⁵ Shih Raporti Vjetor 2009, Kutia 1, faqe 33.

tjetër e tatimeve vendore, me pjesëmarrje më të ulët (2.2 përqind) janë edhe të hyrat nga bizneset individuale, të cilat në vitin 2010 arritën vlerën prej 25.5 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 23.9 përqind. Në vitin 2010, të hyrat vetanake shënuan vlerën prej 100.5 milionë euro (8.5 përqind të gjithsej të hyrave buxhetore), që paraqet një rritje vjetore prej 39.8 përqind. Struktura e të hyrave vetanake përbëhet nga të hyrat nga niveli qendror dhe të hyrat nga komunat. Në vitin 2010, nga niveli qendror u mboldhën 48.5 milionë euro ndërsa nga komunat u mbloodhën 52.0 milionë euro në buxhetin e Kosovës. Sa i përket të hyrave të njehershme, respektivisht transferimit të dividendës së PTK-së në buxhetin e Kosovës, në vitin 2010 shuma e këtyre të hyrave ishte 85 milionë euro, krahasuar me 200 milionë të transferuara në vitin 2009.

3.2.2. Shpenzimet buxhetore

Shpenzimet buxhetore në vitin 2010 ishin 1.27 miliardë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 3.2 përqind, që paraqet një rritje të ngadalësuar në krahasim me rritjen e vitit paraparak (29.6 përqind). Shpenzimet buxhetore në vitin 2010 përbënin 30.1 përqind të PBB-së, që paraqet pjesëmarrje më të ulët në krahasim me mesataren e rajonit (35.3 përqind të PBB-së në vitin 2009). Shpenzimet buxhetore të dedikuara për konsum në vitin 2010 ishin 11.2 përqind e PBB-së, ndërsa investimet kapitale ishin 10.8 përqind e PBB-së⁶.

Ngjashëm me vitet e fundit, edhe në vitin 2010 shpenzimet kapitale absorbuan pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore, me pjesëmarrje prej 35.8 përqind në gjithsej shpenzimet. Shpenzimet kapitale në vitin 2010 arritën vlerën prej 455.3 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 13.7 përqind. Pjesa më e madhe e shpenzimeve kapitale gjatë vitit 2010 kishte për destinim investimet në infrastrukturë (57 përqind të shpenzimeve kapitale), të cilat në masën më të madhe përbëhen prej investimeve në autostradën Morinë-Merdarë, që filloi të ndërtohet në prill të vitit 2010. Kategoria e dytë për nga madhësia ishin pagat dhe mëditjet, të cilat arritën vlerën prej 311.4 milionë euro (24.5 përqind të gjithsej shpenzimeve). Pagat dhe mëditjet përfaqësojnë kategorinë që ka shënuar rritjen më të lartë në kuadër të shpenzimeve buxhetore, duke shënuar një normë vjetore të rritjes prej 17.8 përqind. Subvencionet dhe transferet ishin kategoria e tretë me radhë për nga madhësia, me pjesëmarrje prej 19.9 përqind në gjithsej shpenzimet buxhetore. Subvencionet dhe transferet në vitin 2010 arritën vlerën prej 252.7 milionë euro. Kjo kategori u zvogëlua për 1.6 përqind në krahasim me vitin 2009. Zvogëlimi i kësaj kategorie në vitin 2010, kryesisht i atribuohet zvogëlimit të subvencioneve për ndërmarrjet publike nga 82 milionë euro sa ishin në vitin 2009, në 56 milionë euro në vitin 2010. Ndërsa, pensionet bazë, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të subvencioneve dhe transfereve, në vitin 2010 arritën vlerën prej 95 milionë euro (86 milionë euro në vitin 2009).

Kategoria me pjesëmarrjen më të vogël në kuadër të shpenzimeve buxhetore në vitin 2010 ishte kategoria e mallrave dhe shërbimeve, e cila shënoi vlerën prej 162.6 milionë euro (12.8 përqind të gjithsej shpenzimeve buxhetore) dhe shënoi rritje vjetore prej 7.1 përqind. Rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime erdhi kryesisht si rrjedhojë e rritjes së shpenzimeve kontraktuale dhe të mirëmbajtjes e riparimit.⁷

Në kuadër të shpenzimeve buxhetore, që nga viti 2009 kanë filluar të klasifikohen edhe financimet tjera, në të cilat bëjnë pjesë huazimet për ndërmarrjet publike dhe servisimi i borxhit të jashtëm (7.1 përqind të gjithsej shpenzimeve buxhetore). Në vitin 2010, nga buxheti i Kosovës janë ndarë 60 milionë euro hua për ndërmarrjet publike, prej të cilave pjesa më e madhe i është akorduar KEK-ut. Sa i përket borxhit të jashtëm, në vitin 2010,

⁶ Në shpenzimet për konsum bëjnë pjesë pagat e mëditjet dhe mallrat e shërbimet, ndërsa në investime bëjnë pjesë shpenzimet kapitale.

⁷ Shërbimet e arsimit dhe trajnimit, avokaturës, mirëmbajtjes së ndërtesave dhe infrastrukturës rrugore, etj.

nga Buxheti i Kosovës janë paguar 10.1 milionë euro. Përveç kësaj shume të paguar, Qeveria Amerikane ka ndihmuar në zvogëlimin e borxhit të jashtëm të Kosovës, duke paguar shumën prej 9.8 milionë euro.

3.3. Sektori financiar

3.3.1 Karakteristikat e përgjithshme


Gjatë vitit 2010, sektori financiar shënoi rritje më të ngadalshme krahasuar me vitin paraprak. Vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit financiar (pa konsideruar BQK-në) arriti në 3.2 miliardë euro në vitin 2010, që paraqet një rritje vjetore prej 13.7 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 24.1 përqind në vitin 2009. Akterët kryesorë të sektorit financiar vazhdojnë të jenë bankat komerciale dhe fondet pensionale,

duke menaxhuar 77 përqind respektivisht 15.5 përqind të gjithsej aseteve të sektorit financiar (Figura 5). Pjesa e mbetur u takon institucioneve mikrofinanciare (4.3 përqind), kompanive të sigurimeve (3.1 përqind) dhe ndihmësve financiarë (0.2 përqind).

Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2010, vërejmë pothuajse numër të njëjtë të institucioneve financiare që operonin në tregun financiar të Kosovës (Tabela 2). I vetmi ndryshim ishte shtimi i disa ndihmësve financiarë, të cilët kryesisht operojnë si byro të këmbimit valutor.

Pasqyra e institucioneve financiare (përfshirë edhe BQK-në) tregon për një rritje më të theksuar të aseteve të jashtme neto (AJN) gjatë vitit 2010 krahasuar me vitin 2009. Në fund të dhjetorit 2010, vlera e AJN-ve ishte rreth 2 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore prej 17.3 përqind (rritja vjetore në 2009 ishte 6.7 përqind). Vlera e kërkesave të institucioneve financiare në Kosovë ndaj sektorit të jashtëm ishte 2.4 miliardë euro, prej së cilës pjesa më e madhe është investuar në depozita (52.7 përqind) dhe në letra me vlerë (22.0 përqind). Depozitat dhe letrat me vlerë janë kryesisht të investuara nga BQK-ja (59.2 përqind), bankat komerciale (32.4 përqind) dhe fondet pensionale (8.4 përqind).

Figura 5. Struktura e aseteve të sistemit financiar sipas sektorëve



Burimi: BQK (2011)

Tabela 2. Numri i institucioneve financiare


Përshkrimi	2007	2008	2009	2010
Bankat komerciale	7	8	8	8
Kompanitë e sigurimeve	10	11	11	11
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit fin. dhe inst. mikrofinanciare	46	45	46	49

Burimi: BQK(2011)

Në anën tjetër, vlera e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm në vitin 2010 ishte 392.5 milionë euro, një rritje vjetore prej 17 përqind. Këto detyrime përbëhen kryesisht nga depozitat e jorezidentëve në bankat komerciale në Kosovë (22.2 përqind) dhe kreditë e marra nga jashtë (42.8 përqind). Përfitues të këtyre kredive kryesisht janë bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare. Pjesa tjetër e detyrimeve ka të bëjë me të Drejtat Speciale të Tirazhit (angl. Special Drawing Rights) dhe kuotën në FMN.

Kërkesat ndaj sektorit të brendshëm kapin vlerën prej 765.9 milionë euro, një rritje vjetore prej 33.5 përqind krahasuar me fundin e vitit 2009. Këto kërkesa përbëhen nga detyrimet ndaj qeverisë qendrore dhe kërkesat ndaj sektorit real. Sektori financiar i Kosovës ka vetëm detyrime ndaj qeverisë qendrore (jo edhe kërkesa), dhe ato përbëhen nga depozitat e qeverisë në BQK (98.6 përqind e tyre) dhe në bankat komerciale (1.4 përqind). Kërkesat e sektorit financiar të Kosovës ndaj sektorit real në fund të vitit 2010 ishin 1.59 miliardë euro (një rritje vjetore prej 12.0 përqind). Këto kërkesa kryesisht përbëhen nga kreditë e lëshuara nga bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare. Megjithatë, kur merren parasysh edhe detyrimet ndaj sektorit real, që kryesisht janë depozitat në bankat komerciale, atëherë neto kërkesat ndaj sektorit real shënojnë bilanc negativ prej 693.9 milionë euro (Figura 6).

Figura 6. Kërkesat neto të sektorit financiar, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

3.3.2. Sistemi bankar

Struktura e sistemit bankar të Kosovës në vitin 2010 ishte e ngjashme me atë të vitit të kaluar, si për nga numri i bankave ashtu edhe për nga struktura e pronësisë së tyre. Në vitin 2010, në tregun bankar të Kosovës operuan tetë banka komerciale, prej të cilave gjashtë ishin me pronësi të huaj ndërsa dy me pronësi vendore. Bankat me pronësi të huaj dominojnë tregun bankar në Kosovë, duke menaxhuar 90.2

përqind të gjithsej aseteve të sistemit bankar (91.1 përqind në vitin 2009). Pjesa e mbetur e aseteve (9.8 përqind në dhjetor 2010) menaxhohet nga dy bankat me pronësi vendore. Sistemi bankar në Kosovë vazhdon të karakterizohet me një shkallë të lartë të koncentrimit të tregut, ku rreth 77.4 përqind e gjithsej aseteve të sistemit bankar menaxhohen nga tri bankat më të mëdha. Megjithatë, duhet të theksohet se rritja e vazhdueshme e aktivitetit të bankave më të vogla ka ndikuar që shkalla e koncentrimit në tregun bankar të shënojë rënie të vazhdueshme që nga viti 2007. Shprehur përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH) për gjithsej asetet, tregu bankar kishte një shkallë të

Figura 7. HHI për asete, kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2011)

koncentrimin prej 2,241 pikë në dhjetor 2010 që, krahasuar me vitin 2009, tregon se shkalla e koncentrimin është për 224,1 pikë të IHH më e ulët (Figura 7).

Për dallim nga viti i kaluar, kur sistemi bankar u kushtëzua të ndërmarrë masa për kufizimin e shpenzimeve si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit ndërmjetësues financiar, në vitin 2010 sistemi bankar është karakterizuar me zgjerim të infrastrukturës. Në dhjetor 2010, numri i degëve dhe nëndegëve të bankave komerciale arriti në 303, që paraqet një rritje vjetore prej 16 njësi. Gjithashtu, krahasuar me vitin e kaluar, është vënë re një rritje e numrit të punëtorëve të punësuar në këtë sistem. Në dhjetor 2010, sistemi bankar kishte 3,768 punëtorë (3,626 punëtorë në dhjetor 2009). Gjatë këtij viti është vërejtur një trend më i ngadalshëm i zgjerimit për sa i përket numrit të ATM-ve dhe POS-ve të instaluar nga bankat komerciale (Tabela 3).

Numri i llogarive rrjedhëse në bankat komerciale gjatë vitit 2010 shënoi rritje më të ngadalshme, duke arritur në 1.40 milion në dhjetor 2010 krahasuar me 1.36 milion në dhjetor 2009. Përderisa në vitin 2009, numri i llogarive rrjedhëse shënoi rritje vjetore prej 12.9 përqind, në dhjetor 2010 rritja e llogarive në bankat komerciale u ngadalësua në 2.5 përqind. Trend të shpejtë të rritjes kanë treguar llogaritë 'e-banking', numri i të cilave ka arritur në 55,292 në dhjetor 2010, krahasuar me 40,924 në dhjetor 2009.

Tabela 3. Rrjeti i sistemit bankar

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010
Numri i degëve dhe nëndegëve	227	279	287	303
Numri i të punësuarëve	2,855	3,762	3,626	3,768
Numri i ATM-ve	155	240	339	415
Numri i POS-ve	0	3,426	5,251	6,194
Numri i llogarive e-banking	8,746	13,051	40,924	55,292

Burimi: BQK (2011)

Numri dhe vlera e transaksioneve në sistemin e pagesave ndërbankare ka vazhduar me rritje gjë që reflekton rritjen e aktivitetit ekonomik, si dhe rritjen e përdorimit të llogarive bankare nga ana e individëve dhe bizneseve, çka kontribuon edhe në zvogëlimin e informalitetit ekonomik në vend. Numri i gjithsej transaksioneve në vitin 2010 arriti në 3.9 milion (rritje vjetore prej 4.4 përqind), ndërsa rritje më e theksuar u vërejt në vlerën e transaksioneve, që kryesisht ishte rrjedhojë e transaksioneve qeveritare, në veçanti transferet e dividendës së Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (PTK). Duke arritur vlerën prej 4.7 miliard euro në dhjetor 2010, vlera e gjithsej transaksioneve të pagesave bankare shënoi një rritje vjetore prej 17.2 përqind.

3.3.2.1 Bilanci i gjendjes i sistemit bankar

i. Asetet

Vlera e gjithsej asetëve të menaxhuara nga bankat komerciale në Kosovë arriti në 2.5 miliard euro në vitin 2010, që tregon për një rritje vjetore prej 11.4 përqind (21.9 përqind në dhjetor 2009). Përderisa kontribuues thelbësorë në rritjen e përgjithshme të asetëve të sistemit bankar vazhdojnë të jenë kreditë dhe investimet në letra me vlerë, ngadalësimi i ritmit të rritjes së asetëve gjatë vitit 2010 mund të jetë kryesisht pasojë e kontributit

negativ të bilancit të bankave komerciale në BQK. Kreditë dhe letrat me vlerë kontribuan në normën e rritjes së gjithsej aseteve me 7.7, përkatësisht 3.5 pp në vitin 2010, përdërisa bilanci i bankave komerciale në BQK kontribuoi negativisht me 1.3 pp (Figura 8).

Rikuperimi i ekonomisë globale nga kriza financiare e vitit të kaluar ka ndikuar në rritjen e aktivitetit të bankave, gjë që ka ndikuar në rritjen më të shpejtë të kredive krahasuar me vitin e kaluar, dhe në të njëjtën kohë, zvogëlimin e rezervave të bankave komerciale

në BQK. Në raport me PBB-në, asetet e sistemit bankar arritën normën prej 59.7 përqind, një rritje prej 2.7 pp krahasuar me vitin paraprak. Aktiviteti i bankave komerciale që operojnë në Kosovë në masë dërmuese është i koncentruar në aktivitetin ndërmjetësues brenda ekonomisë së vendit, ndërsa 19.7 përqind e gjithsej aseteve janë të investuara në sektorin e jashtëm.

Kreditimi i ekonomisë vazhdon të jetë aktiviteti kryesor i sistemit bankar në vend. Për dallim nga viti i kaluar, kur trendi i kreditimit të ekonomisë vendore shënoi ngadalësim të rritjes, në vitin 2010, kreditë u karakterizuan me trend më të shpejtë të rritjes. Vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga sistemi bankar i Kosovës arriti në 1.46 miliard euro në vitin 2010, që paraqet një rritje vjetore prej 13.2 përqind, krahasuar me rritjen prej 8.9 përqind të shënuar në vitin 2009 (Tabela 4). Në fund të vitit 2010, kreditë përfaqësuan 59.4 përqind të gjithsej aseteve të sistemit bankar (58.5 përqind në vitin 2009).


Tabela 4. Struktura e aseteve të sistemit bankar

Përshkrimi	2007		2008		2009		2010	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	189.0	13.2%	218.2	12.1%	322.7	14.6%	307.5	12.5%
Bilanci me bankat komerciale	208.1	14.5%	283.9	15.7%	405.6	18.4%	439.0	17.9%
Letrat me vlerë	78.9	5.5%	40.5	2.2%	97.0	4.4%	173.4	7.1%
Kreditë dhe lizingu (bruto)	892.1	62.2%	1,183.4	65.4%	1,289.0	58.5%	1,458.7	59.4%
Asetet fikse	27.2	1.9%	39.0	2.2%	43.1	2.0%	44.1	1.8%
Asetet tjera	39.7	2.8%	43.1	2.4%	46.7	2.1%	32.5	1.3%
Gjithsej	1,435	100%	1,808	100%	2,204	100%	2,455	100%

Burimi: BQK (2011)

Si rrjedhojë e ngadalësimit të kreditimit, në vitin paraprak bankat komerciale orientuan një pjesë të investimeve të tyre drejtë tregjeve të jashtme, konkretisht në investime në letra me vlerë. Rritja e investimeve në letra me vlerë jashtë vendit vazhdoi edhe gjatë vitit 2010, duke u nxitur po ashtu nga rimëkëmbja e tregjeve financiare ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe. Investimet në letra me vlerë arritën shumën prej 173.4 milionë euro në vitin 2010 (97.0 milionë euro në vitin 2009), duke rritur pjesëmarrjen e tyre në gjithsej asetet në

Figura 8. Kontributi në rritjen e aseteve të sistemit bankar sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

7.1 përqind (4.4 përqind në 2009). Kjo është pjesëmarrja më e lartë që kanë pasur investimet në letra me vlerë në gjithsej asetet që nga viti 2006. Struktura e investimeve të bankave në letra me vlerë përbëhet kryesisht nga investimet në letra me vlerë të qeverive (83.1 përqind), korporatave financiare (16.7 përqind) dhe korporatave jofinanciare (0.2 përqind).

ii. Struktura e kredive


Rikuperimi i ekonomisë botërore dhe si rrjedhojë edhe përmirësimi i perceptimeve të bankave për ambientin ekonomik në vend, u reflektuan në një normë më të lartë të rritjes së kredisë gjatë vitit 2010 krahasuar me vitin 2009. Në vitin 2010, vlera e kredive të lëshuara nga sistemi bankar në vend arriti në 1.5 miliardë euro, një rritje vjetore prej 13.2 përqind krahasuar me rritjen prej 8.9 përqind në vitin 2009 (Figura 9). Normën më të lartë të rritjes

vazhdojnë të regjistrojnë kreditë për ekonomitë familjare të cilat, në vitin 2010, shënuan një rritje vjetore prej 25.5 përqind. Kreditë për ndërmarrjet vazhdojnë të rriten me normë më të ulët sesa kreditë për ekonomitë familjare. Megjithatë, norma vjetore e rritjes prej 8.7 përqind në vitin 2010 tregon për një trend më të shpejtë të rritjes së kredive për ndërmarrjet në krahasim vitin 2009.

Struktura e kredive edhe në vitin 2010 ishte e dominuar nga kreditë për ndërmarrjet, të cilat kishin një pjesëmarrje prej 70.5 përqind në gjithsej kreditë e lëshuara nga sistemi bankar (Figura 10). Sidoqoftë, kreditë për ekonomitë familjare gjatë dy viteve të fundit kanë rritur pjesëmarrjen në gjithsej kreditë. Në vitin 2010, pjesëmarrja e kredive për ekonomitë familjare në gjithsej kreditë e sistemit bankar arriti në 29.5 përqind, krahasuar me 26.7 përqind në vitin 2009. Kjo kryesisht për shkak të ngadalësimit më të theksuar të rritjes së kredive për ndërmarrjet, përderisa norma e rritjes së kredive për ekonomitë familjare, me gjithë zvogëlimin, ishte më e përafërt me periudhat e kaluara.


Shpërndarja sektoriale e kredive mbeti e pandryshuar nga vitet e mëparshme, me sektorin e shërbimeve që absorbon pjesën më të madhe të kredive (70.1 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet). Pjesa më e madhe e kredive për sektorin e shërbimeve përbëhet nga kreditë për ndërmarrjet tregtare (50.8 përqind të kredive për ndërmarrjet), pasuar nga kreditë për sektorin e industrisë që përfshinë minierat, prodhimtarinë, industrinë dhe

Figura 9. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

Figura 10. Struktura e kredive, në përqindje



Burimi: BQK (2011)


ndërtimtarinë, të cilat kanë pranuar 26.1 përqind të gjithsej kredive të lëshuara për ndërmarrjet. Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë një pjesëmarrje mjaft të ulët në kreditë e lëshuara për ndërmarrjet, duke pranuar vetëm 3.7 përqind të gjithsej këtyre kredive (Figura 11).

Kreditë për sektorin e tregtisë dhe për shërbimet financiare u karakterizuan me trend rritës në vitin 2010, përderisa kreditimi i sektorëve tjerë shënoi ngadalësim krahasuar me vitin paraprak. Duke arritur vlerën prej 521.6 milion euro, kreditë për sektorin e tregtisë shënuan rritje vjetore prej 13.7 përqind në vitin 2010 (4.9 përqind, në dhjetor 2009). Kreditë lëshuar ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime financiare arritën vlerën prej 22.1 milion euro, krahasuar me 10.6 milion euro në vitin paraprak. Kreditimi i sektorit të industrisë shënoi ngadalësim të rritjes gjatë vitit 2010, me kreditë për prodhimtarinë që shënuan rritje vjetore prej 5.8 përqind (29.9 përqind në vitin 2009), dhe kreditë për sektorin e ndërtimtarisë që shënuan rritje vjetore prej 22.5 përqind (35.9 përqind në vitin 2009). Në vitin 2010, kreditë për sektorin e prodhimtarisë arritën vlerën prej 126.8 milion euro, që tregon për një pjesëmarrje prej 12.3 përqind në gjithsej kredite e lëshuara për ndërmarrjet. Në të njëjtën periudhë, kreditë për sektorin e ndërtimtarisë arritën vlerën prej 109.1 milion euro, duke përfaqësuar 10.6 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet.

Për sa i përket afatit të maturimit, struktura e kredive të lëshuara nga sistemi bankar mbetet e dominuar nga kreditë me afat më të gjatë maturimi. Në vitin 2010, kreditë me afat maturimi mbi dy vite deri në pesë vite përfaqësuan 43.5 përqind të gjithsej kredive, pasuar nga kreditë me maturitet mbi pesë deri në dhjetë vite, të cilat përbënin 25.4 përqind të gjithsej kredive. Gjithsej kreditë me maturitet mbi dy vite, në vitin 2010 përfaqësuan rreth 73.1


përqind të gjithsej kredive të sistemit bankar (Figura 12). Pjesëmarrje të konsiderueshme në gjithsej kreditë e sistemit bankar kanë edhe kreditë me maturitet deri në një vit, që përfaqësojnë 20.6 përqind të gjithsej kredive. Pjesa e mbetur i takon kredive me maturitet prej një deri në dy vite (6.3 përqind) dhe mbi dhjetë vite (4.3 përqind). Në vitin 2010 është vënë re një rënie në kreditë me afat maturimi prej një deri në dy vite. Duke shënuar vlerën prej 91.2 milion euro, kreditë me afat maturimi prej një deri në dy vite shënuan rënie vjetore prej 37.1 përqind. Si rrjedhojë, pjesëmarrja e kredive me afat maturimi prej një deri në dy vite u zvogëlua për rreth 5.0 pp.

Figura 11. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

Figura 12. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

iii. Detyrimet

Edhe në vitin 2010, struktura e detyrimeve të sistemit bankar u dominua nga depozitat e mbledhura brenda Kosovës, që njëkohësisht përfaqësojnë burimin kryesor të financimit për bankat komerciale në vend. Në dhjetor 2010, depozitat përfaqësuan 78.9 përqind të gjithsej detyrimeve të sistemit bankar (Tabela 5). Trendi i rritjes së depozitave në vitin 2010 ishte më i ngadalshëm krahasuar me vitin 2009. Duke arritur vlerën prej 1.93 miliard euro, depozitat në sistemin bankar shënuan një rritje vjetore prej 11.0 përqind në dhjetor 2010, e cila është më e ulët se sa norma e rritjes prej 20.8 përqind në dhjetor 2009. Ngadalësimi i trendit të rritjes së depozitave kryesisht reflekton tërheqjen e depozitave të qeverisë nga bankat komerciale, të cilat ndikuan nivelin e përgjithshëm të depozitave.

Mjetet vetanake përbëjnë një burim tjetër të rëndësishëm të financimit që, në dhjetor 2010, përfaqësuan 9.4 përqind të gjithsej detyrimeve të sistemit bankar. Mjetet vetanake shënuan rritje vjetore prej 12.7 përqind, kryesisht si rrjedhojë e rritjes së kapitalit aksionar të bankave, që përbën rreth 73.9 përqind të gjithsej mjeteve vetanake. Në kuadër të detyrimeve të sistemit bankar, rritje të vazhdueshme ka shënuar edhe kategoria e borxhit të ndërvarur që, në dhjetor 2010 arriti vlerën prej 33.5 milionë euro (24.4 milion euro në dhjetor 2010). Megjithatë, pjesëmarrja e borxhit të ndërvarur në gjithsej detyrimet e sistemit bankar vazhdon të jetë e ulët (1.4 përqind në dhjetor 2010). Rritja e vazhdueshme e borxhit të ndërvarur dhe plasmanëve nga bankat komerciale jashtë vendit tregojnë për rritjen graduale të shfrytëzimit të burimeve të jashtme të financimit nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë.

Tabela 5. Struktura e detyrimeve të sistemit bankar


Përshkrimi	2007		2008		2009		2010	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	25.8	1.8	34.9	1.9	58.5	2.7	56.8	2.3
Depozitat	1,143.1	79.6	1,444.1	79.9	1,744.9	79.2	1,937.0	78.9
Huatë tjera	2.7	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Detyrimet tjera	103.7	7.2	129.8	7.2	171.7	7.8	197.4	8.0
Borxhi i ndërvarur	7.0	0.5	7.0	0.4	24.4	1.1	33.5	1.4
Mjetet vetanake	152.7	10.6	192.5	10.6	204.6	9.3	230.5	9.4
Gjithsej	1,435	100.0	1,808	100.0	2,204	100.0	2,455	100.0

Burimi: BQK (2011)

iv. Struktura e depozitave

Burimi kryesor i depozitave për sistemin bankar të Kosovës vazhdojnë të jenë depozitat e ekonomive familjare që, në dhjetor 2010, arritën vlerën prej 1.3 miliardë euro. Depozitat për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 25.0 përqind në vitin 2010, krahasuar me rritjen prej 23.3 përqind në vitin paraprak. Duke arritur shumën prej 526.6 milion euro, depozitat e ndërmarrjeve shënuan një rritje

Figura 13. Struktura e depozitave sipas sektorëve, në përqindje




Burimi: BQK (2011)

vjetore prej 14.0 përqind. Struktura e depozitave të ndërmarrjeve, në fund të vitit 2010, u dominua nga depozitat e ndërmarrjeve private (76.0 përqind të gjithsej depozitave të ndërmarrjeve). Sa i përket depozitave të qeverisë, tërheqja e vazhdueshme nga bankat komerciale gjatë vitit 2010 ndikoi që vlera e këtyre depozitave në fund të vitit të jetë vetëm 11.7 milionë euro krahasuar me vlerën prej 164.9 milionë euro sa ishin në dhjetor 2009.

Sa i përket strukturës së gjithsej depozitave, në vitin 2010 vërehet se pjesëmarrja e depozitave të ekonomive familjare ka shënuar rritje prej 7.5 pp duke arritur në 67.1 përqind të gjithsej depozitave, ndërkaq pjesëmarrja e depozitave të ndërmarrjeve shënoi rritje më të ngadalshme prej 0.7 pp duke arritur në 27.2 përqind të gjithsej depozitave të sistemit bankar (Figura 13). Rritja e pjesëmarrjes së depozitave të ekonomive familjare kryesisht reflekton zvogëlimin e pjesëmarrjes së depozitave të qeverisë në këtë periudhë. Krahasuar me vitin paraprak, pjesëmarrja e depozitave të qeverisë në gjithsej depozitat e sektorit bankar arriti në 0.6 përqind, që tregon për zvogëlim të pjesëmarrjes për 8.8 pp në vitin 2010. Rritje të pjesëmarrjes

kanë shënuar depozitat e jorezidentëve të cilët duke arritur vlerën prej 84.8 milionë euro, shënuan rritje vjetore prej 32.3 përqind (dhjetor 2010). Struktura e depozitave në sektorin bankar të Kosovës, për sa i përket valutës, dominohet nga depozitat në valutën euro, të cilat përbëjnë 94.5 përqind të gjithsej depozitave. Kjo bënë që edhe rreziku i normës së këmbimit ndërmjet euros dhe valutave tjera të jetë minimal.

Figura 14. Struktura e depozitave të afatizuara sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

Sa i përket afatit të maturimit, depozitat në sistemin bankar të Kosovës në vitin 2010 kishin një strukturë të ngjashme me vitin e kaluar. Pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej depozitat vazhdojnë ta kenë depozitat e afatizuara, që përfaqësojnë rreth 47.7 përqind të gjithsej depozitave. Pjesa e mbetur përbëhet nga depozitat e transferueshme dhe depozitat e kursimeve që, në dhjetor 2010 përfaqësuan 34.6 përkatësisht 17.6 përqind të gjithsej depozitave.

Struktura e depozitave të afatizuara vazhdon të dominohet nga depozitat me afat të shkurtër maturimi. Në dhjetor 2010, depozitat me afat maturimi deri në një vit përfaqësuan 76.2 përqind të gjithsej depozitave të afatizuara, pasuar nga depozitat me afat maturimi mbi dy vite që përfaqësuan 15.3 përqind të depozitave të afatizuara (Figura 14). Pjesa e mbetur e depozitave të afatizuara janë kryesisht depozita me afat maturimi mbi një vit deri në dy vite, që përfaqësuan 8.5 përqind të gjithsej depozitave të afatizuara në vitin 2010. Sa i përket trendit të depozitave të afatizuara, vlen të theksohet se në vitin 2010 është vërejtur që depozitat me afat më të shkurtër maturimi kanë zvogëluar pjesëmarrjen e tyre në gjithsej depozitat, ndërsa depozitat me afat më të gjatë maturimi kanë rritur pjesëmarrjen e tyre. Kështu, depozitat me afat maturimi deri në një vit zvogëluan pjesëmarrjen e tyre për 8.3 pp, ndërsa depozitat me afat maturimi mbi dy vite rritën pjesëmarrjen e tyre në gjithsej depozitat për 8.2 pp. Rritja e vazhdueshme e depozitave me afat më të gjatë maturimi do të ndikojë pozitivisht në zgjerimin e kreditimit afatgjatë dhe njëkohësisht përmirëson gjendjen e likuiditetit në sistemin bankar. Aprovimi i ligjit mbi sigurimin e depozitave pritet të ndikojë pozitivisht në besimin e depozitorëve ndaj bankave, gjë që do të ndikojë në rritjen e mëtejme të depozitave me afat më të gjatë maturimi.

3.3.2.2 Normat e interesit

Lëvizjet e normave të interesit gjatë vitit 2010 u karakterizuan me një rënie të normave në depozita, ndërsa normat e interesit në kredi shënuan një ngritje të lehtë.

Norma mesatare e interesit në depozita (mesatarja lëvizëse 12-mujore) u zvogëlua nga 4.3 përqind sa ishte në dhjetor 2009 në 3.7 përqind në dhjetor 2010, përderisa norma mesatare e interesit në kredi u ngrit në 14.6 përqind në dhjetor 2010 nga 14.4 përqind në dhjetor 2009 (Figura 15). Zvogëlimi i normës së interesit në depozita gjatë vitit 2010 mund të jetë rezultat i ngadalësimit të kredidhënies nga sistemi bankar në gjysmën e parë të vitit, gjë që mund të ketë ndikuar në zvogëlimin e kërkesës së bankave për depozita. Dallimi në mes të normave të interesit në depozita dhe kredi në fund të vitit 2010 arriti në 10.9 pp, që paraqet një rritje vjetore prej 0.8 pp.


Normat e interesit për depozitat e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare ishin të ngjashme gjatë vitit 2010. Norma mesatare më e lartë për depozitat e ndërmarrjeve në dhjetor 2010 ishte 5.14 përqind, e cila ofrohet për depozitat e ndërmarrjeve në vlerë deri në 250 mijë euro dhe me afat maturimi mbi dy vite. Ndërsa, norma më e lartë mesatare për depozitat e ekonomive familjare arrin në 5.14 përqind, që po ashtu i takon depozitave me afat maturimi mbi dy vite. Sa i përket normave mesatare të interesit në kredi, kreditë për ndërmarrje vazhdojnë të kenë norma më të larta të interesit krahasuar me kreditë për ekonomitë familjare. Me një nivel prej 13.8 përqind, norma mesatare e interesit për kreditë e ndërmarrjeve ishte më e lartë për rreth 1.4 pp krahasuar me normën mesatare të interesit në kreditë për ekonomitë familjare.

3.3.2.3 Performanca e sistemit bankar

Sistemi bankar i Kosovës përmbylli vitin 2010 me profit neto prej 32.8 milionë euro, që është për 29.9 përqind më i lartë sesa ai i vitit të kaluar. Duke marrë parasysh se në vitin 2009 kishte zvogëlim të profitit neto në sistemin bankar, rritja e profitit në vitin 2010 tregon për përmirësim të dukshëm në performancën e këtij sistemi.

Një ndër arsyt kryesore të rritjes së profitit është rritja më e shpejtë e kreditimit të ekonomisë nga ana e sistemit bankar gjatë vitit 2010 në krahasim me vitin e mëparshëm, duke pasur parasysh që të hyrat nga interesi në kredi përfaqësojnë burimin kryesor të të hyrave të sistemit bankar. Kontribut mjaft të rëndësishëm në rritjen e profitit ka dhënë edhe ngadalësimi i rritjes së shpenzimeve të sistemit bankar, duke bërë që norma e rritjes së të hyrave të jetë më e lartë sesa norma e rritjes së shpenzimeve. Përkundër rritjes së profitit neto, kthimi mesatar në asete (*angl. Return on Average Assets: ROAA*) mbeti në nivel të njëjtë me vitin e kaluar, duke qëndruar në 1.5 përqind (Figura 16).⁸ Ndërsa, kthimi mesatar në kapital (*angl. Return on Average Equity: ROAE*), në vitin 2010 arriti në 14.9 përqind, krahasuar me 13.9 përqind në vitin 2009.

Figure 15. Mesatarja lëvizëse 12-mujore e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2011)


⁸ Bazuar në asetet neto.

Gjithsej të hyrat e sistemit bankar në vitin në vitin 2010 arritën vlerën prej 217.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.8 përqind (3.3 përqind rritje vjetore në 2009).

Kjo tregon se trendi i rritjes së të hyrave të sistemit bankar u përshpejtua në krahasim me vitin 2009. Rritja e të hyrave të sistemit bankar në vitin 2010 kryesisht rezultoi për shkak të rritjes së kredidhënies gjatë këtij viti, që shkaktoi edhe rritjen e të hyrave nga interesi në kredi. Struktura e të hyrave të sistemit bankar mbetet e ngjashme me vitet e kaluara, ku të hyrat nga interesi përbëjnë pjesën më të madhe të

gjithsej të hyrave (80.1 përqind në vitin 2010). Të hyrat nga interesi shënuan rritje vjetore prej 7.7 përqind (4.4 përqind rritje në 2009) duke arritur vlerën prej 157.8 milionë euro. Po ashtu, ndryshe nga viti i mëparshëm, në vitin 2010 kishte edhe rritje të të hyrave nga jointerеси. Në vitin 2010, të hyrat nga jointerеси arritën vlerën prej 43.1 milionë euro, duke shënuar një normë vjetore të rritjes prej 8.1 përqind. Pjesën më të madhe të këtyre të hyrave e përbëjnë të hyrat nga komisionet.

Figura 16. Treguesit e performancës së sistemit bankar, në përqindje



Burimi: BQK (2011)

Tabela 6. Bilanci i suksesit, në milionë euro

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010
Të hyrat				
Të hyrat nga interesi	117.9	155.7	163.2	175.8
Të hyrat nga jo-interesi	39.5	39.3	38.2	41.4
Gjithsej të hyra	157.3	195.0	201.5	217.2
Shpenzimet				
Shpenzime e interesit	26.0	38.1	52.2	55.2
Shpenzimet tjera përveç të interesit	19.9	21.9	32.6	36.0
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	69.7	86.0	87.0	88.1
Gjithsej shpenzimet	116	146.0	172	179.3
Të hyrat neto				
Të hyrat operuese neto	41.7	49.0	29.6	37.8
Të hyrat neto para tatimit	41.3	47.6	28.9	37.1
Provizionet për tatim	7.9	11.2	3.6	4.3
Neto fitimi / humbja brenda periudhës	33.5	36.4	25.3	32.8

Burimi: BQK (2011)

Shpenzimet e sistemit bankar në vitin 2010 arritën vlerën prej 179.3 milionë euro. Trendi i rritjes së shpenzimeve të sistemit bankar u ngadalësua dukshëm në vitin 2010 (4.3 përqind rritje vjetore), në krahasim me normën e rritjes në vitin 2009 (17.7 përqind rritje vjetore). Ngadalësimi i rritjes ishte prezent në pothuajse të gjithë zërat e shpenzimeve bankare. Për shembull, shpenzimet e interesit në vitin 2010 ishin 55.2 milionë euro dhe u rritën për vetëm 5.8 përqind (37 përqind rritje vjetore në 2009). Shpenzimet e interesit u ngadalësuan kryesisht si pasojë e ngadalësimit të rritjes së depozitave në vitin 2010. Po ashtu, ngadalësimi i shpenzimeve të interesit mund të ketë ardhur si pasojë e rënies së normave të interesit në depozita gjatë vitit 2010, në krahasim me normat e interesit në vitin 2009. Shpenzimet e jointerесit në vitin 2010 arritën vlerën prej 36 milionë euro dhe shënuan

rritje vjetore prej 10.4 përqind (49.2 përqind në vitin 2009). Në kuadër të shpenzimeve të jointeressit, shpenzimet për provizione përbëjnë kategorinë më të madhe me vlerë 28.3 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 10.3 përqind. Rritja e shpenzimeve për provizione reflekton rritjen e kredive joperformuese gjatë vitit 2010. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative paraqesin kategorinë dominuese në shpenzimet e sistemit bankar (49.1 përqind të gjithsej shpenzimeve). Në vitin 2010 këto shpenzime arritën vlerën prej 88.1 milionë euro, që paraqet nivel të ngjashëm me vitin 2009. Ngadalësimi i rritjes së shpenzimeve të sistemit bankar para së gjithash pasqyron masat e ndërmarra nga sistemi bankar ndaj rënies së ndjeshme të profitit në vitin 2009.

Norma më e ulët e rritjes së të hyrave të sistemit bankar, në krahasim me rritjen e gjithsej aseteve të këtij sistemi, ka bërë që raporti ndërmjet të hyrave dhe aseteve të sistemit bankar të regjistrojë rënie gjatë dy viteve të fundit (9.3 përqind në 2009, 8.8 përqind në 2010). Kjo sugjeron se bankat komerciale ishin më pak efikase në gjenerimin e të hyrave nga shfrytëzimi i aseteve të tyre. Në anën tjetër, efikasiteti i bankave komerciale, shprehur përmes vlerës mesatare të aseteve të menaxhuara nga një punëtor, ka shënuar rritje. Për shembull, në vitin 2009 vlera mesatare e aseteve të menaxhuara nga një punëtor ishte 637.2 mijë euro, përderisa në vitin 2010 kjo vlerë u rrit në 680.1 mijë euro. Ky dallim reflekton zgjerimin më të shpejtë të aseteve të sistemit bankar në raport me numrin e punëtorëve.

3.3.2.4 Rreziqet e sistemit bankar


i. Rreziku i likuiditetit

Burimi kryesor i financimit për aktivitetin e sistemit bankar në Kosovë vazhdojnë të jenë depozitat e mbledhura brenda vendit. Si rrjedhojë, sistemi bankar i Kosovës karakterizohet me një ndjeshmëri të ulët ndaj lëvizjeve në koston dhe ofertën e fondeve në tregjet financiare ndërkombëtare. Në dhjetor 2010, pjesëmarrja e depozitave të sistemit bankar në gjithsej detyrimet e këtij sistemi ishte 78.9 përqind. Rol të rëndësishëm në financim e

operacioneve bankare kanë edhe mjetet vetanake, të cilat përfaqësojnë rreth 9.4 përqind të gjithsej detyrimeve. Ndërsa, plasmanet nga bankat komerciale jashtë vendit dhe borxhi i ndërvarur kanë një pjesëmarrje më të ulët, duke përbërë vetëm 2.3, përkatësisht 1.4 përqind të gjithsej detyrimeve të sistemit bankar të Kosovës.

Treguesit e likuiditetit flasin për një nivel në vazhdimësi të kënaqshëm të likuiditetit në sistemin bankar të Kosovës. Rritja më e shpejtë e kredive krahasuar me rritjen e depozitave gjatë vitit 2010 ndikoi në rritjen e raportit kredi-depozita, që në dhjetor të vitit 2010 arriti në 75.3 përqind, nga 73.9 përqind në vitin 2009 (Figura 17). Përkundër rritjes, raporti aktual ndërmjet kredive dhe depozitave është në pajtim me rekomandimet e BQK-së, të cilat sugjerojnë që bankat komerciale që operojnë në Kosovë mesatarisht të kenë një raport kredi-depozita rreth 80 përqind. Në të njëjtën kohë, rritja e raportit ndërmjet aseteve likuide dhe gjithsej aseteve të sistemit bankar tregon përmirësim të lehtë të

Figura 17. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

likuiditetit në sistemin bankar. Në dhjetor 2010, asetet likuide përbënin rreth 37.5 përqind të gjithsej aseteve të sistemit bankar, që paraqet një rritje prej 0.15 pp krahasuar me vitin paraprak.

Struktura e aseteve likuide të sistemit bankar të Kosovës përbëhet nga paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në, bilanci me bankat komerciale jashtë vendit si dhe investimet në letra me vlerë (Figura 18). Në fund të vitit 2010, asetet në kategorinë "paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në" ishin 307.5 milionë euro, që paraqet një rënie prej 4.7 përqind në krahasim me dhjetorin e vitit 2009. Ndërsa, kategoria a aseteve "bilanci me bankat komerciale" përbëhet kryesisht nga

Figura 18. Asetet likuide, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

mjetet të investuara si plasmane nga bankat që operojnë në Kosovë në bankat jashtë vendit. Në dhjetor 2010, kjo kategori kishte një vlerë prej 439.0 milionë euro, që paraqet një rritje prej 8.2 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2009. Edhe gjatë vitit 2010, bankat vazhduan trendin e filluar në vitin 2009, duke rritur investimet në letra me vlerë. Në dhjetor 2010, mjetet e investuara në formë të letrave me vlerë arritën në 173.4 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 78.8 përqind krahasuar me dhjetor 2009. Performanca e kënaqshme e tregjeve financiare në nivel global ishte përcaktues kyç që inkurajoi bankat të rrisin investimet në letra me vlerë. Po ashtu, rritjes së investimeve në letra me vlerë i ka kontribuar edhe ngadalësimi i rritjes së kredidhënies brenda vendit, duke krijuar kështu më tepër mjete në dispozicion për tu investuar në tregjet e jashtme.


ii. Rreziku kreditor

Reflektimi i krizës ekonomike globale edhe në Kosovë, gjatë vitit 2009 ndikoi në aftësinë paguese të kredimarrësve, duke u reflektuar kështu negativisht në cilësinë e portofolit kreditor të sistemit bankar. Në vitin 2010, përkundër faktit që ekonomia e Kosovës vlerësohet të ketë shënuar një normë më të lartë të rritjes krahasuar me vitin paraprak, pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej portofolin kreditor vazhdoi të rritet.

Përkeqësimi i cilësisë së portofolit kreditor përkundër normës më të lartë të rritjes ekonomike gjatë

këtij viti, deri në një masë mund të shpjegohet nga natyra specifike e kredive joperformuese, të cilat nuk reagojnë me automatizëm ndaj përmirësimit në performancën e ekonomisë së një vendi. Rritja e pjesëmarrjes së kredive joperformuese në gjithsej portofolin

Figura 19. Struktura e kredive sipas klasifikimit



Burimi: BQK (2011)


kreditor gjatë viteve 2009 dhe 2010, deri në një shkallë mund t'i atribuohet edhe "efektit të bazës" të shkaktuar nga shtrëngimi i kredidhënies nga bankat komerciale si përgjigje ndaj rritjes së pasigurisë mbi performancën e sektorit real të ekonomisë. Shtrëngimi i kredidhënies ka bërë që norma e rritjes së nivelit të përgjithshëm të kredive të jetë më e ulët sesa norma e rritjes së kredive joperformuese.

Për sa i përket strukturës së kredive në bazë të cilësisë, mund të vërehet një migrim i kredive nga kategoria "standarde" (që paraqet kreditë të cilat nuk kanë probleme të kthimit) drejtë kategorive që karakterizohen me cilësi më të dobët.⁹ Në dhjetor 2010, kreditë e klasifikuara si 'nënstandarde' përfaqësonin 2.6 përqind të gjithsej kredive, duke shënuar rritje prej 0.3 pp në krahasim me vitin 2010, përderisa kreditë e klasifikuara si 'vrojtuese' shënuan rënie (Figura 19).

Rritje më të theksuar kanë shënuar kreditë e klasifikuara në kategoritë si "të dyshimta" dhe "të humbura". Këto dy kategori së bashku përbëjnë portfolion e Kredive e joperformuese (angl. *Non-Performing Loans: NPL*). Në fund të vitit 2010, NPL-të përbënin 5.9 përqind të gjithsej kredive në sistemin bankar të Kosovës. Ky nivel i NPL-ve është për 0.9 pp më i lartë sesa në vitin 2009, kur NPL-të përfaqësonin 4.3 përqind të gjithsej kredive (Figura 20). Devijimi i mëtutjeshëm i cilësisë së portofolit kreditor parashtron


nevojën për ngjitje të mëtutjeshme të kapaciteteve në bankat komerciale për vlerësimin e rrezikut kreditor, në mënyrë që zgjerimi i mëtutjeshëm i kreditimit nga bankat të bëhet në suaza të kreditimit të shëndoshë, duke mos rrezikuar performancën e sistemit.

Figura 20. Gjithsej kreditë dhe NPL-të




Burimi: BQK (2011)

Figura 21. NPL-të sipas sektorëve



Burimi: BQK (2011)

Figura 22. NPL-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2011)

⁹ Bazuar në rregulloren e BQK-së, kreditë në sistemin bankar të Kosovës klasifikohen në pesë kategori kryesore: standarde, vrojtuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë e klasifikuara përfshijnë kategoritë: vrojtuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë me probleme përfshijnë kategoritë: nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë joperformuese përfshijnë kategoritë: të dyshimta dhe të humbura.

Struktura e NPL-ve në vazhdimësi është dominuar nga kreditë e klasifikuara si "të humbura". Mirëpo, në dhjetor të vitit 2010, pjesëmarrja e këtyre kredive në gjithsej NPL-të ishte 59.5 përqind apo 12.5 pp më e ulët në krahasim me vitin 2009. Ndërsa, pjesëmarrja e kredive të klasifikuara si "të dyshimta" në gjithsej NPL-të u ngrit në 40.5 përqind. Në vitin 2010, kreditë e klasifikuara si 'të humbura' u rritën për 10.8 milionë euro (27.3 përqind), ndërsa kreditë e klasifikuara si "të dyshimta" shënuan një rritje prej 19 milionë euro (122.5 përqind).


Për sa i përket ndarjes së kredive në bazë të agjentëve ekonomik, mund të vërehet se gjatë vitit 2010 portofoli i kredive të destinuara për ekonomitë familjare nuk ka pësuar ndonjë ndryshim sa i përket cilësisë në krahasim me vitin 2009 (Figura 21). Në anën tjetër, portofoli i kredive të destinuara për ndërmarrjet jofinanciare tregoi ndjeshmëri më të lartë ndaj vështirësive ekonomike. Gjatë kësaj periudhe, 5.0 përqind të kredive të ndërmarrjeve u cilësuan si NPL, që paraqet një rritje prej 0.2 pp krahasuar me vitin 2009.

Sistemi bankar i Kosovës në vazhdimësi është treguar mjaft konservativ sa i përket mbulimit të NPL-ve me provizione për humbje nga kreditë. Në dhjetor 2009, shkalla e mbulimit të NPL-ve me provizione për humbje nga kreditë ishte 125 përqind, kurse mesatarja për katër vitet e fundit ishte 130 përqind (Figura 22). Në dhjetor 2010, shumica e përgjithshme e provizioneve ishte rreth 96.9 milionë euro krahasuar me 77.4 milionë euro në dhjetor 2009. Shkalla e lartë e mbulueshmërisë së NPL me provizione bënë që niveli aktual i NPL-ve të mos kërcënoj stabilitetin e sistemit bankar.

iii. Rreziku i solvencës

Një prej treguesve të rëndësishëm për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sistemit bankar është Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (*angl. Capital Adequacy Ratio: CAR*). Në dhjetor 2010, sistemi bankar i Kosovës ngriti normën e CAR në 18.7 përqind krahasuar me 17.9 përqind sa ishte në vitin 2009 (Figura 23). Kjo normë është mjaft e kënaqshme duke marrë parasysh se është dukshëm më i lartë sesa niveli minimal prej 12 përqind që kërkohet me rregullativën e BQK-së. Duhet të potencohet fakti se të gjitha bankat që operojnë në Kosovë janë mirë të kapitalizuara dhe nuk kanë pasur ndonjë vështirësi në përmbushjen e kriterit prej 12 përqind për normën e CAR. Rritja e këtij treguesi gjatë vitit 2010 ishte si rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të kapitalit (13.0 përqind në 2010) në raport me asetet e peshuara ndaj rrezikut (*ang. Risk Weighted Assets: RWA*), të cilat shënuan rritje vjetore prej 9.0 përqind në 2010. Gjatë vitit 2010, bankat rriten investimet në letra me vlerë të cilat bartin në vete më pak rrezik në krahasim me kategoritë tjera, duke kontribuar në ngadalësimin e rritjes së RWA.

Figura 23. Kapitalizimi i sistemit bankar



Burimi: BQK (2011)

Në fund të vitit 2010, shumë e përgjithshme kapitalit të sistemit bankar ishte 271.4 milionë euro krahasuar me 240.2 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nga dhjetori i vitit 2008, kapitali i sistemit bankar ndoqi një trend rritës, por norma e rritjes u ngadalësua vazhdimisht (Figura 24). Burim kryesor i financimit të kapitalit në sistemin bankar vazhdon të jetë kapitali aksionar me pjesëmarrje prej 62.8 përqind, pasuar nga fitimi i mbajtur nga bankat me 21.9 përqind.

Bazuar në Rregullën I të BQK-së¹⁰, në dhjetor 2010 bankat ishin të obliguara të mbanin shkallën e kapitalit në nivelin prej 160.8 milionë euro. Mirëpo, në vazhdimësi bankat kanë mbajtur nivel më të lartë të kapitalit rregullativ se sa që u është kërkuar. Në dhjetor 2010, gjithsej kapitali rregullativ ishte 271.4 milionë, që paraqet një tepricë të kapitalit rregullativ prej 96.5 milionë euro (Figura 25).

3.3.2.4.1. Analiza stres-test

Gjendja e kënaqshme e sistemit bankar, për sa i përket qëndrueshmërisë ndaj rrezikut kreditor dhe atij të likuiditetit, konfirmohet edhe nga rezultatet e analizës stres-test. Rezultatet e prezantuara në këtë raport bazohen në të dhënat e dhjetorit 2010 për bankat komerciale që operojnë në Kosovë. Në kuadër të kësaj analize është testuar ndjeshmëria e sistemit bankar ndaj rrezikut kreditor të kombinuar me rrezikun nga normat e interesit dhe rrezikun nga norma e këmbimit. Gjithashtu, është testuar edhe ndjeshmëria ndaj rrezikut të likuiditetit, bazuar në supozimet hipotetike mbi tërheqjen e depozitave nga sistemi bankar.

i. Rezultatet e stres-testit – Rreziku kreditor

Për të vlerësuar ndjeshmërinë e sistemit bankar ndaj rrezikut kreditor, është supozuar se pjesëmarrja e kredive joperformuese (*angl. Non-Performing Loans: NPL*) në gjithsej kreditë e sistemit bankar do të rritet për 4.5pp, nga niveli aktual i NPL-ve prej 5.9 përqind në dhjetor 2010.¹¹ Kjo rritje e NPL-ve u kombinua edhe me supozimin e rënies së normave të

Figura 24. Gjithsej kapitali i sistemit bankar, në milionë euro





Figura 25. Gjithsej kapitali dhe kapitali rregullativ, në milionë euro



¹⁰ Sipas Rregullës I të BQK-së, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të kapitalit në raport me RWA

¹¹ Norma e supozuar e rritjes së NPL-ve është përcaktuar duke marrë për bazë normën mesatare të rritjes ekonomike në Kosovë në vitet e fundit, supozimin për rënien ekonomike dhe koeficientin e elasticitetit të NPL-ve ndaj hendekut të prodhimit, që është bazuar në një analizë të papublikuar të FMN-së "CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise", Korrik 2010

interesit dhe zhvlerësimin e valutës euro ndaj valutave tjera¹². Si rezultat, u vlerësua ndikimi i këtyre tri supozimeve në nivelin e kapitalit rregullativ të sistemit bankar, aseteve të peshuara me rrezik, dhe rrjedhimisht në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (*angl. Capital Adequacy Ratio: CAR*).

Rezultatet nga kjo analizë tregojnë se nën skenarin e lartshënuar vetëm njëra nga bankat (nga gjithsej tetë bankat që operojnë në Kosovë) do të kishte probleme me nivelin rregullativ të kapitalit, duke shënuar një normë të CAR-së më të ulët se 12 përqind, përderisa shuma e nevojshme për rikapitalizimin e kësaj banke do të arrinte në 1.5 milionë euro, apo vetëm 0.03 përqind të PBB-së. Gjithashtu, niveli i NPL-ve në tërë sistemin bankar do të arrinte në 10.4 përqind të gjithsej kredive të sistemit bankar.

Duke pasur parasysh rezultatet e mësipërme, mund të vlerësohet se sistemi bankar është mjaft i qëndrueshëm ndaj tronditjeve të mundshme në cilësinë e portofolit kreditor. Kjo kryesisht për shkak të nivelit të mjaftueshëm të provizionimit ndaj humbjeve të mundshme nga kreditë dhe nivelit të lartë të kapitalizimit të sektorit në përgjithësi (treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 18.8 përqind në dhjetor 2010). Gjithashtu, sistemi paraqitet të jetë i qëndrueshëm edhe ndaj ndonjë ndryshimi eventual të normave të interesit dhe normës së këmbimit. Normat kryesisht fikse të ofruara nga bankat si për kreditë ashtu edhe për depozitat bëjnë që sektori të mos jetë i ndjeshëm ndaj rrezikut nga normat e interesit. Ngjashëm, për shkak se më pak se 1 përqind e gjithsej mjeteve nga bilanci i gjendjes së sistemi bankar është në valutë tjetër nga euro, edhe rreziku nga norma e këmbimit është tejet marginal.

ii. Rezultatet e stres-testit – Rreziku i likuiditetit

Në kuadër të vlerësimit të ndjeshmërisë së sistemit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit është supozuar tërheqje e depozitave në normë prej 8 përqind të gjithsej depozitave në baza ditore për një periudhë prej 5 ditësh. Vlera totale e depozitave të tërhequra pas 5 ditësh do të arrinte në 34 përqind të gjithsej depozitave në sistemin bankar. Sa i përket mjeteve likuide në dispozicion të bankave gjatë kësaj periudhe, është supozuar se mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind brenda ditës, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jolikuide do të ishte vetëm 1 përqind. Është supozuar se bankat mund të shfrytëzojnë rezervat e tyre, mirëpo është përjashtuar mundësia e financimit përmes burimeve tjera të financimit. Pra, nën këtë skenar është vlerësuar mjaftueshmëria e mjeteve likuide në dispozicion të sistemit bankar për të përballuar një tërheqje të tillë të depozitave, duke mos shfrytëzuar burime të jashtme të financimit.

Rezultatet e stres-testit tregojnë se, nën këtë skenar hipotetik problemet e likuiditetit në sistemin bankar do të fillonin të paraqiteshin pas ditës së tretë dhe atë vetëm në njërin nga bankat. Shuma e nevojshme për përmbushjen e nevojave të likuiditetit për këtë bankë, nën supozimet e bëra, do të ishte 1.5 milionë euro (0.04 përqind e PBB-së). Ndërsa, pas ditës së pestë, në katër nga bankat do të paraqiteshin probleme të likuiditetit. Gjithsej mjetet likuide shtesë, të nevojshme për tejkalimin e problemeve të likuiditetit, do të arrinin vlerën prej 24.1 milionë euro, apo 0.58 përqind e PBB-së (Tabela 7). Pas ditës së pestë, raporti kredi/depozita në nivel të sektorit do të arrinte në 113.3 përqind (duke supozuar se niveli i kredive mbetet i pandryshuar).

Në përgjithësi, mund të vlerësohet se edhe pas një skenari të tillë mjaft konservativ, sistemi bankar i Kosovës paraqitet të ketë gjendje mjaft të mirë të likuiditetit. Problemet e

¹² Për detaje më të hollësishme mbi metodologjinë konsultoni Raportin e Stabilitetit Financiar, nr 1, faqe 53 – 54, BQK (2010).

paraqitura, duke marrë për bazë këtë skenar hipotetik, janë të izoluara në banka individuale. Niveli i kënaqshëm i mjeteve likuide në raport me gjithsej mjetet e sistemit, bënë që sistemi bankar të jetë i qëndrueshëm ndaj një tërheqje të konsiderueshme të depozitave.

Tabela 7. Rreziku i likuiditetit, rezultatet

Përshkrimi	Numri i bankave 1/	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)
Pas ditës së parë	0	0
Pas ditës së dytë	0	0
Pas ditës së tretë	1	1,510
Pas ditës së katërt	4	5,907
Pas ditës së pestë	4	24,074


1/ Numri i bankave që kanë nevojë për mjete likuide shtesë

Nëse bëjmë një krahasim të këtyre rezultateve me ato të qershorit 2010, nën skenarin e njëjtë (norma e tërheqjes së depozitave 8 përqind), situata duket të jetë mjaft e ngjashme. Duke shfrytëzuar të dhënat e qershorit 2010, niveli i supozuar i tërheqjes së depozitave do të ndikonte që pas ditës së tretë njëra prej bankave të kishte nevojë për mjete likuide shtesë në vlerë prej 2.2 milionë euro. Pas ditës së katërt, shuma totale e mjeteve likuide shtesë të nevojshme do të ishte 5.8 milionë, mirëpo e koncentruar në vetëm një bankë, përderisa me aplikimin e skenarit në të dhënat e dhjetorit 2010 shuma e mjeteve likuide shtesë (pothuajse e njëjta) është e shpërndarë në katër banka (Tabela 7).

3.3.3. Kompanitë e Sigurimit

Sistemi i kompanive të sigurimit në Kosovë vazhdoi të zgjerojë aktivitetin edhe gjatë vitit 2010, megjithëse pjesëmarrja e këtij sistemi në gjithsej asetet e sektorit financiar në vend vazhdon të jetë mjaftë e ulët. Në fund të vitit 2010, sistemi i sigurimeve në Kosovë përbëhej nga gjithsej 11 kompani të sigurimeve. Prej tyre, 10 kompani të sigurimeve ushtrojnë veprimtari në sigurimet jojetë dhe vetëm një kompani ofron shërbimet e sigurimit të jetës. Sa i përket strukturës së pronësisë, tetë kompani të sigurimeve janë me pronësi të huaj, ndërsa tri kanë pronësi vendore. Struktura e pronësisë së kompanive të sigurimit mbetet e ngjashme me atë të viteve paraprake. Në vitin 2010, 77.4 përqind e gjithsej aseteve të kompanive të sigurimeve kishin pronësi të huaj, ndërsa 22.6 përqind kishin pronësi vendore. Megjithatë, ndryshim në strukturën e pronësisë ka pësuar kompania "Dukagjini", e cila paraprakisht ishte pjesërisht në pronësi të huaj dhe vendore, ndërsa në vitin 2010, 100 përqind e aksioneve të saj i kaluan kompanisë sllovene "SAVA e Re".

Figura 26. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit



Gjithsej asetet e sistemit të kompanive të sigurimit në vitin 2010 arritën vlerën prej 97.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.3 përqind. Pjesën më të madhe të aseteve të kompanive të sigurimit e përbëjnë depozitat, të cilat në vitin 2010 kishin pjesëmarrje

prej 51.5 përqind në gjithsej asetet (Figura 26). Ndërsa, në anën e detyrimeve, kapitali aksionar paraqet kategorinë me peshën më të madhe, me pjesëmarrje prej 41.8 përqind të gjithsej detyrimeve të këtij sektori.

Raporti ndërmjet kapitalit dhe gjithsej asetëve, që shpreh nivelin e kapitalizimit të kompanive të sigurimit, në vitin 2010 ishte 41.8 përqind, krahasuar me 43.4 përqind në vitin 2009. Raporti ndërmjet kapitalit dhe rezervave teknike, i cili tregon aftësinë e kompanive të sigurimit për të përballuar humbjet potenciale, në vitin 2010 ishte 77.7 përqind, krahasuar me 81.5 përqind në vitin 2009.

Rënia e kësaj norme ka ardhur si rezultat i rritjes së rezervave teknike për 12.8 përqind, kundrejt rritjes më të ngadalësuar të kapitalit për 7.6 përqind.

Fitimi neto i kompanive të sigurimit në vitin 2010 ishte 1.5 milionë euro, krahasuar me 4.9 milionë euro humbje në vitin 2009. Përmirësimi i rezultatit financiar në kompanitë e sigurimit është reflektuar edhe në ecurinë e dy treguesve të performancës,


Kthimin Mesatar në Asete (*angl. Return on Average Assets: ROAA*) dhe Kthimin Mesatar në Kapital (*angl. Return on Average Equity: ROAE*). Kështu, indikatorin e ROAA për vitin 2010 u ngrit në 1.6 përqind nga një nivel negativ prej -5.7 përqind në vitin 2009, ndërsa ROAE arriti në 3.9 përqind nga -12.5 përqind në vitin 2009.

Gjatë vitit 2010, numri i policave të shitura nga kompanitë e sigurimit që operojnë në Kosovë ishte 540.7 mijë, që paraqet një rritje prej 5.7 përqind në krahasim me numrin e policave të shitura gjatë vitit 2009 (Figura 27). Po ashtu, rritje prej 5.1 përqind shënoi edhe vlera e primeve të pranuar, të cilat deri në fund të vitit 2010 arritën vlerën prej 71.2 milionë euro. Megjithatë, rritja e vlerës së primeve të pranuar ishte më e ngadalshme në vitin 2010, krahasuar me vitin 2009, kur rritja vjetore ishte 20.0 përqind. Ngadalësimi i rritjes së primeve të pranuar erdhi si rezultat i zvogëlimit të tarifave të sigurimit kufitar, gjë e cila ndodhi dy herë gjatë vitit 2010.¹³ Rrjedhimisht, të hyrat nga policat kufitare në vitin 2010 shënuan rënie vjetore prej 16.3 përqind, duke shënuar vlerën prej 10.6 milionë euro.

Veprimtaria e kompanive të sigurimit në Kosovë kryesisht është orientuar në ofrimin e policave për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palës së tretë (*angl. Third Party Liability: TPL*), të cilat gjenerojnë pjesën më të madhe të primeve të pranuar (57 përqind të gjithsej primeve). Vlera e TPL-ve në vitin 2010 ishte 40.6 milionë euro dhe shënoi rritje vjetore prej 11.8 përqind. Pjesa tjetër e primeve të pranuar përbëhet nga shitja e policave vullnetare, të cilat në vitin 2010 arritën vlerën prej 20 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 6.8 përqind. Megjithatë, pjesëmarrja e primeve të pranuar nga policat vullnetare në gjithsej primet e pranuar qëndroi në 28 përqind, që paraqet një nivel të ngjashëm me vitin 2009.

Dëmet e paguara nga ana e kompanive të sigurimit shënuan trend rritës gjatë vitit 2010, duke arritur vlerën prej 26.5 milionë euro (rritje vjetore prej 40.8 përqind). Pjesën më të

Figura 27. Primet e shitura dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)


¹³ Sipas Rregullës 3 të BQK-së, neni 8.3, kompanitë e sigurimeve kanë të drejtë të aplikojnë më së shumti dy herë gjatë një viti për ndryshim të tarifave. Në në janar 2010, tarifat e sigurimit kufitar u zvogëluar mesatarisht për 12 përqind, dhe në qershor 2010 u zvogëluar për rreth 15 përqind.

madhe të dëmeve të paguara zakonisht e përbëjnë pagesat për mbajtësit e policave TPL (rreth 72 përqind e gjithsej dëmeve të paguara në vitin 2010). Raporti ndërmjet dëmeve të paguara dhe primeve të pranuar në vitin 2010 arriti në 37.2 përqind (27.8 përqind në vitin 2009), duke reflektuar rritjen më të shpejtë të pagesave sesa të primeve të pranuar nga kompanitë e sigurimeve.

3.3.4. Fondet pensionale

Asetet e sistemit pensional të Kosovës në vitin 2010 arritën vlerën prej 493.7 milionë euro (12.0 përqind e PBB-së), duke shënuar një rritje vjetore prej 29.6 përqind. Performanca e sistemit pensional të Kosovës gjatë vitit 2010 ishte relativisht e mirë krahasuar me vitet paraprake. Kjo pasi që çmimi i njësisë së Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK-së), që menaxhon pjesën më të madhe të aseteve të sistemit pensional, shënoi rritje për 6.2 përqind krahasuar me vitin paraprak dhe arriti në 1.04 euro (çmimi bazë gjatë kontributit llogaritet 1.0 euro për aksion). Përmirësimi i performancës së investimeve të TKPK-së reflekton zhvillimet pozitive në tregjet ndërkombëtare të kapitalit gjatë vitit 2010, gjë e cila paraqitet edhe nga Figura 28, ku vërehet se çmimet e aksioneve të TKPK-së kanë ndjekur një trend shumë të ngjashëm me indeksin Dow Jones Industrial.


Figura 28. Çmimi i aksionit tëTKPK-së dhe indeksi DJI



Burimi: Trusti (2011), DJI (2011)

Nga gjithsej 488.5 milionë euro asete të TKPK-së, 6.8 përqind e tyre janë investuar në bankat komerciale në Kosovë, ndërsa 9.0 përqind janë depozituar në BQK. Nga mjetet tjera të investuara jashtë vendit (kryesisht në SHBA, Britani të Madhe dhe Japoni), pjesa më e madhe e mjeteve të TKPK-së janë të investuara në aksione (afër 40 përqind), ndërsa një pjesë e konsiderueshme e tyre është investuar edhe në tregun e parave (15 përqind) dhe në fletëobligacione (12.2 përqind). Sa i përket aseteve të Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve, pjesa më e madhe e tyre (mbi 95 përqind) janë të investuara në obligacione dhe depozita bankare ndërsa pjesa tjetër është e mbajtur në para të gatshme, aksione etj.

Figura 29. Struktura e investimeve të Trustit



Burimi: Trusti (2010)

3.3.5. Institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar

Në fund të vitit 2010, në Kosovë operonin 13 institucione mikrofinanciare (IMF), si dhe 8 institucione tjera jobankare. Industria mikrofinanciare në Kosovë vazhdimisht është karakterizuar me shkallë relativisht të lartë të koncentrimit të tregut. Megjithatë, në vitin

2010 vërehet rënie e shkallës së koncentrimit. Kjo tregohet përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman për asete, sipas të cilit shkalla e koncentrimit në vitin 2010 u zvogëlua në 1,747 pikë, krahasuar me 2,115 pikë në vitin 2009. Po ashtu, zvogëlimi i shkallës së koncentrimit të IMF-ve mund të vërehet edhe në rënien e shkallës së koncentrimit të aseteve të tri IMF-ve më të mëdha në vend (Figura 30). Zvogëlimi i shkallës së koncentrimit të tregut në këtë industri mund të nënkuptojë intensifikim të konkurrencës ndërmjet institucioneve mikrofinanciare.

Aktiviteti i IMF-ve vazhdon të jetë i përqendruar në financimin e bizneseve të vogla dhe ekonomive familjare. Numri i kredive të lëshuara nga këto institucione deri në fund të vitit 2010 ka arritur në 62,683 që paraqet një rritje vjetore prej 9 përqind. Në vitin 2010, vlera e portofolios së kredive të lëshuara nga IMF-të arriti në 116 milionë euro, që është një rritje vjetore prej 6.5 përqind (Figura 30).

Pjesëmarrja e kredive të lëshuara nga IMF-të në gjithsej kreditë e

lëshuara nga sektori financiar i Kosovës në vitin 2010 ishte 7.4 përqind, që paraqet një nivel të ngjashëm me atë të vitit 2009. Vlera mesatare e një kredie të lëshuar nga IMF-të në vitin 2010 arriti në 1,852 euro, në krahasim me 1,405 euro në vitin 2009.


Në vitin 2010, sektori i IMF-ve shënoi rënie të performancës në krahasim me vitin 2009 (humbje në vlerë rreth 2.0 milion euro). Si rrjedhojë, edhe treguesit si kthimi mesatar në asete (ROAA) dhe kthimi mesatar në kapital (ROAE) shënuan rënie. ROAA shënoi rënie nga 1.4 përqind sa ishte në vitin 2009 në -1.6 përqind në vitin 2010, përderisa ROAE u zvogëlua nga 4.3 përqind në vitin 2009 në -5.5 përqind në vitin 2010.

Ndihmësit financiarë në Kosovë përbëhen nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferimin e parave (ATP). Përmes ndihmësve financiar, në vitin 2010 janë transferuar 231.8 milionë euro, ose 2.1 përqind më shumë se në vitin 2009. Nga kjo shumë, 92.1 përqind ishin transfere hyrëse në Kosovë. Transferet përmes ATP-ve përbëjnë 4.2 përqind të gjithsej transfereve ndërkombëtare, kurse pjesa më e madhe e transfereve ndërkombëtare vazhdon të realizohet përmes bankave komerciale (rreth 78 përqind e gjithsej transfereve).

3.4. Sektori i jashtëm

Ekonomia e Kosovës vazhdoi të karakterizohet me nivel të lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse edhe gjatë vitit 2010. Në këtë vit, kryesisht si pasojë e rritjes së bilancit negativ të tregtisë së mallrave dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv të llogarisë së shërbimeve, deficitin në llogarinë rrjedhëse shënoi një rritje vjetore prej 13.4 përqind. Përderisa në vitin 2009 eksportet e Kosovës shënuan rënie, rimëkëmbja e kërkesës në nivel global ndikoi që në vitin 2010 eksportet të shënojnë një normë mjaft të lartë të rritjes. Rritja e importeve ishte më e ngadalshme krahasuar me rritjen e eksporteve, megjithatë, pesha e lartë që kanë importet në strukturën e përgjithshme të tregtisë së Kosovës vazhdoi të neutralizojë efektin e rritjes së eksporteve. Si rrjedhojë, deficitin tregtar i ekonomisë së vendit në vitin 2010, ishte më i lartë për rreth 9.4 përqind krahasuar me vitin e kaluar. Llogaritë e të ardhurave

Figura 30. Asetet e IMF-ve, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

dhe transfereve rrjedhëse vazhdojnë të kontribuojnë pozitivisht në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, bilancet pozitive të të cilave u karakterizuan me rritje vjetore prej 50.7 përkatësisht 2.6 përqind në vitin 2010. Në të njëjtën kohë, llogaria kapitale dhe financiare u përmbyll me bilanc pozitiv prej 448.9 milion euro. Rënia vjetore prej 17.3 përqind ishte kryesisht pasojë e zvogëlimit të bilancit të llogarisë kapitale në këtë periudhë.


3.4.1" Llogaria rrjedhëse

Bilanci negativ në llogarinë e tregtisë së mallrave vazhdon të jetë shkaktari kryesor për mbajtjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse në nivel të lartë. Në vitin 2010, deficitin e llogarisë rrjedhëse arriti në 684.4 milionë euro, krahasuar me 603.5 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (Figura 31).

Duke shënuar rritje vjetore prej 9.4 përqind, bilanci negativ i tregtisë së mallrave ka kontribuar ndjeshëm në rritjen e

deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në anën tjetër, rritja e bilancit pozitiv të llogarisë së të ardhurave si dhe transfereve rrjedhëse ka vazhduar të kontribuojë në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Llogaria e të ardhurave shënoi rritje vjetore prej 50.7 përqind në vitin 2010 (-49.4 përqind në vitin 2009). Në të njëjtën kohë, llogaria e transfereve rrjedhëse u karakterizua me rritje vjetore prej 2.6 përqind në vitin 2010 (9.0 përqind në vitin 2009), poashtu duke kontribuar në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse.

Figura 31. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK 2011

3.4.1.1" Mallrat dhe shërbimet

Ekonomia e Kosovës po vazhdon me zgjerim dhe rritje të këmbimit tregtar me botën e jashtme, duke bërë që shkalla e hapjes tregtare në dhjetor 2010 të arrijë në 59.3 përqind të PBB-së (dhjetor 2010), krahasuar me 54.3 përqind të PBB-së (dhjetor 2009). Rritja e theksuar e eksporteve, gjatë vitit 2010 ka rezultuar në shkallë më të lartë të mbulueshmërisë së importeve me eksporte, përkatësisht ka shënuar shkallën e mbulueshmërisë prej 13.7 përqind, krahasuar me 8.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (Tabela 8).

Duke shënuar vlerën prej 1.85 miliard euro, deficitin tregtar i Kosovës në vitin 2010 ishte më i lartë për rreth 4.6 përqind krahasuar me vitin 2009. Në raport me PBB-në, deficitin tregtar në vitin 2010 shënoi një rënie të lehtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, përkatësisht nga 45.8 përqind të PBB-së në dhjetor 2009 në 45.0 përqind të PBB-së në dhjetor 2010.

Importet e Kosovës gjatë vitit 2010 shënuan rritje vjetore prej 10.8 përqind, duke arritur vlerën prej 2.1 miliardë euro. Ngritja vjetore e çmimeve të produkteve të naftës në tregun ndërkombëtar për rreth 25.0 përqind gjatë vitit 2010 ndikoi deri në një masë në rritjen e vlerës së përgjithshme të importeve, kur kemi parasysh që produktet minerale paraqesin një ndër kategoritë kryesore të importeve në vend.

Tabela 8. Bilanci tregtar i Kosovës, në milionë euro


Përshkrimi	2007	2008	2009	2010
Eksportet	165.1	198.5	165.3	294.0
Importet	1,576.2	1,928.2	1,935.5	2,144.9
Bilanci tregtar	-1,411.0	-1,729.7	-1,770.2	-1,850.9
Raporti eksport/import (%)	10.5	10.3	8.5	13.7
Hapja tregtare (% e PBB-së)	51.0	55.3	54.3	59.3

Burimi: BQK (2011)


Edhe pse ngritja e çmimeve gjatë vitit 2010 ishte kryesisht me karakter global, ekonomia e Kosovës u përball me nivel më të lartë të çmimeve krahasuar me mesataren e vendeve të BE-së dhe të vendeve anëtare të CEFTA-s. Shkalla më e lartë e inflacionit në Kosovë për rreth 4.8 pp krahasuar me vendet e CEFTA-s dhe vendet në BE, ndikoi që norma reale efektive e këmbimit (*angl. Real Effective Exchange Rate: REER*) të vlerësohet në këtë periudhë. Të dhënat deri në dhjetor tregojnë se REER është vlerësuar ndaj vendeve të Eurozonës për 1.4 përqind si dhe ndaj vendeve të CEFTA-s për 2.2 përqind.

Në vitin 2009, eksportet e Kosovës u karakterizuan me një rënie të theksuar kryesisht si pasojë e krizës globale që ndikoi në masë të madhe shitjet e industrisë së metaleve, përkatësisht të xeheve të nikelit. Rimëkëmbja e ekonomisë botërore në vitin 2010 ndikoi edhe në përforsimin e kërkesës për këto metale. Si rrjedhojë, rritja e çmimit të metaleve që pasoi në vitin 2010 ndikoi në rritjen e prodhimit dhe u reflektua në rritje të vëllimit dhe vlerës së shitjeve. Duke qenë se rreth 90 përqind e metaleve të eksportuara nga Kosova janë xehe të nikelit, eksportet e Kosovës shënuan rritje vjetore prej 77.8 përqind në dhjetor 2010, duke arritur vlerën prej 294.0 milionë euro.

Struktura e importeve në vitin 2010 ishte e ngjashme me vitin paraprak (Figura 32). Mirëpo, ndryshe nga viti i kaluar kur importet e produkteve minerale (kryesisht karburanteve) shënuan rënie vjetore prej 12.5 përqind, në vitin 2010, importi i produkteve minerale shënoi rritje vjetore prej 26.5 përqind duke kontribuar kështu me rreth 4.5 pp në rritjen e gjithsej importeve. Pjesëmarrja e produkteve minerale në gjithsej importet në vitin 2010 u ngrit në 19.5 përqind (17.1 përqind në vitin 2009). Edhe kategoria e makinerive dhe pajisjeve shënoi

Figura 32. Kategoritë kryesore të strukturës së importeve, në përqindje

Burimi: BQK 2011

Figura 33. Kategoritë kryesore të strukturës së eksporteve, në përqindje

Burimi: BQK 2011

rritje vjetore prej 3.4 përqind në vitin 2010, megjithëse shënoi zvogëlim të pjesëmarrjes në gjithsej importet në 13.4 përqind (14.4 përqind në vitin 2009). Kategori të rëndësishme në importet e Kosovës mbeten edhe metalet bazë dhe produktet ushqimore, të cilat rritën pjesëmarrjen e tyre në gjithsej importet në 8.9 përkatësisht 12.2 përqind në vitin 2010.

Struktura e eksporteve në vitin 2010 u dominua nga metalet bazë, të cilat kishin një pjesëmarrje prej 63.0 përqind në gjithsej eksportet, krahasuar me 53.5 përqind në dhjetor 2009. (Figura 33). Rigjallërimi i kërkesës së jashtme dhe ngritja e çmimeve të industrisë së metaleve në nivel ndërkombëtar ndikuan në rritjen e theksuar të eksporteve të metaleve bazë, që në dhjetor 2010 arritën shumën prej 185.2 milionë euro (88.4 milionë euro në dhjetor 2009), dhe kontribuan në rritjen e gjithsej eksporteve të vendit me rreth 58.6 pp. Rritja e eksporteve gjatë vitit 2010 ishte gjithashtu kontribut i rritjes vjetore prej 55.3 përqind të eksporteve të


produkteve minerale, të cilat përfaqësuan 13.2 përqind të gjithsej eksporteve. Eksportet e makinerive dhe pajisjeve (që kryesisht përfaqësohen nga eksporti i energjisë elektrike) përfaqësuan 3.6 përqind të eksporteve të vendit. Për dallim nga viti i kaluar kur eksporti i makinerive dhe pajisjeve shënoi rënie vjetore prej 18.0 përqind, në vitin 2010 eksportet e kësaj kategorie shënuan rritje vjetore prej 48.8 përqind.

Struktura e klasifikimit të produkteve të importuara sipas qëllimit të përdorimit të tyre apo sipas Kategorive Kryesore Ekonomike (*angl. Broad Economic Categories: BEC*) ishte relativisht e njëjtë me vitin paraprak. Sipas këtij klasifikimi, kategoria më e madhe përfaqësohet nga produktet e ndërmjetme, që kanë një pjesëmarrje rreth 47.9 përqind në gjithsej importet, pasuar nga mallrat e konsumit me pjesëmarrje prej 31.1 përqind në gjithsej

importet (Figura 34). Pjesëmarrja e lartë e importit të mallrave të ndërmjetme tregon se aktiviteti prodhues në ekonominë e Kosovës mbështetet në masë të madhe nga importi i lëndës së parë nga jashtë. Gjithashtu, rritja e pjesëmarrjes së mallrave të konsumit në gjithsej importet në vazhdimësi tregon për një nivel ende të ulët të prodhimit vendor. Pjesëmarrja e mallrave kapitale në gjithsej importet është zvogëluar në 10.8 përqind në vitin 2010 nga 15.1 përqind në vitin 2009, përkundër rritjes më të shpejt të investimeve në vend në vitin 2010 krahasuar me vitin 2009.


Struktura e partnerëve tregtarë të Kosovës në vitin 2010 ishte e ngjashme me vitet e kaluara. Në vitin 2010, Kosova realizoi rreth 74.7 përqind të gjithsej shkëmbimeve tregtare me vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe vendet anëtare të CEFTA-s. Rikuperimi i

Figura 34. Importet sipas BEC-it, në përqindje



Burimi: BQK 2011

Figura 35. Struktura e eksporteve sipas partnerëve tregtarë, në përqindje



Burimi: BQK 2011

kërkesës së përgjithshme në vendet e BE-së, sidomos gjatë gjysmës së dytë të vitit 2010, ndikoi që eksportet e Kosovës drejt këtyre vendeve të shënojnë rritje më të madhe krahasuar me eksportet drejt vendeve të rajonit. Moszbatimi i marrëveshjes së CEFTA-s, për arsye politike, nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina po vazhdon të pengojë eksportet e Kosovës drejt këtyre vendeve. Përveç problemit të moszbatimit të plotë të marrëveshjes së CEFTA-s, që nga fundi i vitit 2010 Kosovës i ka përfunduar statusi i vendit të favorizuar për tregti me BE-në, gjë që do të paraqesë një tjetër pengesë për eksportet kosovare.


Vlera e eksporteve të Kosovës në BE arriti në 131.5 milionë euro në vitin 2010, që paraqet një rritje vjetore prej 84.4 përqind. Si rrjedhojë, pjesëmarrja e eksporteve të vendit në BE u rrit në 44.7 përqind, krahasuar me 43.1 përqind sa ishte në vitin paraprak (Figura 35). Në kuadër të vendeve të BE-së, Italia paraqet destinacionin kryesor për eksportet e Kosovës, me një pjesëmarrje prej 27.3 përqind në gjithsej eksportet. Pjesa më e madhe e eksporteve në Itali përbëhen nga xehet e nikelit. Rritje të pjesëmarrjes në gjithsej eksportet e Kosovës kanë shënuar edhe eksportet drejt Gjermanisë, Austrisë dhe Sllovenisë.

Shpërndarja e eksporteve të Kosovës ndërmjet vendeve të CEFTA-s në vitin 2010 ishte e ngjashme me vitin e kaluar, ndërsa pjesëmarrja e gjithsej eksporteve në vendet e CEFTA-s në gjithsej eksportet e Kosovës u zvogëlua nga 32.4 përqind në vitin 2009 në 24.1 përqind në vitin 2010. Në kuadër të vendeve të rajonit, Kosova vazhdon të eksportojë pjesën më të madhe të produkteve në Shqipëri dhe Maqedoni (11.0 përkatësisht 8.9 përqind të gjithsej eksporteve të vendit). Vlen të theksohet se përkundër pengesave të vëna nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, eksportet drejt këtyre dy vendeve kanë shënuar një rritje të lehtë në vitin 2010. Gjatë këtij viti, eksportet drejt Bosnjës dhe Hercegovinës arritën vlerën 1.9 milion euro (1.2 milion euro në vitin 2009), ndërsa eksportet drejt Serbisë në të njëjtën periudhë arritën vlerën prej 3.8 milionë euro (3.5 milion euro në vitin 2009).

Edhe sa i përket importeve, vendet e BE-së dhe CEFTA-s mbeten partnerë kryesorë tregtarë për Kosovën. Deri në dhjetor 2010, rreth 38.3 përqind e gjithsej mallrave të importuara në Kosovë ishin nga vendet anëtare të BE-së (Figura 36). Pjesa më e madhe e mallrave të importuara nga BE vijnë nga Gjermania (12.8 përqind e gjithsej importeve) dhe Greqia (4.7 përqind të importeve).

Prej vendeve të CEFTA-s, pjesa më e madhe e mallrave të importuara


Figura 36. Struktura e importeve sipas partnerëve tregtarë, në përqindje



Burimi: BQK 2011

Shpërndarja e eksporteve të Kosovës ndërmjet vendeve të CEFTA-s në vitin 2010 ishte e ngjashme me vitin e kaluar, ndërsa pjesëmarrja e gjithsej eksporteve në vendet e CEFTA-s në gjithsej eksportet e Kosovës u zvogëlua nga 32.4 përqind në vitin 2009 në 24.1 përqind në vitin 2010. Në kuadër të vendeve të rajonit, Kosova vazhdon të eksportojë pjesën më të madhe të produkteve në Shqipëri dhe Maqedoni (11.0 përkatësisht 8.9 përqind të gjithsej eksporteve të vendit). Vlen të theksohet se përkundër pengesave të vëna nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, eksportet drejt këtyre dy vendeve kanë shënuar një rritje të lehtë në vitin 2010. Gjatë këtij viti, eksportet drejt Bosnjës dhe Hercegovinës arritën vlerën 1.9 milion euro (1.2 milion euro në vitin 2009), ndërsa eksportet drejt Serbisë në të njëjtën periudhë arritën vlerën prej 3.8 milionë euro (3.5 milion euro në vitin 2009).

Figura 37. Llogaria e shërbimeve, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

janë nga Maqedonia dhe Serbia, që kanë një pjesëmarrje prej 14.7 përkatësisht 12.1 përqind në gjithsej importet e Kosovës.


Llogaria e tregtisë së shërbimeve kishte bilanc pozitiv edhe në vitin 2010, por për dallim nga vitet paraprake, bilanci i kësaj llogarie shënoi një rënie të theksuar. Në vitin 2010, bilanci i shërbimeve shënoi një vlerë prej 37.1 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 120.8 milionë euro në vitin paraprak (Figura 37). Zvogëlimi i bilancit të llogarisë së shërbimeve në këtë periudhë kryesisht reflekton rritjen më të ngadalshme të të hyrave nga shitja e shërbimeve të jorezidentët, krahasuar me rritjen që shënuan pagesat e rezidentëve Kosovar për shërbimet e blera jashtë vendit. Në vitin 2010, llogaria e shërbimeve realizoi të hyra në vlerë prej 515.0 milionë euro, një rritje vjetore prej 20.1 përqind. Në të njëjtën kohë, gjithsej pagesat për shërbimet e blera nga jashtë arritën vlerën prej 477.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 55.2 përqind. Rritja e pagesave për shërbimet e ndërtimit, më konkretisht shërbimet për ndërtimin e segmentit të parë të autostradës Morinë-Merdarë, ishin shkak kryesor për zvogëlimin e bilancit të shërbimeve në këtë periudhë. Të hyrat nga shërbimet e ndërtimit arritën vlerën prej 52.0 milionë euro (15.7 milionë euro në vitin 2009), përderisa pagesat për shërbimet e ndërtimit arritën vlerën 100.3 milionë euro (5.0 milionë në vitin 2009). Deri në dhjetor 2010, të hyrat nga shërbimet e udhëtimit shënuan rritje vjetore prej 18.2 përqind, duke përfaqësuar rreth 43.2 përqind të gjithsej të hyrave nga shërbimet. Sidoqoftë, rritja e pagesave për shërbimet e udhëtimit (kryesisht udhëtime për pushime verore) për 28.1 përqind ndikoi që bilanci i përgjithshëm i shërbimeve të udhëtimit të rritet për rreth 10.4 përqind (26.4 përqind në vitin 2009). Përveç shërbimeve të udhëtimit, komunikimit dhe shërbimeve qeveritare (shërbimet e ofruara për ambasada dhe pranisë ushtarake të NATO-s), të gjitha shërbimet tjera raportuan bilanc negativ në vitin 2010.

3.4.1.2" Të ardhurat dhe transferet rrjedhëse

Llogaria e të ardhurave në vitin 2010 regjistroi bilanc pozitiv në vlerë prej 125.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 50.7 përqind. Llogaria e të ardhurave realizoi të hyra në vlerë prej 188.4 milionë euro në vitin 2010, që paraqet një rritje prej 3.3 përqind. Në të njëjtën kohë, pagesat arritën vlerën prej 63.3 milionë euro, që përbën një zvogëlim më të theksuar prej 36.3 përqind. Kategori dominuese në kuadër të të ardhurave mbeten të hyrat nga kompensimi i punëtorëve të cilat, në vitin 2010 përfaqësuan 93.5 përqind e gjithsej të hyrave në llogarinë e të ardhurave, përderisa të ardhurat nga investimet e rezidentëve kosovarë jashtë vendit përfaqësuan 6.5 përqind të gjithsej të hyrave në këtë llogari.

Vlera e bilancit të kompensimit të punëtorëve në dhjetor 2010 ishte 171.6 milionë euro, një rritje e lehtë prej vetëm 1.7 përqind (Figura 38). Vlera e kompensimit të punëtorëve kosovarë që punojnë jashtë vendit arriti në 176.1 milionë euro në vitin 2010 (169.7 milionë

Figura 38. Bilanci i Llogarisë së të Ardhurave, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

euro në vitin 2009), ndërkaq kompensimi i punëtorëve jorezident në Kosovë në periudhën e njëjtë arriti në 4.5 milionë euro (0.9 milion euro në vitin 2009).

Në vitin 2010, si pasojë e realizimit të të hyrave në vlerë prej 12.3 milionë euro dhe pagesave në vlerë prej 58.8 milionë euro, kategoria e të ardhurave nga investimet shënoi bilanc negativ prej 46.5 milionë euro (85.7 milionë euro në vitin 2009). Të hyrat nga investimet përbëhen kryesisht nga të hyrat që janë realizuar nga investimet e institucioneve vendore në letra me vlerë në tregjet e jashtme (të hyrat nga investimet e TKPK-së,


bankave komerciale dhe investimet në letra me vlerë të BQK-së), përderisa të dalat kryesisht përbëhen nga të hyrat e realizuara nga investimet e kompanive të huaja që veprojnë në vend si bankat komerciale, ndërmarrje të tjera të huaja, etj. Të hyrat nga investimet u karakterizuan me rënie prej 4.0 përqind në vitin 2010, përderisa të dalat shënuan rënie prej 40.3 përqind. Rënia e të dalave nga investimet ishte kryesisht pasojë e tërheqjes së fitimeve nga kompanitë e huaja të cilat veprojnë në Kosovë.

Transferet rrjedhëse vazhdojnë të përfaqësojnë një kategori me rëndësi të veçantë në bilancin e pagesave të Kosovës, duke i kontribuar në vazhdimësi zbutjes së deficitit të llogarisë rrjedhëse. Bilanci i transfereve rrjedhëse arriti vlerën prej 888.9 milionë euro në dhjetor 2010, që tregon për një rritje vjetore prej 2.6 përqind. Transferet rrjedhëse të sektorit privat dominohen nga dërgesat e emigrantëve, që përfaqësojnë rreth 47.3 përqind të gjithëj transfereve të sektorit privat. Deri në dhjetor 2010, bilanci i dërgesave të emigrantëve arriti shumën prej 420.2 milionë euro, një rritje vjetore prej 6.3 përqind. Rritja e bilancit të dërgesave të emigrantëve në këtë periudhë kryesisht i atribuohet rënies më të theksuar të transfereve nga ekonomia e Kosovës, në krahasim me nivelin e transfereve hyrëse në ekonominë e Kosovës.

Përderisa vlera e gjithëj transfereve nga ekonomia e Kosovës shënoi rënie vjetore prej 17.2 përqind, vlera e gjithëj transfereve të pranuar në formë të dërgesave nga emigrantët arriti në 511.6 milionë euro (505.6 milionë euro në vitin paraprak) që paraqet një rritje vjetore prej 1.2 përqind (Figura 39). Rimëkëmbja e ekonomive të Eurozonës, ku janë të koncentruar pjesa më e madhe e emigrantëve kosovarë, pritet të ndikojë pozitivisht në nivelin e


dërgesave të emigrantëve në Kosovë, të cilat kryesisht vijnë nga Gjermania, Zvicra, Italia dhe Austria. Në të njëjtën kohë, bilanci i transfereve të sektorit qeveritar (donatorët,

Figura 39. Dërgesat e emigrantëve të pranuar në Kosovë



Burimi: BQK (2011)

Figura 40. Transferet rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: (BQK 2011)

EULEX-i dhe UNMIK-u) arriti vlerën prej 361.0 milionë euro, një rënie vjetore prej 10.1 përqind (Figura 40).

3.4.2" Llogaria kapitale dhe financiare

Llogaria kapitale dhe financiare në vitin 2010 u karakterizua me bilanc pozitiv prej 448.9 milionë euro (543.0 milionë euro në vitin 2009). Rënia prej 17.3 përqind në vitin 2010 rrjedhë nga llogaria kapitale kur merret parasysh se në vitin 2009 Kosova kishte në llogarinë kapitale 108.2 milionë euro ndërsa në vitin 2010 bilanci i llogarisë kapitale ishte 25.4 milionë euro. Ndërsa, në kuadër të llogarisë financiare, gjatë vitit 2010 bilanci pozitiv prej 423.5


milionë euro ishte më i ulët për 2.6 përqind krahasuar me vitin 2009. Ndër faktorët që ndikuan më së shumti në zvogëlimin e bilancit të llogarisë financiare ishte edhe rritja e portfolio investimet jashtë ekonomisë së Kosovës, të cilat arritën në 231.0 milionë euro. Rritja e lartë e portfolio investimeve i atribuohet rritjes së theksuar të investimeve nga ana e fondeve pensionale dhe bankave komerciale të Kosovës në tregjet e jashtme. Në anën tjetër, kategoria e "investimeve tjera" kishte ndikim pozitiv në bilancin e llogarisë financiare, gjë që i atribuohet tërheqjeve të depozitave të investuara jashtë vendit nga autoritetet monetare, bankat komerciale si dhe sektorët tjerë të ekonomisë së Kosovës. Sa i përket IHD-ve neto, në vitin 2010, niveli i tyre ishte për 10.8 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2009 (Figura 41).

3.4.2.1" Investimet e Huaja Direkte

Në vitin 2010, IHD-të e pranuar në Kosovë shënuan rritje prej 8.0 përqind krahasuar me vitin 2009. Vlera e IHD-ve në ekonominë e Kosovës, në fund vitit 2010, arriti në 314.6 milionë euro. Ndërsa, investimet e rezidentëve të Kosovës jashtë vendit u zvogëluan, duke shënuar vlerën prej 3.4 milionë euro, krahasuar me 10.5 milionë euro sa ishin në vitin 2009. Vlera neto e IHD-ve në ekonominë e Kosovës në vitin 2010 ishte 311.2 milionë euro krahasuar me 280.9 milionë euro në vitin 2009 (Figura 42).


Vështirësitë rreth qasjes së bizneseve të Kosovës në një pjesë të tregut rajonal, të përbërë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, vazhdojnë të paraqesin një sfidë të rëndësishme për ekonominë e Kosovës në tërheqjen e IHD-ve. Niveli i IHD-ve të pranuar në Kosovë ka

Figura 41. Llogaria financiare, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

Figura 42. Investimet e huaja direkte në Kosovë dhe rritja ekonomike në eurozonë



Burimi: IMF (2011) dhe BQK (2011)

ndjekur një trend të ngjashëm me performancën e ekonomive të BE-së, të cilat paraqesin burimin kryesor të IHD-ve në Kosovë (Figura 42).

Investimet kapitale janë kategoria kryesore e IHD-ve në Kosovë, përcjellë nga kategoria e investimeve tjera në kuadër të IHD-ve. Investimet kapitale të cilat përbëjnë 70.5 përqind të gjithsej IHD-ve, në vitin 2010 arritën në 221.8 milionë euro (211.1 milionë euro gjatë vitit 2009). Kategoria e investimeve tjera në kuadër të IHD-ve përbëhet kryesisht nga kreditë ndërmjet ndërmarrjeve. Kjo kategori e IHD-ve në vitin 2010 arriti në 49.5 milionë euro (23.2 milionë euro në vitin 2009). Pjesëmarrja e kategorisë së investimeve tjera në gjithsej IHD-të në Kosovë ishte 15.9 përqind në vitin 2010. Pjesëmarrje të rëndësishme në gjithsej IHD-të në Kosovë kanë edhe fitimet e pashpërndara të bizneseve të huaja që veprojnë në Kosovë. Niveli i fitimeve të pashpërndara arriti në 43.4 milionë euro (57.2 milionë euro në vitin 2009) dhe ka pjesëmarrje prej 13.8 përqind në gjithsej IHD-të.


Në vitin 2010, struktura e IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik pësoi disa ndryshime të lehta (Figura 43). Gjatë këtij viti, sektori i prodhimitarisë paraqet sektorin me më së shumti IHD të pranuar (23.0 përqind të gjithsej IHD-ve). Sektor i rëndësishëm në tërheqjen e IHD-ve është edhe sektori financiar me një pjesëmarrje prej 22.1 përqind në gjithsej IHD-të. Investimi i fitimeve të pashpërndara nga kompanitë financiare në Kosovë përbënë pjesën më të madhe të këtyre investimeve. Sektorë tjerë të rëndësishëm për tërheqjen e IHD-ve paraqesin edhe sektorët e patundshmërisë (15 përqind të gjithsej IHD-ve) dhe sektori i industrisë së ndërtimit (15 përqind të gjithsej IHD-ve).

Origjina e investitorëve të huaj në Kosovë është kryesisht nga vendet e BE-së. Gjermania vazhdon të jetë vendi prej ku vijnë më së shumti IHD, pasuar nga Sllovenia që paraqet vendin e dytë për nga vëllimi i investimeve në Kosovë. Pjesëmarrje të konsiderueshme në nivelin e përgjithshëm të IHD-ve në Kosovë gjithashtu kanë Austria dhe Kina (Figura 44).

3.4.2.2 Portfolio investimet, investimet tjera dhe asetet rezervë


Portfolio investimet jashtë vendit shënuan rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2010, duke arritur vlerën prej 231.0 milionë euro (56.5 milionë euro në vitin 2009), prej të cilave 66.9 përqind janë investime të bëra nga ana e fondeve pensionale, ndërsa pjesa prej 33.1 përqind

Figura 43. Struktura e IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK (2011)

Figura 44. Investimet e huaja direkte sipas vendit të origjinës



Burimi: BQK (2011)

janë investime të bankave komerciale që operojnë në Kosovë. Këto mjete kryesisht janë të investuara në instrumente të tregut monetar (p.sh. letra me vlerë), ndërsa një pjesë më e vogël e tyre është investuar edhe në instrumente tjera në tregun e kapitalit. Stabilizimi i tregjeve globale financiare mund të konsiderohet si faktori më i rëndësishëm që ka ndikuar në rritjen e portfolio investimeve jashtë vendit gjatë vitit 2010.

Bilanci i kategorisë së 'investimeve tjera' në vitin 2010 ishte 390.4 milionë euro, krahasuar me 116.2 milionë euro në vitin 2009. Asetet në kuadër të investimeve tjera përbëjnë 62.1 përqind të gjithsej investimeve, ndërsa detyrimet 37.9 përqind. Rritje e konsiderueshme në kuadër të investimeve tjera u shënuar në kuadër të asetëve, si rezultat i rritjes së investimeve jashtë vendit, investime të cilat kryesisht janë orientuar në instrumente të tregjeve monetare nga bankat, institucionet monetare si dhe sektorët tjerë të ekonomisë së Kosovës. Sa i përket detyrimeve, ato vazhdojnë të dominohen nga kreditë tregtare, të cilat përbëjnë 43.1 përqind të gjithsej detyrimeve në kuadër të kategorisë së investimeve tjera. Deri në fund të vitit 2010, vlera e kredive tregtare ishte 63.7 milionë euro që në krahasim me vitin paraprak paraqet rënie prej 39.9 përqind. Rënia në kuadër të kredive tregtare mund të jetë edhe indikator i aftësisë më të mirë paguese të kompanive kosovare gjatë vitit 2010 në krahasim me vitin 2009. Asetet rezervë të Kosovës deri në fund të vitit 2010 shënuan ngritje për 46.9 milionë euro.

4. Mbikëqyrja e Institucioneve Financiare

Që nga themelimi, BQK-ja ka autoritet licencues, rregullator dhe mbikëqyrës për të gjitha institucionet financiare në Kosovë dhe si e tillë ajo kontribuon në zhvillimin dhe modernizimin e sektorit financiar në Kosovë. Aktualisht, sektori financiar i vendit tonë përbëhet nga industria bankare, industria e sigurimeve, fondet pensionale dhe institucionet tjera financiare (institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jobankare, zyrat e këmbimit të valutave dhe të pagesave, si dhe institucionet për transferin e parave).

Edhe në vitin 2010, duke marrë gjithnjë për bazë standardet më të mira ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit financiar, BQK-ja ka vazhduar së investuari në ngritjen e efektivitetit dhe eficiencës së licencimit, rregullativës dhe mbikëqyrje financiare me synim të promovimit të mëtejme të një sektori financiar konkurrues dhe të bazuar në ekonominë e tregut.

Duke u bazuar në parimet bazë të Baseli-it për mbikëqyrje efektive të sistemit bankar, në vitin 2010, janë bërë hapa drejt ngritjes së kapaciteteve për mbikëqyrje të bazuar në profilin e rrezikut në sistemin bankar duke synuar sinergjinë mbikëqyrëse që pritet të reflektojë koordinimi më efektiv i mbikëqyrjes mikrprudenciale dhe asaj makroprudenciale. Gjithashtu, me qëllim të përcaktimit sa më të drejtë të aftësisë paguese të bazuar në rrezik, edhe tek industria e sigurimeve janë bërë hapa të mirë drejt adoptimit të parimeve bazë të parapara me kornizën e Solvencës II që qartëson.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e caktuar me ligjin e saj, BQK-ja në vitin 2010 ka iniciuar rishikimin e legjislacionit të të gjithë sistemeve kryesore përbërëse të sektorit financiar. Ligji mbi sistemin e sigurimit të depozitave në Kosovë është aprovuar në fund të vitit 2010, ndërsa operacionalizimi i Fondit të Sigurimit të depozitave do të kompletohet në vitin 2011. Gjithashtu, janë draftuar versionet e para të Ligjit mbi bankat komerciale, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet tjera financiare jobankare, pastaj draft-ligji mbi sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia, draft-ligji mbi sigurimet e përgjithshme dhe është punuar në amandamentimin e ligjit mbi pensionet.

4.1. Licencimi dhe Metodologjia

Një nga funksionet kryesore të BQK-së është që të sigurojë mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare, me qëllim të krijimit të një sistemi financiar të shëndoshë, të qëndrueshëm, konkurrues dhe të besueshëm dhe i cili ofron një sferë të gjerë të shërbimeve financiare. Në kryerjen e këtij misioni, përgjegjësia direkte bie mbi drejtoratet si ai i licencimit dhe metodologjisë, i mbikëqyrjes së bankave dhe ai i mbikëqyrjes së sigurimeve dhe pensioneve.

4.1.1. Licencimi

Kriteret dhe kushtet për të marrë licencë për kryerjen e veprimtarive bankare dhe financiare nga bankat dhe institucionet tjera financiare në Republikën e Kosovës janë të përcaktuara në Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës nr. 03/ L-209 dhe me aktet tjera nënligjore të nxjerra nga BQK-ja. Në përputhje me legjislacionin që drejton funksionin e saj statusor, BQK-ja ka autoritetin për të vendosur kriteret për licencimin e institucioneve financiare dhe për të refuzuar ato të cilat nuk i përmbushin këto standarde.

Kriteret e licencimit të përcaktuara me legjislacion, synojnë sigurimin e një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar nëpërmjet një procesi të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve. Hyrja e

investitorëve të huaj në tregun financiar të vendit dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja, pa i cenuar kërkesat ligjore.

Strategjia e BQK-së në fushën e licencimit të institucioneve financiare përqendrohet në tërheqjen e investitorëve të cilët kanë gjendje të mirë financiare, përmbushin kriteret etike dhe profesionale të nevojshme dhe të përshtatshme për aksionarë dhe menaxhment, të janë të aftë të drejtojnë një qasje në zhvillimin e matur të biznesit për të mbrojtur interesat e klientëve, duke ndihmuar në këtë mënyrë forcimin e sistemit financiar dhe rritjen e besueshmërisë ndaj tij.

Drejtoriati i licencimit dhe metodologjisë, në punën e tij të licencimit dhe rregullimit të bankave komerciale, të kompanive të sigurimit, të ndërmjetësuesve, të fondeve pensionale suplementare dhe të institucioneve tjera financiare jobankare, udhëhiqet nga parime që janë në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian dhe praktikat e mira ndërkombëtare ashtu siç janë të prezantuara në “Principet Themelore të Mbikëqyrjes Efektive Bankare” të publikuara nga Banka për Rregullim Ndërkombëtar (*anglisht: Bank for International Settlements- BIS*), si dhe Principet Themelore të Mbikëqyrjes Efektive të Sigurimeve të publikuara nga Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (*anglisht: International Association of Insurance Supervisors- IAIS*).

Aktiviteti i licencimit të mbikëqyrjes financiare gjatë vitit 2010 kryesisht ka përfshirë ndryshimet në hapje të degëve të reja të bankave dhe institucioneve tjera financiare në Kosovë, ndryshime në strukturën e pronësisë dhe të kapitalit aksionar të bankave dhe të kompanive të sigurimeve, shtim të veprimtarive dhe të produkteve bankare dhe të sigurimeve, ndryshime në aktet normative siç janë statutet e bankave dhe të kompanive të sigurimeve, ndryshime dhe emërime të reja të administratorëve dhe menaxhmentit të lartë të bankave dhe të kompanive të sigurimeve, zgjerim të rrjetit të zyrave të këmbimit të valutave si zgjerimin e rrjetit të zyrave për transfer të parave.

Bankat dhe kompanitë e sigurimeve kanë punuar vazhdimisht në zgjerimin e aktivitetit të tyre në drejtim të diversifikimit të produkteve bankare dhe siguroese duke ofruar më mundësi edhe më të shumta investimi dhe zgjedhje të shumta për klientët e tyre. vitit 2010 kanë vazhduar të ushtrojnë aktivitetin e tyre në tregun bankar tetë (8) banka me 312 degë dhe nëndegë bankare, ndërsa në tregun e sigurimeve njëmbëdhjetë (11) kompani të sigurimeve, dhjetë (10) kompani të sigurimit jojetë dhe një kompani e sigurimit të jetës.

Bordi Drejtues i BQK-së gjatë vitit 2010 ka aprovuar licencën preliminare të kompanisë së sigurimeve “Grawe Kosova” për sigurim të jetës, si dhe ndryshimin në strukturën e pronësisë së kompanisë së sigurimeve “Dardania”.

a) Institucionet Mikrofinanciare

Në fund të vitit 2010 në Kosovë kanë operuar trembëdhjetë (13) institucione mikrofinanciare dhe tetë (8) institucione jobankare financiare. Gjatë vitit 2010, me kërkesën e institucioneve dhe në pajtim me rregullativën ligjore në fuqi, iu është tërhequr regjistrimi i “Cordaid” si institucion mikrofinanciar me seli në Gjakovë dhe “PTK” si institucion financiar jobankar me seli në Prishtinë.

b) Ndërmjetësuesit e Sigurimeve

Në fund të vitit 2010 kanë operuar katër (4) ndërmjetësues të sigurimeve. Me kërkesën e institucioneve dhe në pajtim me rregullativën ligjore në fuqi iu është tërhequr licenca e Ndërmjetësuesit të Sigurimeve “Intel Broker” dhe “Intel Service” me seli në Prizren, “Incoming” Sh.p.k dhe “Nic Holding” Sh.p.k me seli në Prishtinë.

c) Zyrat e Këmbimit të Valutave dhe Zyrat e Transferit të Parave

Gjatë vitit 2010 Bordi Ekzekutiv i BQK-së aprovoi regjistrimin e tre (3) Zyrave të Këmbimit për aktivitete të këmbimit të valutave: “Kujtimi” në Pejë, “Adis” në Prizren dhe “Aral” në Shtime. Në fund të vitit 2010 , kanë operuar në Kosovë njëzetegjashtë (26) zyra të këmbimit të valutave dhe tre (3) agjensione të transferit të parave.

Tabela 9. Aktiviteti i Licencimit të Bankave, 2006 – 2010

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009	2010
Të Licensuara më parë	7	8 ^[1]	8	9	8
Aprovime Preliminare *	2	1	1	0	0
Revokim/Tërheqje e Licencës	-1	0	0	-1	0
Refuzuar	1	0	0	0	1
Totali	8	9	9	8	8

[1] Bashkimi i bankave NLB-KSB dhe NLB-BRK ka qenë efektiv me 2 Janar 2008

Burimi: BQK 2011

Tabela 10. Aktiviteti i Licencimit të Kompanive të Sigurimeve, 2006 – 2010

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009	2010
Të Licensuara më parë	8	9	9	11	11
Aprovime Preliminare	1	0	2	0	1
Refuzuar	0	0	0	0	1
Totali	9	9	11	11	12

Burimi: BQK 2011

Tabela 11. Aktiviteti i Licencimit të Fondeve Pensionale, 2006 – 2010

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009	2010
Fondet Pensionale të detyrueshme	1	1	1	1	1
Fondet pensionale Suplementare	6	1	0	0	0
Ofruesit e pensioneve individuale	1	2	1	1	1
Totali	8	4	2	2	2

Burimi: BQK 2011

Tabela 12. Aktiviteti i regjistrimit të Institucioneve Mikrofinanciare dhe Jo bankare Financiare, 2006– 2010

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009	2010
Të Regjistruara më parë	19	18	19	22	20
Regjistruara	1	1	4	0	0
Tërheqja e Regjistrimit	-2	0	-1	-2	-2
Totali	18	19	22	20	18

Burimi: BQK 2011

Tabela 13. Aktiviteti licencues i Ndërmjetësuesve të Sigurimit, 2006-2010

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009	2010
Agjentët/operatorët	784	347	479	528	679
Brokerët e Sigurimit	2	2	2	4	3
Trajtuesit e dëmeve	2	2	3	4	1

Burimi: BQK 2011

Tabela 14. Aktiviteti i Regjistrimit të Agjensioneve për Transfer të Parave, 2006 – 2010

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009	2010
Të regjistruara më parë	2	3	3	3	3
Regjistruara	1	0	0	0	0
Totali	3	3	3	3	3

Burimi: BQK 2011

Tabela 15. Aktivitet e Regjistrimit të Zyreve për Këmbim të Valutave, 2006 – 2010

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009	2010
Të regjistruara më parë	6	16	23	21	23
Regjistruara	10	7	0	2	3
Tërheqja e Regjistrimit	0	0	-2	0	0
Totali	16	23	21	23	26

Burimi: BQK 2011

4.1.2 Metodologjia

Procesi i plotësimit të kornizës ligjore në fushën e rregullimit të mbikëqyrjes financiare ka vazhduar të rishikohet dhe freskohet, për të siguruar një mbikëqyrje efektive financiare në përputhje me zbatimin e parimeve dhe standardeve të Komitetit të Bazelit, direktivave të Komisionit Evropian dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Qëllimi i plotësimit të rregulloreve dhe rregullave përkatëse është për të siguruar krijimin e një mjedisi të rregulluar mirë, pa vendosur ngarkesa të panevojshme për përdoruesit e shërbimeve financiare.

Me qëllim të rishikimit të rregulloreve të mbikëqyrjes financiare, duke u bazuar edhe në mbështetjen e asistencës teknike, është themeluar Komisioni për përgatitjen e kornizës së re rregullative dhe mbikëqyrëse sipas standardeve të reja të Komitetit të Bazelit për mbikëqyrje bankare. Komisioni për Bazel ka hartuar planin e detajuar të veprimeve për realizimin e projekteve të veçanta sipas prioriteteve të caktuara nga mbikëqyrja bankare. Kështu që, janë themeluar grupe punuese brenda mbikëqyrjes financiare që të punojnë në mënyrë aktive për plotësimin e rregulloreve përkatëse dhe draftimin e politikave dhe procedurave të brendshme. Në bashkëpunim me asistencën teknike të siguruar nga FMN-ja është punuar në draf-ligj mbi licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave, projekt ky që pritet të finalizohet gjatë të vitit 2011.

4.2. Mbikëqyrja Bankare

Sistemi bankar i Kosovës vijoi me rritje të qëndrueshme edhe gjatë vitit 2010, mirëpo me një ritëm më të ngadalshëm krahasuar me vitin 2009. Vlera e gjithsej mjeteve të sistemit bankar arriti në 2.237 miliardë euro. Gjithsej mjetet u rritën për rreth 11.0 për qind për dallim nga niveli i rritjes së vitit të kaluar prej 21.5 për qind.

Rritja më e ngadalshme e nivelit të mjeteve në vitin aktual i atribuohet kryesisht rritjes më të ngadalshme të depozitave, të ndikuar në masë të madhe nga tërheqja në emër të dividendës të depozitave të PTK-së prej llogarive bankare dhe kreditimi i llogarisë së Thesarit (Ministria e Ekonomisë dhe Financave) me 233¹⁴ milionë euro gjatë vitit 2010.

Në vitin 2010 ritëm më të shpejt rritjeje të gjithsej mjeteve patën banka të klasifikuara të mesme dhe të vogla krahasuar me bankat e mëdha (sistemo). Bankat e vogla (G3)¹⁵ shfaqën nivel më të lartë të rritjes me rreth 39.7 milionë euro ose 45.3 për qind, të pasuara nga bankat e mesme (G2)¹⁶ për të cilat kjo rritje përlllogaritet në rreth 95.7 milionë euro ose 31.6 për qind dhe bankat e mëdha (G1)¹⁷ me rritje rreth 95.8 milionë euro ose 5.6 për qind. Pas këtyre ndryshimeve, pjesëmarrja e bankave të mesme (G2) dhe të vogla (G3) në gjithsej mjetet e sistemit bankar është rritur në 17.1 respektivisht 5.5 për qind nga 14.4 dhe 4.2 për qind sa ishte në 2009, ndërsa pjesëmarrja e bankave të mëdha ka rënë nga 81.4 për qind sa ishte në vitin 2009 në 77.4 për qind në vitin 2010.

Ndryshimet e lartpërmendura shtojnë vlerë konkurrencës ndërbankare duke shtuar ndikimin e bankave të mesme dhe të vogla në sistem. Këtyre ndryshimeve gjatë vitit i është adaptuar edhe aktiviteti mbikëqyrës duke shtuar fokusin e monitorimit të performancës financiare dhe ekzaminimeve më të shpeshta në grup-bankat me ritëm më të shpejtë të rritjes.

¹⁴ Në këtë shumë nuk është i përfshirë interesi i fituar

¹⁵ Përfshin bankat që marrin pjesë në treg <3% të totalit të mjeteve.

¹⁶ Përfshin bankat që marrin pjesë në treg prej 3%-10% të totalit të mjeteve.

¹⁷ Përfshin bankat që marrin pjesë në treg >10% të totalit të mjeteve.

a) Njësia e Ekzaminimeve nga Jashtë

Konform detyrave dhe përgjegjësive, njësia e ekzaminimeve nga jashtë është angazhuar në monitorimin e vazhdueshëm të profilit të rrezikut të institucioneve financiare. Raportet dhe analizat periodike¹⁸ mbi zhvillimet e institucioneve financiare ndihmuan në identifikimin e fushave për vëmendje me të theksuar të mbikëqyrjes. Mbi këtë bazë është realizuar shpërndarja e resurseve dhe me këtë fokusi i aktivitetit mbikëqyrës ndaj institucioneve financiare.

Edhe gjatë vitit 2010 në vazhdimësi është monitoruar tendenca e indikatorëve me frekuencë të lartë, me fokus të veçantë në kontrollin e niveleve të likuiditetit pas tërheqjes së 233 milion euro nga ana e Thesarit, në emër të dividendës së PTK-së. Vëmendje e theksuar i është kushtuar edhe performancës së bankave amë, në kontekst të filialeve dhe degëve të bankave që operojnë në Kosovë për të siguruar me kohë informacionet mbi ndikimin e mundshëm nga bankat amë. Këtë vit i është kushtuar vëmendje e posaçme e edhe ekspozimeve kreditore të bankave komerciale jashtë vendit.

b) Njësia e Ekzaminimeve në Vend

Gjatë vitit 2010 u kryen 14 ekzaminime të plota dhe 16 të fokusuara të institucioneve financiare.

Tabela 16. Ekzaminimet e kryera nga mbikëqyrja bankare gjatë vitit 2010

Institucionet financiare – Inspektimet e plota dhe të fokusuara		
Përshkrimi	I plotë	I fokusuar
Banka	8	13
Institucionet Mikrofinanciare	3	1
Institucionet financiare jobankare	3	2
Gjithsej	14	16

Burimi: BQK 2011

Me gjithë përkeqësimin e cilësisë së portofolit kreditorë (rritja e kredive joperformuese nga 4.4 për qind në dhjetor 2009 në 5.9 për qind në dhjetor 2010) dhe nevojës së ruajtjes së niveleve të likuiditetit pas tërheqjes së fondeve të PTK-së, sistemi bankar vazhdoi të jetë likuid, profitabil dhe mirë i kapitalizuar. Ekzaminimet e kryera gjatë vitit janë fokusuar kryesisht në mënyrën e menaxhimit të rreziqeve bankare, me theks të veçantë në rrezikun kreditorë dhe atë të likuiditetit. Nga bankat u kërkua të sigurojnë plane kontingjente të likuiditetit dhe qasje në burime shtesë të financimit në rast se do ishte e nevojshme.

c) Profili i Sistemit Bankar

Në vitin 2010, gjithsej mjetet u rritën rreth 231 milionë euro ose 11.0 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Zërat kryesorë të mjeteve të sistemit bankar evidentuan ndryshimet si më poshtë :

“Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK” shënoi rënie me rreth 14.6 milionë euro ose 4.5 për qind, respektivisht paraja e gatshme shënoi rritje me rreth 15 milionë euro ose 16.8 për qind, ndërsa gjendja me BQK evidentoi rënie për 29.6 milionë euro ose 12.7 për qind. Pas këtij ndryshimi pjesëmarrja e zërit ”paraja e gatshme dhe gjendja me BQK” në kuadër të

¹⁸ Javore, Mujore, Tremujore dhe Gjysmë-vjetore

gjithsej mjeteve te sistemit bankar ka rënë nga 15.4 për qind sa ishte në vitin e kaluar në 13.2 për qind në vitin 2010.

“Kërkesat ndaj bankave/plasmanët” regjistruan rritje me rreth 15.1 milionë euro ose 3.6 për qind krahasuar me vitin e mëparshëm. Megjithatë, rritja e plasmaneve ishte dukshëm më e ngadalshme krahasuar me vitin e kaluar, kur këto ishin rritur me rreth 140 milionë euro ose 49.3 për qind. Rritja më e ngadalshme e plasmaneve ka zvogëluar peshën e tyre në kuadër të totalit të aktivitetit nga 20.2 për qind sa ishte në vitin paraprak në 18.9 për qind në vitin 2010. Rritja më e shpejtë e plasmaneve në vitin paraprak ishte ndikuar kryesisht nga qasja më konservative e bankave në lejimin e kredive të reja, e cila kishte rrjedhur nga vlerësimi rreth ndikimit që mund


të kishte kriza globale financiare në kushtet ekonomike në përgjithësi dhe efektit të saj direkt në kthimin e kredive. Ngjashëm me vitin paraprak edhe gjatë vitit 2010, BQK-ja ishte aktive në ndjekjen e qasjes më konservative për sa u takon limiteve ekzistuese të ekspozimeve të bankave në institucionet financiare jashtë vendit. Nga ky aspekt në të shumtën e rasteve iu është refuzuar kërkesa bankave për të

rritur nivelet e plasmanëve në kuadër të një institucioni mbi limitin 20 për qind të kapitalit të klasit të I.. Kjo politikë (e aplikuar në vitin 2009, e vazhduar edhe në vitin 2010) iu imponua BQK-së duke marrë për bazë rrethanat e reja të cilat ishin krijuar në tregjet globale financiare si rezultat i krizës që i pat përfshirë tregjet botërore financiare.

Investimet në letrat me vlerë është zëri i aktivitetit i cili shënoi rritjen më të lartë krahasuar me vitin e kaluar, përkatësisht për 76.4 milionë euro ose 78.8 për qind. Kjo prirje e rritjes së nivelit të letrave me vlerë i atribuohet kryesisht rënies së peshës së parave të gatshme dhe gjendjes me BQK dhe Plasmanëve me bankat tjera në kuadër të aktivitetit, si dhe përmirësimit të kushteve në tregjet financiare ndërkombëtare gjatë vitit 2010. Kjo ka ndikuar që pjesëmarrja e letrave me vlerë në kuadër të aktivitetit të rritet nga 4.6 për qind sa ishte në vitin e kaluar në 7.5 për qind në vitin aktual.


“Kreditë (Bruto) dhe lizingjet” shënuan rritje me rreth 170.4 milionë euro ose 13.5 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Rritja e kredive në vitin aktual vazhdoi me një trend më të shpejtë krahasuar me vitin paraprak, duke shënuar rritje me 13.5 për qind, përderisa në vitin e kaluar rritja ishte 9.2 për qind. Rritja më e shpejtë e kredive gjatë vitit aktual u reflektua me rritjen e pjesëmarrjes së totalit të kredive (neto) në kuadër të totalit të aktivitetit nga 56.6 për qind sa ishte në vitin e kaluar në 57.5 për qind në vitin aktual.

Figura 45. Vlera e aseteve në sektorin bankar - aktivitet gjithsej, në mijëra euro



Burimi: BQK (2011)

Figura 46. Trendi i kredive në sektorin bankar - gjithsej kreditë, në mijëra euro




Burimi: BQK (2011)

Gjatë vitit 2010 kreditë e klasifikuara “standard” u rritën për 154.5 milionë euro ose 13.6 për qind, ndërsa kreditë e klasifikuara “vrotuese” u zvogëluan për 20.2 milionë euro ose 43.6 për qind. Në të njëjtën kohë, kreditë e klasifikuara “nën-standard” u rritën për 6.9 milionë euro ose 23.0 për qind, ndërsa kreditë e klasifikuara “të dyshimta” u rritën për 18.6 milionë euro ose 118.4 për qind. Kreditë e klasifikuara në “humbje” u rritën për 10.7 milionë euro ose 27.0 për qind.

Si rezultat i zhvillimeve të theksuara më lartë, treguesit e kualitetit të kredive shënuan këto ndryshime: “kreditë me vonesa^{19/} totali i kredive” u zvogëluan nga 10.4 për qind sa ishin në vitin 2009 në 10.3 për qind në vitin 2010, “kreditë me probleme^{20/} totali i kredive” u rritën nga 6.7 për qind në 8.5 për qind, ndërsa “kreditë joperformuese^{21/} totali i kredive” evidentuan rritje nga 4.4 për qind në 5.9 për qind. Këto zhvillime në kualitetin e kredive kanë ndikuar në rritjen e rezervës për kredi krahasuar me vitin e kaluar për 18.7 milionë euro ose 23.9 për qind.

Figura 47. Trendi i depozitave në sistemin bankar - gjithsej depozita, në mijëra euro



Burimi: BQK (2011)

Burimet e financimit (pasivet) e sistemit bankar evidentojnë këto ndryshime sipas zërave :

“Gjithsej Depozitat ” shënuan rritje me rreth 178.6 milionë euro ose 10.2 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Depozitat pa interes u rritën për 141.3 milionë euro ose 36.9 për qind, ndërsa depozitat me interes u rritën për 37.2 milionë euro ose për 2.7 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Në kuadër të strukturës së depozitave pa interes janë shënuar këto ndryshime : depozitat nga bankat u zvogëluan për 3.8 milionë euro ose 52.9 për qind, ato nga individët u rritën për 52.1 milionë euro ose 22.4 për qind, ndërsa depozitat nga ndërmarrjet u rritën për rreth 93.2 milionë euro ose 65.5 për qind.

Ndërsa në kuadër të strukturës së depozitave me interes janë shënuar këto ndryshime : depozitat nga bankat u rritën për rreth 253 mijë euro ose 8.0 për qind, depozitat nga individët u rritën për rreth 220.1 milionë euro ose 26.5 për qind dhe depozitat nga ndërmarrjet u zvogëluan për 183.1 milionë euro ose për 34.2 për qind.

Depozitat ruajnë peshën e lartë që pozicioni i tyre ka në kuadër të pasivit. Në vitin aktual pjesëmarrja e totalit të depozitave në kuadër të totalit të detyrimeve të sistemit bankar evidentohet rreth 92.2 për qind.

d) Struktura e Kapitalit Rregullativ – Norma e Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Totali i kapitalit rregullativ²² në sistemin bankar vazhdoi me trendin e rritjes edhe gjatë vitit aktual. Vlera e totalit të kapitalit rregullativ raportohet rreth 271.4 milionë euro, që paraqet një rritje në shumë absolute prej rreth 30.1 milionë euro ose 12.5 për qind krahasuar me vitin 2009, ku kontributin kryesorë e dhanë fitimet e realizuara gjatë vitit në

¹⁹ Kreditë me vonesa përfshijnë kreditë e klasifikuara : vrotuese, nën-standard, të dyshimta dhe kreditë humbje.

²⁰ Kreditë me probleme përfshijnë kreditë e klasifikuara : nën-standard, të dyshimta dhe kreditë humbje.

²¹ Kreditë joperformuese përfshijnë kreditë e klasifikuara : të dyshimta dhe kreditë humbje.

²² Kapitali rregullator = kapitali i klasit të parë + kapitali i klasit të dytë

vlerë prej 32.9 milionë euro. Në vitin 2010 tre (3) nga bankat e sistemit shpërndan dividendë aksionarëve nga fitimet e pashpërndara të viteve të kaluara në vlerë prej 18 milionë euro nga të cilat 5 milionë u rikapitalizuan. Gjatë vitit, disa nga bankat komerciale shtuan kapital të freskët në vlerë prej 5 milionë euro si dhe kapital të klasit të II-të përmes borxheve të ndërvarura në vlerë prej 6.5 milionë euro.

Rritja e vazhdueshme e nivelit të kapitalit rregullativ ka bërë që sistemi bankar të ketë tregues shumë të mirë të mjaftueshmërisë së kapitalit, duke shënuar nivele më të larta se sa niveli minimal i kërkuar nga ana e BQK-së. Treguesit kryesorë të mjaftueshmërisë së kapitalit, përkatësisht “kapitali i klasit të I / gjithsej mjetet e rrezikuara” dhe “gjithsej kapitali / gjithsej mjetet e rrezikuara” në vitin 2010 evidentohen 15.6 respektivisht 18.7 për qind, nga 15.0 dhe 18.0 për qind sa ishin në vitin 2009. Rritja e treguesve të kapitalizimit i atribuohet rritjes së totalit të kapitalit me një ritëm më të shpejt krahasuar me rritjen e totalit të mjeteve të rrezikuara. Përderisa totali i kapitalit evidentoi rritje me rreth 30.1 milionë ose 12.5 për qind (përkrahur nga rritja e vazhdueshme e fitimeve), totali i mjeteve të rrezikuara u rrit me rreth 113.9 milionë euro ose 8.5 për qind (rezultuar nga rritja e vazhdueshme e nivelit të kredive dhe investimeve në letra me vlerë dhe plasmane) krahasuar me vitin 2009.

e) Likuiditeti i Sistemit Bankar

Sistemi bankar në përgjithësi vazhdoi të ketë tregues të kënaqshëm të likuiditetit, edhe pse krahasuar me vitin e kaluar ky tregues reflekton një tendencë të rënies. Në vitin 2010, treguesit, “mjete likuide / totali i mjeteve” dhe “mjete likuide / totali i depozitave” përlogariten 37.3 dhe 45.0 për qind, krahasuar me 38.8 dhe 46.4 për qind sa ishin në vitin 2009. Kjo ka ardhur kryesisht si rezultat i trendit të rritjes më të ngadalshme të totalit të depozitave, të ndikuar në masë të madhe nga tërheqja e cekur më parë e dividendës së PTK-së si dhe nga rritja më e shpejtë e totalit të kredive.

f) Profitabiliteti i Sistemit Bankar

Rezultati i profitit neto i sistemit bankar në fund të 2010, raportohet rreth 32.9 milionë euro, i cili krahasuar me vitin 2009 është për 5.5 milionë euro ose 20.0 për qind më i lartë. Faktorët kryesorë të cilët kanë ndikuar në rritjen e fitimeve ishin : rritja e të hyrave nga interesi me një ritëm më të shpejt krahasuar me vitin 2009, respektivisht me 11.2 milionë euro ose 6.8 për qind si dhe rritja e neto të hyrave nga provizionet me rreth 4.0 milionë euro ose 15.7 për qind krahasuar me vitin 2009. Faktorët e cekur më lartë ndikuan në përmirësimin e treguesve të profitabilitetit, respektivisht kthimi nga mjetet mesatare (ROAA) dhe kthimi nga kapitali mesatar (ROAE) evidentuan trend të rritjes së lehtë, nga 1.5 për qind dhe 13.9 për qind sa ishin në fund të vitit 2009 në 1.5 për qind dhe 14.9 për qind në fund të vitit 2010.

g) Banka Kreditore e Prishtinës në likuidim

Procesi i likuidimit të bankës kreditore ka vijuar edhe gjatë vitit 2010. Deri në fund vitin 2010 janë rimbursuar gjithsej 50.92% e shumës së depozitave, respektivisht 99.80% e numrit të llogarive të depozitave.

Procesi i likuidimit është mundësuar nga arkëtimet e kredive. Gjatë vitit 2010 nga kreditë janë arkëtuar gjithsej 1,044 mijë euro.

Perspektiva e procesit të likuidimit të bankës varet tani nga faktorë të jashtëm, kryesisht blerësit potencial dhe efikasiteti i sistemit gjyqësor për të mundësuar rritjen e arkëtimeve nga ekzekutimi i kolateraleve.

h) Performanca e Institucioneve Mikrofinanciare

Numri i Institucioneve Mikrofinanciare (IMF) dhe Institucioneve Jobankare (IJB) që për aktivitet kanë kredidhënien, në fund të vitit 2010, ishte shtatëmbëdhjetë (17).

Portofoli aktiv i kredive në fund të vitit 2010 ishte 115.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.5 milionë euro ose 5.9 për qind. Kreditë, si aktiviteti kryesorë i këtyre institucioneve përbëjnë rreth 92.7 për qind të gjithsej aktivitetit. Portofoli kreditorë gjatë vitit 2010 evidentoi ecuri të përkeqësimit të cilësisë. Treguesit e cilësisë së kredive, përkatësisht raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredive dhe raporti i kredive joperformuese ndaj totalit të kredive evidentojnë nivele prej 4.4 për qind dhe 3.6 për qind përderisa në fund të vitit të 2009 evidentonin 3.1 përqind respektivisht 2.6 për qind. Gjithashtu, për shkak të dobësive të evidentuara në qeverisjen korporatave, BQK-ja në fillim të vitit 2011, ka qenë e detyruar të caktojë një administrator të përkohshëm në njërin nga këto institucione.

Lëvizje negative gjatë vitit 2010 në sektorin mikrofinanciar vërehet edhe në treguesit e profitabilitetit. Kthimi nga mjetet mesatare (ROAA) dhe kthimi nga kapitali mesatar (ROAE) shënojnë nivele negative prej minus 1.6 për qind, respektivisht minus 5.5 për qind. Këta tregues shënuan rënie të ndjeshme krahasuar me nivelet prej 1.4 për qind, respektivisht 4.3 për qind të vitit të kaluar nga ndikimi i rritjes së ndjeshme të shpenzimeve të provizioneve për humbjet nga kreditë, rritje vjetore prej 3.5 milionë euro ose prej 117.6 për qind.

i) Bashkëpunimi me Autoritet tjera Rregullative dhe Mbikëqyrëse

Bashkëpunimi me autoritetet rregullative dhe mbikëqyrëse të huaja është vazhduar me intensitet më të theksuar. Kështu është realizuar ekzaminim i përbashkët i bankës përkatëse me kolegë nga Agjensioni i Mbikëqyrjes dhe Rregullimit të Bankave nga Turqia ("BRSA"), është bërë shkëmbimi i raporteve mbikëqyrëse (anglisht: *supervisory newsletter*) në bazë tremujore me Agjencionin për Mbikëqyrje Financiare në Austri ("FMA"), pastaj shkëmbimin i ndërsjellë i informacionit me Bankën Qendrore të Sllovenisë, Bankën e Shqipërisë, komunikimi dhe kooperimi me Agjencionin Federal të Mbikëqyrjes Financiare në Gjermani (BaFin) në lidhje me inicimim e arritjes së Memorandumit të Mirëkuptimit mes dy institucioneve i cili pritet të nënshkruhet në fillim të vitit 2011.

Në këtë rast vlen edhe të theksohet se projekti i Bankës Qendrore Evropiane për forcimin e mbikëqyrjes makro dhe mikro-prudenciale i ka shtuar vlerë ngritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse, sikundër që i ka kontribuar shkëmbimit të përvojave dhe shpaltosjes së njohurive për praktikën dhe standardet më të mira për mbikëqyrje financiare. Përndryshe, ky projekt do vazhdojë së zbatuari gjatë vitit 2011 me komponentin e dytë ku BQK-ja do përfitojë asistencë teknike në pasurimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm dhe makro "stres-test"-it, si dhe komponentin e tretë për të vënë në pah aspektin e bashkëpunimit ndër shtetëror me autoritetet tjera mbikëqyrëse duke simuluar raste krizash.

4.3. Mbikëqyrja e Sigurimeve

Gjate vitit 2010 në tregun e industrisë së sigurimeve operuan gjithsej 11 kompani të sigurimeve, prej tyre dhjetë kompani jojetë dhe një kompani për sigurim të jetës. Sa i përket strukturës së pronësisë, katër kompani ishin me pronësi të huaj, katër me pronësi të përzier, ndërsa tre prej tyre ishin kompani sigurimi tërësisht në pronësi vendore.

Në vazhden e ndryshimit të strukturës së pronësisë gjatë vitit 2010, dy kompani të sigurimit me strukturë pronësie të përzier (vendore dhe të huaj) u shndërruan në kompani tërësisht të huaj.

Në fund të vitit 2010 numri total i policave të shitura të sigurimeve mbërriti në 542,097 ose 6 përqind më shumë se në vitin 2009. Struktura e portfolios siguruës për vitin 2010 karakterizohej me 47.6 përqind polica të sigurimit të detyrueshëm nga auto-përgjegjësia, pastaj 35.6 përqind polica të sigurimit kufitar si dhe 16.6 përqind polica të sigurimeve tjera (vullnetare). Tregu i sigurimit të jetës akoma mbetet me një pjesëmarrje të ultë në gjithsej portofolin siguruës (0.25 përqind e policave të portfolios siguruës për vitin 2010).

Gjate vitit 2010, bruto primi i shkruar u karakterizua me 56.13 përqind nga sigurimi i detyrueshëm i auto-përgjegjësive, pastaj me 28.25 përqind nga sigurimet tjera (vullnetare) dhe 14.64 përqind nga sigurimi kufitar. Tregu i sigurimeve të jetës akoma mbetet i ultë duke marrë pjesë në bruto primin e shkruar për vitin 2010 me vetëm 0.98%.

Gjate vitit 2010 rritje të konsiderueshme pati si në numër ashtu edhe në vlerë të dëmeve të paguara. Dëmet e paguara në numër gjatë vitit 2010 mbërriti në 60,112 dëme apo 56.5 përqind më shumë se në vitin 2009, ndërkohë që vlera e dëmeve të paguara në vitin 2010 ishte 28.1 milionë apo 28.6 përqind më shumë se në vitin 2009. Raporti i dëmeve të paguara në vitin 2010 është 40.87 përqind, krahasuar me atë të vitit 2009 që ishte 39.34 përqind. Nga treguesit si më lartë vërehet rritje e konsiderueshme në pagesën e dëmeve për vitin 2010 krahasuar me vitin paraprak që vjen edhe si rezultat i mbikëqyrjes së shtuar dhe efektive të BQK-së në drejtim të kontrollit të pagesës së dëmeve me qëllim të mbrojtjes së policmbajtësve.

Duke marrë parasysh rolin dhe objektivat e Drejtoratit të mbikëqyrjes së sigurimeve në mbrojtjen e interesave të policmbajtësve (klientëve) dhe në përgjithësi ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar edhe në vitin 2010, ky Drejtorat performoi një mbikëqyrje të bazuar në rrezik duke ekzekutuar ekzaminime direkte në vend (anglisht: “on-site”) ashtu edhe monitorime nga jashtë (anglisht: “off-site”).

Mbi bazën e raporteve mujore, tremujore e vjetore është performuar monitorimi nga jashtë me ç'rast janë llogaritur indikatorë të ndryshëm financiarë të cilët tregojnë mirëvajtjen e aktivitetit të kompanive të sigurimeve si: marxhina minimale e solvencës, fuqia financiare –likuiditeti, kalkulimi i rezervave teknike, ekspozimi i rrezikut, maksimumi i mbajtësve të rrezikut nga kompanitë e sigurimeve, kualiteti i risigurimit si dhe tregues tjerë relevant financiarë.

Tabela 17. Ekzaminimet “on-site” të zhvilluara gjatë vitit 2010

Përshkrimi	Ekzaminime të plota	Ekzaminime të fokusuar	Ekzaminimet në Pikat e Shitjeve
Kompanitë e sigurimeve	3	41	126
Ndërmjetësuesit e sigurimeve	3		

Burimi: BQK 2011

Tabela e sipërme tregon për një qasje proaktive në mbikëqyrjen e sigurimeve gjatë vitit 2010. Ekzaminimet “on-site” janë përqendruar kryesisht në ekzaminime të fokusuara, gjithnjë duke u bazuar në aktivitetin e kompanive të sigurimeve të cilat janë identifikuar dhe vlerësuar për aktivitet me rreziqe më të larta orientimi i mbikëqyrjes së sigurimeve drejt ekzaminimeve të fokusuara gjatë vitit 2010 është vlerësuar mjaft efektiv. Në veçanti, janë arritur rezultate pozitive në ngritjen e pagesës së dëmeve, qëndrueshmërinë financiare, ngritjen e kualitetit të qeverisjes korporative si dhe mbarë rregullimit të tregut të sigurimeve.

Përveç aktiviteteve që rezultuan nga plani operativ i mbikëqyrjes së sigurimeve, që nga viti 2010, BQK-ja filloi implementimin e ²³Udhëzimit administrativ mbi certifikimin e rezervave teknike për kompani të sigurimeve jojetë. Sipas këtij udhëzimi kompanitë e sigurimeve jojetë janë të obliguara që në baza tremujore dhe vjetore të dorëzojnë në BQK rezervat teknike të certifikuara nga aktuari i certifikuar i kompanisë apo i angazhuar nga jashtë dhe mbi këtë bazë BQK-ja ka vlerësuar adekuatshmërinë e rezervave, ashtu që në rast të konstatimit të mos adekuatshmerisë së tyre, kompanitë e sigurimeve janë obliguar që të rrisin rezervat.

Gjatë vitit 2010, nga BQK është lëshuar “Udhëzuesi për krijimin e fondit të kompensimit të kartonit të gjelbër”, me ç’rast kompanitë e sigurimeve janë obliguar që të hapin llogari bankare në bankat komerciale. Rrjedhimisht, nga korriku i vitit 2010 kompanitë e sigurimeve kanë filluar të ndajnë 20 përqind të të hyrave të sigurimit kufitar duke kontribuar në themelimin e fondit të lartpërmendur.

Me qëllim të sigurisë sa më të madhe të mjeteve të kapitalit themeltar të cilat kompanitë e sigurimeve i zotërojnë të depozituara në bankat komerciale, gjatë vitit 2010, BQK u ka dërguar shkresa të gjitha kompanive dhe bankave komerciale për hapjen e llogarive të besueshme (anglisht: “escrow account”) mbi depozitimin e kapitalit themeltar.

a) Performanca financiare e sistemit të sigurimeve

Edhe gjatë vitit 2010 industria e sigurimeve performoi me një rritje të qëndrueshme financiare.

Tabela. 18 Bruto Primi i Shkruar

Përshkrimi	2009	2010	Ndryshimi në %
Auto përgjegjësia	35,461,834	40,221,123	11.83%
Sigurimet Kufitare	12,983,207	10,491,743	-23.75%
Sigurimet Vullnetare	17,224,304	20,244,145	14.92%
Kthimet	-1,365,724	-1,878,507	27.30%
Bruto Primet e Shkruara	64,303,621	69,783,389	7.85%

Burimi: BQK 2011

Tabela e mësipërme tregon se bruto primi i shkruar ka shënuar rritje në vitin 2010 për 7.85 përqind krahasuar me vitin 2009. Rritje më të madhe kanë shënuar sigurimet vullnetare, përkatësisht 14.9 përqind krahasuar me vitin 2009. Orientimi drejt sigurimeve vullnetare tregon një indikator zhvillimor inkurajues për sistemin e sigurimeve në Kosovë.

²³ Udhëzimi është lëshuar nga BQK-ja në Dhjetor të vitit 2009.

Gjatë vitit 2010, primi nga sigurimi kufitar shënoi rënie për 23.75 përqind krahasuar me vitin 2009 dhe kjo si rezultat i zvogëlimit të tarifave të sigurimit kufitar nga ana e BQK-së. Brenda dy viteve të fundit (2009 dhe 2010), këto tarifa janë zvogëluar rreth 50 përqind.

Gjate vitit 2010 aktivet e sistemit të sigurimeve në Kosovë shënuan rritje për 9.20% krahasuar me vitin 2009. Pjesëmarrja e aktiveve të sistemit të sigurimeve në aktivet e përgjithshme të sektorit financiar është rreth 7.10 përqind. Në kuadër të aktiveve të përgjithshme, rritje të konsiderueshme kanë shënuar aktivet fikse (27.22 përqind), për shkak të investimit në patundshmëri nga ana e kompanive të sigurimeve.

Tabela 19. Aktivet e sistemit të sigurimeve në Kosovë

Aktivitet	2009	2010	Ndryshimi në %	Pjesëmarrja në 2010	Pjesëmarrja në 2009
Paraja e gatshme	59,267,448	61,108,295	3.01%	62.89%	67.18%
Aktivitet likuide	17,882,681	20,290,650	11.87%	20.88%	20.27%
Aktivitet Fikse	11,011,670	15,130,416	27.22%	15.57%	12.48%
Aktivitet e paprekshme	62,804	639,573	90.18%	0.66%	0.07%
Totali i aktiveve	88,224,603	97,168,934	9.20%	100.00%	100.00%

Burimi: BQK 2011

b) Niveli i Solvences (aftësisë paguese)

Gjate vitit 2010 sistemi i sigurimeve ka rezultuar me performance të qëndrueshme financiare. Niveli i solvences gjatë vitit 2010 është për 21,130,756 euro mbi ²⁴marxhinën minimale të kërkuar prej 6,600,000 euro sipas Rregullës VIII të BQK-se (neni 9). Krahasuar me vitin 2009 niveli i solvences në vitin 2010 ishte 14,751,505 euro, gjë që flet për një tendencë të rritjes së nivelit të solvences.

Tabela 20. Niveli i Likuiditetit në sistemin e sigurimeve në Kosovë

Përshkrimi	2010
Aktivitet likuide – paraja e gatshme / Total aktivitet	63%
Total Aktivitet likuide (paraja e gatshme) / Rezervat Teknike	130%
Total Aktivitet Likuide (paraja e gatshme) / Total Detyrimet	107%
Te hyrat nga investimet / Gjithsej të Hyrat	6%
Jo-TPL / Bruot Primi Shkruar	9%

Burimi: BQK 2011

Gjatë vitit 2010 sistemi i sigurimeve në përgjithësi rezultoi me tregues të qëndrueshëm likuiditeti. Siç vërehet nga tabela e sipërme, aktivet likuide në para të gatshme në raport me rezervat teknike ishin 130 përqind, ndërsa në raport me gjithsej detyrimet ishin 107 përqind. Ngushtimi i likuiditetit në vitin 2010 kryesisht ka rezultuar si pasojë e trendit të rritjes së shpejtë të totalit të rezervave teknike krahasuar me vitin e kaluar si dhe i implementimit të Udhëzuesit të metodologjisë së kalkulimit të rezervave teknike lëshuar nga BQK-ja.

²⁴ Marxhina minimale e solvences-20% e 3 mil euro - kapitalit themeltar = 600,000 euro

c) Veprimet korrektuese

Gjatë vitit 2010 janë ndërmarrë masa korrektuese ndaj kompanive të sigurimeve varësisht prej parregullsisve/shkeljeve të konstatuara. Në korrik të vitit 2010, BQK ka lëshuar urdhëresa ndaj kompanive të sigurimeve mbi ekzekutimin e pagesës së dëmeve të trajtuara por të parregulluara.

Për shkak të lëshimit të policave për sigurimin e detyrueshëm të auto-përgjegjësive në kundërshtim me rregullativën ligjore të BQK-së, respektivisht urdhëresën nr. 008/2004, kompanitë e sigurimeve janë ndëshkuar nga BQK-ja me gjobë në vlerë prej 38,000 euro. Ndërlidhur me këtë, BQK gjithashtu u ka lëshuar vërejtje me shkrim edhe zyrtarëve të lartë të kompanive përkatëse të sigurimeve.

Gjatë vitit 2010 BQK ka lëshuar urdhëresa ndaj kompanive të sigurimeve me qëllim të plotësimit të deficitit të konstatuar nga analizat përkatëse financiare. Pastaj, bazuar në ekzaminimet e performuara direkt në kompanitë e sigurimeve, gjatë vitit 2010, BQK ka lëshuar urdhëresa ndaj kompanive përkatëse me qëllim të sanimit të gjendjes konform rregullatives ligjore në fuqi. Gjithashtu, me qëllim të verifikimit të adekuatshmerisë së stafit të sistemit të sigurimeve, gjatë vitit 2010, BQK ka lëshuar shkresa si dhe janë ndërmarrë masa korrektuese në rast të identifikimit/konfirmimit nga organet kompetente mbi joadekuatshmerinë e individëve përkatës.

d) Bashkëpunimi ndërkombëtar në lëmin e sigurimeve

BQK-ja në bashkëpunim me asistencën teknike të ofruar nga institucionet relevante financiare ndërkombëtare respektivisht me Bankën Botërore, Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave si dhe industrinë e sigurimeve kanë përgatitur draft-ligjin mbi sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia, draft-ligj i cili është dërguar në Kuvendin e Kosovës për aprovim. Pritet që ky ligj të konsolidojë dhe të avancojë më tutje bazën ligjore të tregut të sigurimeve të detyrueshme.

Gjithashtu, në bashkëpunim me asistencën teknike të ofruar nga Banka Botërore, BQK, në fund të vitit 2010, inicioi projektin mbi Vlerësimin e Parimeve Bazë të Sigurimeve, projekt ky i cili vlerëson gjithsej 28 parime bazë të sigurimeve si dhe ofron plan konkret të veprimit me qëllim të implementimit të rekomandimeve të rezultuara nga vlerësimi. Padyshim, kjo do të kontribuojë drejt një mbikëqyrjeje sa më efektive gjithnjë në pajtim me parimet dhe direktivat ndërkombëtarë të sigurimeve të cilat janë relevante për nivelin e zhvillimit të industrisë së Kosovës.

Në këtë vazhdë krahas rishikimit detal të Rregullores së sigurimeve 2001/25 që do të shërbejë si bazë për përgatitjen e Ligjit të përgjithshëm të sigurimeve, si dhe plotësimit të rregullave për industrinë e sigurimeve konform ligjit, që nga fundi i vitit 2010, BQK në përkrahje të asistencës teknike ofruar nga Banka Botërore, ka iniciuar procesin mbi draftimin e Ligjit të përgjithshëm për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sigurimeve, ligj ky që do të përmbajë edhe koncepte si të Solvences I ashtu edhe të Solvences II.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, me qëllim të këmbimit të përvojave dhe mbështetjes së zhvillimit profesional, BQK në vitin 2010 nënshkroi Marrëveshje mbi bashkëpunimin/këmbimin e informacionit me Autoritetin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Bullgarisë si dhe me Agjencionin për mbikëqyrje të sigurimeve të Malit të Zi. Njëkohësisht edhe gjatë vitit 2010, ka vazhduar bashkëpunimi në formë të vizitave zyrtare në vendet përkatëse me të cilat BQK-ja posedon Marrëveshje Mirëkuptimi (MeM).

4.4 Mbikëqyrja e Pensioneve

Sistemi pensional në Kosovë funksionon në bazë të Ligjit 03/L-084 për ndryshim të Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për pensionet në Kosovë. Ligji në fjalë ofron strukturën trishtyllëshe të pensioneëve, strukture kjo e cila siguron:

Pension bazë të moshës së vjetër për të gjithë kosovarët mbi 65 vjeç, që financohet nga të hyrat e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (i njohur si shtylla e D);

Pensione të investuara që financohet nga kontributet e obligueshme të punëdhënësve dhe punëtorëve për punëtorët aktual (i njohur si shtylla e II) dhe;

Skemat vullnetare pensionale, të financuara nga kontributet vullnetare të individëve dhe punëdhënësve (i njohur si shtylla e III-të).

Në bazë të Ligjit 03/L-084 për Pensionet në Kosovë, shtylla e dytë është e financuar nga kontributet mujore të detyrueshme: të punësuarit kontribuojnë me 5 përqind të rrogës së tyre dhe punëdhënësit kontribuojnë me 5 përqind të tjera. Pagesat transferohen në Llogaritë Individuale të pjesëmarrësve në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti).

Vlen nënvizuar se gjatë vitit 2010, në bashkëpunim me asistencën teknike të Bankës Botërore, është punuar në finalizimin e draft ligjit të ri mbi pensionet në Kosovë.

a) Operatorët

Shtylla e II-të (Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës –Trusti) - Trusti është themeluar për të administruar këtë sistem të ri, shtyllën e dytë. Bordi Udhëheqës, me shtatë anëtarët e tij, mbikëqyrë punën e Trustit. Anëtarët e Bordit përzgjidhen nga komisioni i përbërë nga BQK-ja, Auditori i Përgjithshëm dhe Sekretari i Përhershëm i MEF-it dhe emërohen nga Kuvendi i Kosovës pas konsultimeve me Qeverinë.

Gjatë vitit 2010 investimet e Trustit patën një kthim të kënaqshëm. Vlera e kontributeve të investuara nga Trusti vetëm për një vit u shtua me 26 milionë euro, apo një rritje prej 5.18 përqind kthim neto nga investimet. Në fund të vitit 2009 vlera e aksionit të Trustit ishte 0.9818 euro, kurse në fund të 2010-s kjo vlerë arriti në 1.0327 euro, që është më e lartë 5 përqind. Gjatë vitit 2010- është rritur ndjeshëm edhe numri i përfituesve që filluan tërheqjen e pensioneëve nga kursimet e akumuluar. Nga 2,177 përfitues të rinj që kishin tërhequr pensione në vitin 2009, ky numër ka shkuar në 2,738 në vitin 2010. Vetëm gjatë vitit 2010 vlera e mjeteve në menaxhim të Trustit u rrit për gati 115 milionë euro. Vlera e gjithsej mjeteve në menaxhim të Trustit arriti në gati 490 milionë euro në fund të vitit 2010, nga 375 milionë euro sa ishte në fund të vitit 2009. Në fund të vitit, përkatësisht më 31 dhjetor 2010, pjesa më e madhe e mjeteve të Trustit ishte nën menaxhim të menaxherëve të aseteve si “Vanguard” (39.73 përqind), “Fortis GLF” (15.35 përqind), “Schroders” (12.38 përqind), European Credit Management (8.64 përqind), ndërsa një pjesë tjetër e mjeteve ishte e deponuar në tri banka komerciale si dhe në BQK. Në fund të vitit 2009 vlera e aksionit të Trustit ishte 0.9818 euro, kurse në fund të vitit 2010 kjo vlerë arriti në 1.0327 euro. Ky ndryshim pozitiv nënkupton rritje të drejtpërdrejtë në vlerën e kursimeve të kontribuuesve dhe përcakton numrin e aksioneve që kontributet e reja do të blejnë në të ardhmen.

Shtylla e III, Fondi Slloveno - Kosovar i Pensioneve (FSKP) është themeluar si shoqëri aksionare “Prva Group” nga Ljubljana dhe Korporata “Dukagjini” nga Peja, më 4 shtator 2006, në bazë të Ligjit 03/L-084 për ndryshim të rregullores së UNMIK-ut 2005/20 mbi Pensionet në Kosovë. FSKP-ja është licencuar si Fond Pensional Suplementar dhe si

Menaxher i Mjeteve Pensionale, ndërsa mjetet nën menaxhim të FSKP-së më 31 dhjetor 2010 kapën shumën prej 3,616,889 euro, ndërsa numri i kontribuuesve ishte 3,242 si dhe vlera e njësisë ishte e barabartë me 120.91 euro.

Në harmoni me rregullativën ligjore në fuqi, për periudhën e kursimit, asetet e FSKP-së janë të investuara kryesisht në fletëobligacione (75.49 përqind), pastaj në aksione (1 përqind), në depozita (20.84 përqind), në para të gatshme (1.95 përqind) dhe të tjera (0.72 përqind).

Ngjashëm me institucionet tjera financiare edhe operatorët e sistemit të pensioneve si Trusti ashtu edhe FSKP-ja u janë nënshtruar ekzaminimeve “on-sit” dhe “off-site” të kryera nga Drejtorati i sigurimeve dhe i pensioneve të BQKsë.


5. Shërbimet e siguruar për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

BQK u siguron institucioneve shtetërore, atyre financiare dhe publikut të gjerë shërbimet e rëndomta që ofrojnë bankat qendrore. Këto shërbime kryesisht kanë të bëjnë me qarkullimin e parave të gatshme, transaksionet e llogarive, menaxhimin e mjeteve financiare, sistemet ndërbankare të pagesave, regjistrin e kredive, statistikat dhe analizat ekonomike. Në këtë kontekst, BQK ka bashkëpunim të ngushtë me institucionet vendore, si Policinë e Kosovës, Departamentin e Thesarit, Ministrinë e Financave, Agjensionin Kosovar të Privatizimit dhe asociacionet e institucioneve përkatëse financiare.

5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme


Që nga themelimi BQK-së i është dhënë mandati për të siguruar një furnizim adekuat të ekonomisë së vendit me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme. Meqë euroja është valuta që përdoret zyrtarisht në Kosovë, përgjegjësitë e BQK-së lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme kanë të bëjnë në radhë të parë me furnizimin me euro.

Figura 48. Furnizimi me para të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2011)


Figura 49. Pranimi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK(2011)


Sa i përket vlerës së përgjithshme, paratë e gatshme të furnizuara gjatë vitit 2010 patën një rritje prej 18.4 për qind krahasuar me vitin 2009, ndërkaq struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, nuk pati ndonjë ndryshim të dukshëm nga viti 2009 në vitin 2010. Tek kartëmonedhat euro vazhduan të dominojnë denominimet e ulëta (5, 10, 20 dhe 50 euro), ndërsa denominimet prej 200 dhe 500 euro ishin më pak të qarkulluara. Tek monedhat euro furnizimi kryesisht dominohet nga monedhat me vlerë të mesme nga 5 eurocent deri në 50 eurocent, ndërsa vëllimet e denominimeve edhe më të ulëta se dy parapraket patën

Figura 50. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2011)


Figura 51. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2011)


rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2009.

Figura 52. Kartëmonedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2011)

Figura 53. Monedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2011)


Siç është paraqitur në figurat e mësipërme, gjatë vitit 2010 pa ndryshim të theksuar nga viti paraprak, BQK-ja furnizoi bankat komerciale dhe institucionet e tjera më afër 8.04 milionë copë kartëmonedha euro (në shumë prej rreth 225 milionë euro) dhe mbi 1.5 milionë copë monedha euro (në shumë rreth 0.63 milion euro).

Në anën tjetër, gjatë vitit 2010 vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita shënoi një rritje të konsiderueshme prej 7.9 për qind krahasuar me vitin paraprak. BQK-ja pranoi afër 12.6 milionë copë kartëmonedha euro (mesatarisht rreth 50,500 copë kartëmonedha në ditë) dhe afër 2.94 milionë copë monedha euro (mesatarisht rreth 12,000 copë monedha në ditë) si depozita në para të gatshme nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera. Të shprehura në vlerë, këto depozita arritën përafërsisht shumat prej 648 milionë euro dhe 2.2 milionë euro, përkatësisht. Struktura e kartëmonedhave dhe monedhave euro të pranuar nuk dallon shumë nga viti paraprak.

Ngjashëm me vitet e kaluara, në vitin 2010 paratë e gatshme të depozituara kishin një vlerë dukshëm më të lartë sesa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, duke arritur në rreth 423.7 milionë euro, ndryshimi i këtyllë në vlerë ishte paksa më i lartë sesa në vitin paraprak kur ishte 411 milionë euro.


Meqë BQK-ja mban vetëm nivelin minimal të nevojshëm të parave të gatshme, duke dërguar tepricat në Eurozonë, ku kthehen në mjete interes-prurëse, tejkalimi i konsiderueshëm vjetor i parave të gatshme të depozituara kundrejt parave të gatshme të furnizuara ka rezultuar në një shumë të konsiderueshme të neto dërgesave jashtë vendit të parave të gatshme. Neto dërgesat jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2010 arritën shumën prej 405.3 milionë eurove duke qenë në një vlerë paksa më të ulët sesa një vit më herët kur ishin rreth 429 milionë euro. Ecuritë e eksporteve dhe importeve të parave të gatshme gjatë viteve të fundit janë të paraqitura në dy figurat e mësipërme.

Figura 54. Eksporti i parave të gatshme (vlera), në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

Figura 55. Importi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

Figura 56. Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2011)


Figura 57. Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar



Burimi: BQK (2011)


Operacionet me para të gatshme vijuan të kryhen përmes pajisjeve moderne të procesimit dhe në përputhje me rregullat standarde. Të gjitha paratë e gatshme të pranuar nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera procesohen dhe klasifikohen sipas shkallës së vjetërsimit. Gjatë vitit, rreth 3.2 milionë copë kartëmonedha euro (25 për qind e numrit të kartëmonedhave euro të depozituara) u klasifikuan si tejet të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi dhe u dërguan në bankat qendrore të Eurozonës për zëvendësim me kartëmonedha tërësisht të reja. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro tejet të vjetërsuara të hequra nga qarkullimi kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës. Natyrisht, kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si tejet të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi ishin ato të denominimeve 20, 10 dhe 5 euro, të cilat edhe ashtu qarkullojnë më së shumti në ekonominë tonë.

Figura 58. Furnizimi me kartëmonedha të reja (numri i copëve)



Burimi: BQK (2011)

Figura 59. Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara



Burimi: BQK (2011)

Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua edhe përmes furnizimit të bankave dhe të institucioneve të tjera me kartëmonedha plotësisht të reja, të cilat u sollën nga Eurozona. Gjatë vitit 2010, BQK-ja furnizoi këto institucione me mbi 2 milionë copë kartëmonedha të reja euro (25 për qind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara). Shumica e kartëmonedhave të reja të furnizuara ishin kartëmonedha të denominimeve më të ulëta (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat kryesisht u furnizuan bankat komerciale për qëllim të pajisjes së bankomatëve të tyre. Pastaj edhe të gjitha kartëmonedhat e përdorura euro që u furnizuan, ishin të një cilësie standarde të lartë (cilësia adekuate për bankomatë).

Për sa u përket masave kundër falsifikimit, BQK-ja vazhdoi të përcjellë rastet e parave të falsifikuara gjatë vitit 2010. Në veçanti, vazhdoi të bashkëpunojë me autoritetet për avancimin e raportimit të parave të gatshme të dyshuara si false dhe organizimin e trajnimeve mbi paratë e falsifikuara të dizajnuar për stafin e zgjedhur të institucioneve financiare që ofrojnë shërbime me para të gatshme. Vlen të theksohet mbajtja e rregullt e takimeve të Komitetit Qendror të Analizave të Parave të Falsifikuara, i cili është i përbërë nga tre përfaqësues të lartë të BQK-së dhe tre përfaqësues të lartë të Policisë së Kosovës. Mandej, BQK-ja publikoi në faqen e saj të internetit materiale edukative mbi tiparet e sigurisë së kartëmonedhave euro. Materialet e tilla kanë si qëllim edukimin e publikut të gjerë dhe në veçanti të personave që punojnë me para të gatshme në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive

BQK-ja ofron shërbime bankare për Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave (Thesari) dhe institucionet e tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), subjektet e veçanta publike, bankat dhe institucionet e tjera financiare, institucionet financiare ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare. Ngjashëm me vitet paraprake, në vitin 2010 këto shërbime përbëheshin kryesisht nga mirëmbajtja e llogarive dhe kryerja e transaksioneve, duke përfshirë çfarëdo forme të kreditimit.

Tabela 21. Vlera e transaksioneve sipas llojeve kryesore të tyre (në mijëra euro)

Llojet e transaksioneve	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Transaksionet me para të gatshme	+249,904	+295,100	+371,745	+385,113	+411,055	+423,658
Depozitat	456,279	440,975	533,178	524,346	601,207	648,911
Terheqjet	206,375	145,875	161,433	139,233	190,152	225,253
Pagesat vendore	+129,854	+228,668	+358,182	+78,078	+41,169	+392,587
Pagesat vendore ardhëse	828,633	998,128	1,055,472	1,076,145	1,225,527	1,568,021
Pagesat vendore shkuarëse	698,779	769,460	697,290	998,067	1,184,358	1,175,434
Pagesat ndërkombëtare	-221,008	-65,543	+13,124	-364,795	-463,816	-408,689
Pagesat ndërkombëtare ardhëse	100,592	260,267	335,613	203,113	202,755	326,319
Pagesat ndërkombëtare shkuarëse	321,600	325,810	322,489	567,908	666,571	735,008


Burimi: BQK 2010

Numri më i madh i llogarive në BQK mbahen në emër të AKP-së dhe të Thesarit. Sa i përket transaksioneve, përderisa ato me para të gatshme kryhen kryesisht në raport me bankat, transaksionet e pagesave kanë të bëjnë gati krejtësisht me Thesarin dhe AKP-në.

Vërtet, të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë transaksionet e pagesave vendore si produkte të tyre bazë, kurse institucionet e tjera financiare që janë klientë të BQK-së numrin më të madh të pagesave të tyre e kryejnë nëpërmes bankave komerciale, ku edhe mbajnë llogaritë operuese. Të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë edhe pagesat ndërkombëtare, mirëpo përmes BQK-së e bëjnë vetëm transferimin ndërkombëtar të fondeve të tyre.


Gjatë vitit 2010, BQK-ja vazhdoi të mbështesë avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe raportimeve të Thesarit si dhe të AKP-së. Format e pagesave dhe mënyrat e komunikimit u janë përshtatur kërkesave të tyre dhe vlen të veçohet elektronizimi i plotë i urdhërpagesave.

Figura 60. Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse, numri




Burimi: BQK (2011)

Figura 61. Vlera e transaksioneve vendore hyrëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

Figura 62. Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse, numri



Burimi: BQK (2011)

Figura 63. Vlera e transaksioneve vendore dalëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

Shumica e pagesave vendore janë ndërbankare, të cilat BQK-ja i kanalizon përmes Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) si pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në të.

Gjatë vitit 2010, përmes SEKN-së, BQK-ja ka dërguar në emër të klientëve të saj afër 208 mijë urdhërpagesa shkuarëse (një rritje prej 42 për qind krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 88 mijë urdhërpagesa ardhëse (një rritje prej 8 për qind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat shkuarëse në vitin 2010 arritën mbi 1.17 miliardë euro (një zvogëlim prej 1 për qind krahasuar me vitin paraprak) dhe urdhërpagesat ardhëse arritën mbi 1.56 miliardë euro (një rritje prej 28 për qind krahasuar me vitin paraprak). Përndryshe edhe gjatë vitit 2010 BQK-ja ka mbetur, sa i përket si vlerës ashtu edhe vëllimit të transaksioneve, pjesëmarrësi më i madh në SEKN.


Sa u përket pagesave ndërkombëtare, në vitin 2010 numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kanë të bëjnë me transferimet e fondeve të bankave komerciale. Të dhënat vjetore për pesë vitet e fundit mbi transaksionet ndërkombëtare janë të paraqitura në figurat në vijim.

Figura 64. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare hyrëse, numri




Burimi: BQK (2011)

Figura 65. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare hyrëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2011)

Figura 66. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare dalëse, numri



Burimi: BQK (2011)


Figura 67. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare dalëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2011)

Depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës së bashku me depozitat e AKP-së përbëjnë pjesën më të madhe të depozitave të gjithmbarshme të mbajtura në BQK në fund të vitit 2010. Më 31 dhjetor 2010, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës dhe të AKP-së arritën shumën prej afro 800 milionë euro. Në këtë shumë përfshihen mjetet në llogari rrjedhëse dhe ato të afatizuara.

Figura 68. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së, miliard euro



Burimi: BQK (2011)

Në mesin e llogarimbajtësve të tjerë, bankat komerciale dhe institucionet e sigurimit janë më të rëndësishmit sa i përket nivelit të depozitave që mbahen në llogaritë në BQK. Depozitat e bankave komerciale dhe institucioneve të sigurimeve që mbahen në BQK, kryesisht kanë të bëjnë me obligimet e tyre rregullatorë.

Më 31 dhjetor 2010, depozitat e bankave komerciale dhe institucioneve të sigurimit ishin në shumën prej afro 210 milionë euro.

Niveli i depozitave të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) të mbajtura në BQK u zvogëlua gjatë vitit 2010. Në fund të vitit kishin vlerën prej afro 40 milionë euro. Ky zvogëlim ndodhi për shkak të shtimit të plasmanëve të tyre të jashtëm.

5.3. Menaxhimi i Mjeteve

Menaxhimi i Mjeteve dhe Politika e Investimeve të BQK-së

Bazuar në Ligjin e saj (Neni 1 paragrafi 1.6), BQK-ja është e autorizuar të veprojë si agjent fiskal i Qeverisë ndërsa sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Neni 7), BQK-ja është autorizuar të investojë mjetet e Qeverisë. Kjo formë e investimeve financiare mundëson kthimin në investime, krijimin e mjeteve të paguara nga interesi, mjete të cilat pastaj derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Në praktikë, fondet e depozituara ju takojnë kryesisht institucioneve qeveritare; Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave (rezervat buxhetore), Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) si dhe institucioneve financiare (rezervat e obligueshme për likuiditet).

Menaxhimi i investimeve të Thesarit kryhet nga BQK-ja në marrëveshje me Thesarin përmes Komitetit të Likuiditetit i cili mbahet rregullisht çdo muaj. AKP filloi afatizimin e fondit që nga gushti 2010 në depozita bankare me afat maturimi deri në një vit. Këto investime janë kryer në pajtim me Politikën e Investimeve dhe Politikën e Normës së Kamatës të aprovuara nga Bordi i BQK-së. Po ashtu BQK-ja është e ngarkuar me menaxhimin e fondeve të depozituara nga agjencitë publike, institucionet financiare, dhe organizatat donatore.

Politika e Investimeve e aprovuar nga Bordi i BQK-së ndiqet nga menaxhmenti dhe nën kontrollin e tij, implementohet nga Drejtorati i Menaxhimit të Mjeteve. Për arsye se një pjesë e madhe e fondeve që menaxhohen janë mjete të fondeve publike ose mund të kthehen për një afat të shkurtër kohor, përqendrim i veçantë i është dhënë sigurisë, likuiditetit dhe së fundi kthimit në investime.

Të gjitha mjetet janë të investuara

Figura 69. Raporti i Investimeve të BQK-së





Figura 70. Mesatarja mujore e ofruar nga bankat korrespondente për portfolion e BQK-së



në bankat qendrore dhe komerciale të cilat janë nga shtetet e BE-së. Ndër tri bankat qendrore të këtyre shteteve evropiane me të cilat bashkëpunon BQK-ja janë: Banka Qendrore e Gjermanisë (Deutsche Bundesbank), Banka e Francës (Banque de France) dhe Banka Qendrore e Luksemburgut (Banque Centrale du Luxembourg) të cilat kanë një rrezik kreditor minimal dhe gjashtë banka komerciale të shteteve anëtare të BE-së. Investimi i mjeteve të paraqitura në valutën euro, deri në fund të vitit 2010 është bërë në instrumentet financiare si në depozita bankare

27.12 për qind të mjeteve nga totali i portofolios janë investuar në banka qendrore të shteteve të Eurozonës, 53.50 përqind të mjeteve në banka komerciale të shteteve të Eurozonës ndërsa në letra me vlerë janë investuar 19.38 për qind të totalit të mjeteve ku sipas Politikës së Investimeve ky ekspozim lejohet deri në 70 për qind. Për më tepër, në raport me Politikën e Investimeve ekspozimi i kombinuar tek bankat komerciale nuk ka tejkaluar 60 për qind të portofolios totale investuese të BQK-së.

Normat mesatare të interesit të ofruara nga bankat me të cilat bashkëpunon BQK-ja karakterizohen me ndryshim pozitiv në gjashtëmujorin e dytë të vitit, konkretisht nga muaji i shtatë deri në fund të vitit 2010. Gjashtëmujori i parë i vitit karakterizohet me një normë mesatare të kamatës prej 0.21 për qind ku nuk kishte lëvizje të normave të kamatës.

Menaxhimi i Rrezikut të Investimeve

Menaxhimi i Rrezikut është bërë përmes vlerësimit mujor të bankave me të cilat bashkëpunon BQK-ja. Të gjitha aktivitetet e investimeve janë kryer me bankat që i përmbushin kriteret e parashtruara të Politikës së Investimeve. Edhe përkundër ndikimit të krizës buxhetore, nga vlerësimet e vazhdueshme për qëndrueshmëri financiare nga Agjencionet Financiare Ndërkombëtare, të gjitha bankat me të cilat bashkëpunoi BQK-ja i përmbushën kriteret e Politikës së Investimeve me kategorinë kryesore të vlerësimit *Aa*. BQK-ja i investoi mjetet edhe në instrumentet e tregut të parasë. Gjatë vitit 2010, vëmendje e posaçme i është kushtuar shpërndarjes së rrezikut, ku koncentrimi më i madh i mjeteve të investuara është kryer me bankat qendrore të shteteve të Bashkimit Evropian me afat maturimi deri në një vit. Sipas Politikës së Investimeve të BQK-së, rreziku kreditor është menaxhuar përmes shpërndarjes proporcionale, bazuar në vlerësimet e bëra nga agjencitë financiare ndërkombëtare. Nga vlerësimet e kryera mbi bankat me të cilat bashkëpunoi BQK-ja, bankat të cilat nuk kanë përmbushë kriteret e klasifikimit kreditor janë larguar nga lista e aprovuar. Asnjë investim nuk është kryer me bankat me të cilat bashkëpunon BQK-ja, pa u shqyrtuar, rishikuar dhe aprovuar nga Komiteti i Investimeve i cili mbahet rregullisht çdo muaj. Përcaktimi i kufijve të investimeve për secilën bankë me të cilën bashkëpunon BQK-ja dhe për vendet ku investohet janë të kufizuara rreptësisht. Analizat e rreziqeve si dhe auditimet e funksioneve të menaxhimit të mjeteve janë bërë rregullisht.

Depozitimet e marra nga BQK-ja janë paguar në bazë të Politikës mbi Normën e Kamatës të BQK-së. Sipas kësaj Politike kthimi nga investimet i arritur nga BQK-ja në mesatare është minimumi i normës të kamatës së ofruar, ku BQK-ja ndal një diferencë e cila kontribuon në kthimin nga investimet e saj.

Zhvillimet në tregun global financiar

Kriza e borxheve publike që kaploi BE-në tremujorin e dytë të vitit 2010 krijoi kushte që fondet të përqendrohen drejt investimeve afatshkurtra në tregun e parasë.


Rritje të konsiderueshme nga kthimet nga investimi në letra me vlerë afatshkurtra dhe afatgjata pati në shtetet evropiane me turbulencë financiare si Irlanda, Greqia dhe Portugalia. Kthimet nga investimet që shërbejnë si pika më e mirë e referimit (anglisht: "benchmark") dhe njëkohësisht

pikë e mirë për të krahasuar instrumentet financiare të vendeve të BE-së me Gjermaninë, pësuan një zgjerim të konsiderueshëm i cili u theksua gjatë tremujorit të fundit të 2010. Përderisa kthimi nga investimet e letrave afatshkurtra të Gjermanisë arritën pikën prej 0.40 për qind, ato të Portugalisë kulmuan në 4 për qind. Në muajin nëntor 2010 kthimi nga investimi në obligacione 10-të vjeçare të Irlandës u ngritën në 9 për qind. Kjo pasi që shtetet kryesore të Evropës, Gjermania dhe Franca, u pajtuan që investitorët privat të paguajnë për rreziqet e marra gjatë investimeve në Irlandë për të mos lejuar që e gjithë barra t'i kalojë taksapaguesve të BE-së. Në korrik të vitit 2010, të gjitha obligacionet shtetërore dhe të korporatave në Irlandë u shitën për shkak të rrezikut të infektimit për shtete e tjera evropiane.

EONIA (anglisht: *Euro Overnight Index Average*/Indeksi Mesatar i Euro 'brenda natës') filloi relativisht ulët në gjysmën e parë të vitit 2010, por pësoi trend në ngritje gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt duke bërë që investimet "brenda natës" të portofolios së BQK-së të gjenerojnë fitime të kënaqshme. Në tetor 2010, rënia e EONIA-s si shkak i turbulencave në tregun evropian të borxhit u kompensua me ngritje të theksuar në fund të vitit. Normat e interesit njëjavore dhe njëmujore të ofruara nga bankat korrespondente po ashtu patën një trend të rritjes duke i bërë investimet afatshkurtra kategorinë më të favorshme të mjeteve të investuara në portofolion e BQK-së. Niveli mesatar i EONIA-s për vitin 2010 ishte 0.44 për qind, ndërsa pika më e lartë gjatë vitit prej 0.87 për qind u arrit më 30 shtator 2010.

Banka Qendrore Evropiane (BQE) vazhdoi të mbajë normën kryesore të refinancimit në 1 për qind përgjatë vitit 2010. Duke i mbajtur normat afatshkurtra relativisht të ulëta, BQE njëkohësisht krijoi kushte për një politikë monetare akomoduese në rajon. Kjo i orientoi investitorët drejt tregjeve kapitale që ishin më likuide dhe krijoi kushte tjera që çmimet e obligacioneve shtetërore të vazhdojnë me rënie. Krijimi i mekanizmit për asistencë financiare (anglisht: *European Financial Stability Facility*), përkatësisht Mekanizmi Evropian për Stabilitet Financiar në maj 2010, që kishte për qëllim të ndihmojë shtetet e Eurozonës me nevoja emergjente të likuiditetit, krijoi siguri në treg duke bërë që kthimet nga investimi në letra me vlerë të Portugalisë, Spanjës dhe Irlandës të fillojnë të ulen nga fundi i vitit 2010. Injektimi i likuiditetit në tregun Evropian për të shpëtuar Irlandën dhe përgatitja për të intervenuar në Portugali krijuan siguri të përkohshme tek tregu i parasë. Investitorët privat dhe institucional përfituan nga gjendja jostabile duke blerë letra me vlerë portugeze dhe greke që ofruan kthimet më të larta.

Figura 71. Evoluimi i EONIA-s përgjatë vitit



Burimi: BQK (2011)

Gjatë kësaj periudhe, BQK investoi një pjesë të vogël të mjeteve në tregun e borxheve tek instrumentet afatshkurtra duke gjeneruar fitime dhe mbajtur nivelin e ulët të rrezikut të tregut dhe rrezikut të dështimit.

Bankat komerciale të shteteve të BE-së jashtë krizës së borxheve publike patën një performancë stabile dhe kthime të kënaqshme përgjatë vitit 2010. Në kategorinë e bankave me performancë të qëndrueshme hyjnë bankat e Austrisë, Gjermanisë, Francës, Holandës dhe shteteve Skandinave. Duke e konsideruar profilin e tyre të rrezikut dhe kthimit, investimet në depozita afatshkurtra të BQK-së u përqendruan në bankat më të sigurta të këtij rajoni. Horizonti kohor mesatar për investimet në depozita afatshkurtra për 2010 ishte 9 ditë.

5.4. Sistemi ndërbankar i pagesave

Operimi i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar

Zhvillimi i një sistemi efikas dhe të sigurt për pagesat vendore, si shtyllë kyçe e infrastrukturës financiare kombëtare, është një prej funksioneve parësore të BQK-së. BQK-ja operon Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN), i cili është sistemi i vetëm ndërbankar i pagesave në Republikën e Kosovës. SEKN-ja funksionon si një sistem hibrid i cili mundëson kanalizimin ndërbankar të një sërë instrumentesh të pagesave.

Gjatë vitit 2010 u shënuan rritje në vëllim dhe vlerë të transaksioneve të SEKN-së dhe u bë avancimi i mëtejshëm i sistemit. Nga zhvillimet me rëndësi të veçantë ishin automatizimi i komunikimit në mes të SEKN-së dhe sistemit bazë të BQK-së dhe fillimi i disa studimeve analitike për nevojat e ardhshme zhvillimore.

Figura 72. Numri i transaksioneve në SEKN






Figura 73. Vlera e transaksioneve në SEKN




Rritja e vazhdueshme në vëllim dhe vlerë të transaksioneve ndërbankare të SEKN-së pasqyron rritjen relative të pagesave pa para të gatshme dhe rritjen e besueshmërisë në sistemin bankar. Sikurse viteve të mëparshme, në vitin 2010 rritja vjetore si e vëllimit ashtu edhe e vlerës së transaksioneve të SEKN-së ishte e dukshme. Rreth 3.9 milionë transaksione me një vlerë të përgjithshme prej 4.66 miliardë euro u kanalizuan përmes SEKN-së gjatë vitit 2010.

Figura 74. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2011)

Figura 75. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN




Burimi: BQK (2011)

Krahasuar me transaksionet e SEKN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve u rrit për 4 për qind dhe vlera e transaksioneve u rrit për 17 për qind. Rritja e transaksioneve të SEKN-së mund të shihet edhe nga të dhënat mesatare ditore. Vlera ditore e transaksioneve të SEKN-së në vitin 2010 ishte rreth 18.6 milionë euro, krahasuar me rreth 15.9 milionë euro në vitin 2009. Mandej, vëllimi ditor i transaksioneve të SEKN-së në vitin 2010 ishte afro 15.7 mijë, krahasuar me rreth 15.1 mijë në vitin 2009. Një ndër faktorët që ka ndikuar në rritjen e vlerës së transaksioneve të SEKN-së ishin transaksionet fiskale nga Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës. Ndërkaq rritja në numër e pagesave ndërbankare gjatë këtij viti nuk ishte aq e ndjeshme në krahasim me vitet paraprake.


Janë disa lloje të veçanta të transaksioneve të SEKN-së: të rregullta (individuale dhe masive), prioritare (individuale dhe masive), Kos-Giro dhe Debitimi Direkt. Nivelet e vëllimeve dhe vlerave të tyre për vitet 2010 dhe 2009 janë të paraqitura në vijim.

Figura 76. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2011)

Figura 77. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2011)

Pagesat e rregullta përbejnë rreth 89 për qind të vëllimit dhe rreth 72 për qind të vlerës së transaksioneve të SEKN-së. Ato kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale (një-deri te-një) ose si transaksione masive (një-deri te-shumë ose shumë-deri te-një). Ato procesohen përmes sesioneve të rregullta të kliringut dhe shlyhen në baza neto.

Transaksionet Kos-Giro përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të rregullta që po ashtu procesohen përmes sesioneve të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Ato kanalizohen përmes SEKN-së si transaksione masive (shumë-deri te-një). Përderisa transaksionet e rregullta individuale janë të destinuar për pagesat në përgjithësi dhe transaksionet e rregullta masive janë të destinuar për pagesat dhe arkëtimet e ndërmarrjeve dhe institucioneve të ndryshme, transaksionet Kos-Giro janë të destinuar për arkëtimet e

standardizuara dhe të automatizuara të entiteteve të mëdha faturuese. Gjatë vitit 2010 u shënua një rritje si e vëllimit ashtu edhe e vlerës së tyre.

Transaksionet prioritare (urgjente) procesohen dhe shlyhen menjëherë gjatë orarit të punës në baza bruto. Ngjashëm me transaksionet e rregullta, transaksionet prioritare mund të kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale ose si transaksione masive. Ato ende përfaqësojnë një pjesë të vogël të transaksioneve të gjithmbarshme të SEKN-së. Në vitin 2010, sa i përket vëllimito përfaqësuan më pak se 1 për qind të transaksioneve, ndërsa sa i përket vlerës, ato arritën të përfaqësojnë mbi 12 për qind të transaksioneve. Ky lloj i transaksioneve vazhdon të përdoret kryesisht për kryerjen e pagesave urgjente dhe të atyre me vlera më të mëdha.

Debitimi Direkt si instrument dhe skemë e re e pagesave në Kosovë është lansuar në nëntor 2009. Me anë të skemës së Debitimit Direkt ofrohet një mundësi e avancuar e kryerjes automatike të pagesave periodike nga llogaria bankare. Pagesat periodike që mund të kryhen përmes kësaj skeme kanë të bëjnë në radhë të parë me shpenzimet mujore shtëpiake apo afariste si furnizimi me energji elektrike, furnizimi me ujë, telefonja, ngrohja, mirëmbajtja etj. Si lloj i ri i transaksioneve të SEKN-së akoma nuk përdoret në atë masë sa llojet e tjera. Gjatë vitit 2010, Debitimi Direkt përfaqësoi më pak se 1 për qind si të vëllimit ashtu edhe të vlerës së transaksioneve të SEKN-së. Gjatë vitit 2011, tri kompani të reja iu bashkuan skemës së Debitimit Direkt.

Në kuadër të avancimit të operimit të SEKN-së duhet theksuar se në fund të vitit 2010 me finalizimin e implementimit të ngritjes së sistemit bankar bazë të BQK-së u arrit automatizimin i ndërfaqeve në mes të tij dhe SEKN-së, që rezultoi me ngritje të efikasitetit dhe të sigurisë.

Zhvillimet e përgjithshme, analiza dhe mbikëqyrja e sistemeve të pagesave

Në kuadër të implementimit të Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave, gjatë vitit 2010, fillimisht u bë konstituimi i Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) siç ishte paraparë në shtyllën përkatëse të saj. KKP-ja përbëhet nga përfaqësues të BQK-së, Thesari/MEF-it, ShBK-së dhe bankave komerciale të përfaqësuara në Bordin drejtues të ShBK-së. Ka një strukturë formale me Guvernatorin/Zëvendësguvernatorin e BQK-së si kryesues dhe sekretariati gjithashtu sigurohet nga BQK-ja. Përfaqësuesit e caktuar të akterëve janë kryeshefat ekzekutivë të tyre. KKP-ja synon të mbështesë arritjen e sistemeve të qëndrueshme dhe efikase për kliringun dhe shlyerjen e pagesave dhe letrave me vlerë në Kosovë. Gjithashtu mund të shërbejë si një forum për bashkëpunim për sigurimin e kushteve të duhura në sistemet rajonale dhe ndërkombëtare të pagesave. Në kuadër të KKP-së u konsolidua dhe filloi së vepruari edhe grupi i veçantë i punës për reduktimin e pagesave me para të gatshme në Kosovë. Gjatë vitit 2010 u bë edhe konstituimi i grupeve punuese për të gjitha shtyllat e tjera të parapara në strategji: I) korniza ligjore, II) pagesat me vlera të mëdha dhe ato urgjente, III) pagesat me vlera të vogla, IV) transaksionet qeveritare, V) letrat me vlerë, VI) tregu monetar, VII) dërgesat nga jashtë dhe VIII) mbikëqyrja e sistemit të pagesave. Në kuadër të tyre u punua për përgatitjen e termave të referencës për sistemet e reja të pagesave (shtyllat II, IV, V dhe VI) dhe në draftimin e ligjit mbi sistemin e pagesave (shtylla I).

Në fushën e mbikëqyrjes dhe analizave, me qëllim të publikimit të treguesve analitikë për instrumentet e pagesave në Kosovë, gjatë vitit 2010 u rishikua dhe plotësua Metodologjia për Raportimin e Instrumenteve të Pagesave. Kjo metodologji synon:

Grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave periodike dhe ndërtimin e një baze të dhënash mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Kosovë.


Monitorimin e zhvillimeve në fushën e sistemeve të pagesave në mënyrë që të vlerësohet shkalla e rreziqeve që përmbajnë këto dhe të sigurohet transparenca në marrëveshjet që kanë të bëjnë me instrumentet dhe shërbimet e pagesave.

Avancimin e publikimeve mbi instrumentet e pagesave në pajtim me raportet nga Banka Qendrore Evropiane dhe Banka për Shlyerje Ndërkombëtare, duke synuar kështu publikimin e të dhënave për Kosovë në botimet përkatëse në të ardhmen e afërt.

Analizimi i zhvillimeve në sferën e instrumenteve të pagesave në Kosovë karshi shteteve në Evropën Juglindore dhe Qendrore.


Nga të dhënat e mbledhura dhe të analizuar gjatë vitit 2010 është krijuar një pasqyrë e gjerë mbi nivelin e zhvillimit të sistemit kombëtar të pagesave. Në përgjithësi, vërehet se infrastruktura dhe instrumentet e pagesave po zhvillohen me një ritëm të shpejtë. Në

Figura 78. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2011)

Figura 79. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit




Burimi: BQK (2011)

vazhdimësi numri i kartelave me funksion pagese është rritur. Rrjeti i terminaleve të bankave në Kosovë po ashtu është në rritje. Në dhjetor të vitit 2010, janë raportuar afër 481 mijë kartela me funksion debiti, afër 38 mijë kartela me funksion krediti dhe mbi 8 mijë kartela me parapagim. Këto kartela kanë mundur të përdoren në mbi 400 terminale ATM (bankomatë) dhe mbi 6,100 terminale POS (pika të shitjes) të vendosura gjithandej Kosovës.


Në krahasim me vitin paraprak, si numri i dy llojeve të terminaleve ATM ashtu edhe numri i terminaleve POS janë rritur për rreth 20%.

Figura 80. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2011)

Figura 81. Numri i terminaleve POS



Burimi: BQK (2011)

Gjatë vitit të fundit, të gjitha bankat në Kosovë kanë filluar të ofrojnë shërbimin për banking interneti (e-banking) për klientët e tyre. Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2010, numri total i llogarive bankare të klientëve, të vlefshme për të kryer pagesa, është afër 1.4 milionë, nga të cilat mbi 50 mijë apo rreth 4 për qind përdorin banking interneti. Nga llogaritë që përdorin banking interneti, 84 për qind janë llogari individuale dhe 16 për qind llogari afariste. Në krahasim me vitin paraprak, rritja e numrit të përgjithshëm të këtyre llogarive ishte 23 për qind. Numri dhe vlera e transfereve të kryera me banking interneti është po ashtu në rritje.

Sa i përket numrit të terminaleve për 1 milion banorë, Kosova qëndron nën mesataren e vendeve në rajon, mirëpo ritmi i shtimit vjetor të numrit të terminaleve është mbi mesataren e këtyre vendeve. Situata e ngjashme është edhe tek kartelat bankare.

Tabela 22. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave


Përshkrimi	Kosova	Shqipëria	Republika Çeke	Turqia	Sllovenia	Bullgaria	Hungaria	Bosnja	Mali i Zi	Kroacia	Maqedonia
Banorë	2.1	3.16	10.51	74.8	2.04	7.54	10.02	3.77	0.62	4.42	2.04
Sipërfaqja (km²)	10,887	28,748	78,865	783,562	20,273	110,879	93,028	51,197	13,812	56,594	25,713
Densiteti (për km ²)	193	110	133	95	101	68	108	74	45	78	79
ATM	415	741	3,573	23,952	1,786	5,471	4,748	1,355	295	3,601	832
për 1 milion banorë	198	234	340	320	875	726	474	359	476	815	408
për 100 km ²	4	3	5	3	9	5	5	3	2	6	3
POS	6,194	4,370	77,797	1,731,397	36,720	59,449	70,960	16,259	7,202	85,804	31,447
për 1 milion banorë	2,950	1,383	7,402	23,147	18,000	7,884	7,082	4,313	11,616	19,413	15,415
për 100 km ²	57	15	99	221	181	54	76	32	52	152	122
Kredit Kartelat	37,922	23,844	1,536,882	44,392,600	122,811	1,050,566	1,505,439	-	56,935	2,044,621	188,612
për 1 milion banorë	18,058	7,546	146,230	593,484	60,201	139,332	150,243	-	91,831	462,584	92,457
Debit Kartelat	480,659	543,141	7,811,609	64,661,900	2,611,307	6,631,214	7,266,081	-	318,875	6,489,163	1,021,370
për 1 milion banorë	228,885	171,880	743,255	864,464	1,280,052	879,471	725,158	-	514,315	1,468,136	500,672
E-Banking	40,924	15,034	-	5,169,129	-	-	-	52,000	18,155	919,009	296,914

Burimi: BQK (2011) dhe bankat qendrore apo autoritetet mbikëqyrëse të shteteve përkatëse

5.5. Regjistri i kredive


Furnizimi i institucioneve kredidhënëse dhe kredimarrësve me informacionet kreditore individuale përmes sistemit të Regjistrit të Kredive të Kosovës (RKK) është një shërbim me rëndësi i zhvilluar dhe menaxhuar nga ana e BQK-së.

Figura 82. Numri i çertifikatave të gjeneruara



Burimi: BQK (2011)

Figura 83. Numri i kredive të raportuara në baza mujore gjatë vitit 2010



Burimi: BQK (2011)


RKK-ja është dizajnuar si një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qaset drejtpërdrejt në kohë reale nga zyrtarët e certifikuar të institucioneve kredidhënëse. Zyrtarët e certifikuar të institucioneve kredidhënëse në RKK i raportojnë të dhënat relevante mbi kreditë e lejuara dhe i azhurnojnë ato të dhëna rregullisht deri në kthimin e

këtyre kredive të lejuara. Numri i certifikatave të reja të gjeneruara dhe numri i kredive të reja të raportuara në RKK janë të paraqitura në baza mujore në figurat e mësipërme.

Në anën tjetër, RKK-ja u shërben zyrtarëve të certifikuar të institucioneve kredidhënëse për të kërkuar informacionin kreditor personal për vlerësim të aplikacioneve për kredi dhe për përcjellje të gjendjes së kredimarrësve. Subjekte të informacionit të RKK-së janë personat fizikë dhe bizneset si kredimarrës individualë. Nëse konsiderohet e nevojshme, p.sh. për të verifikuar shënime të diskutueshme, çdo kredimarrës individual mund të marrë nga BQK-ja informacionin e vet kreditor të regjistruar në RKK. Në figurat e mësipërme është paraqitur në baza mujore numri i kërkimeve të kryera nga zyrtarët e certifikuar të institucioneve kredidhënëse dhe numri i raporteve të detajuara të gjeneruara dhe të shpërndara në bazë të kërkesave të kredimarrësve individualë.


Sa i përket zhvillimeve të reja gjatë vitit 2010, vlen të theksohet angazhimi në kuadër të një programi trevjeçar të USAID-it për zhvillimin e mjedisit afarist në Kosovë, në të cilin përfshihet edhe avancimi i informacionit kreditor.

Figura 84. Numri i kërkimeve në baza mujore për vitin 2010



Burimi: BQK (2011)

Figura 85. Numri i raporteve të detajuara



Burimi: BQK (2011)

Avancimi do të përfshijë implementimin e ndryshimeve në RKK dhe në funksione të departamenteve të ndryshme relevante në BQK. Për të lehtësuar aktivitetet e parapara, BQK-ja ka formuar një grup të përbashkët punues me ekspertët e USAID-it.

5.6. Aktivitetet në fushën e statistikave dhe analizave ekonomike

Viti 2010 karakterizohet me zhvillime shumëdimensionale si në fushën e statistikave e po ashtu edhe në atë të analizave ekonomike. Krahas pranimit ndërkombëtar të statistikave të përpiluara, është pranuar edhe ekspertiza e vet stafit të Drejtorisë së Statistikave të BQK-së, përmes përfshirjes në listën e ekspertëve të FMN-së për statistika monetare dhe financiare. Kjo bëri që BQK-ja të jetë jo vetëm pranues, por edhe dhënës i asistencës teknike për vendet tjera në regjion.

E arritur e veçantë në kuadër të funksionit statistikor të BQK-së për vitin 2010 është edhe dërgimi i statistikave të bilancit të pagesave në FMN në frekuencë tremujore, në kuadër të publikimeve siç janë *International Financial Statistics* dhe *Balance of Payments Statistical Yearbook*, krahas statistikave monetare dhe financiare të dërguara në vitin 2009. Kjo dëshmon edhe cilësinë e pranuar ndërkombëtarisht të statistikave të bilancit të pagesave të përpiluara nga BQK-ja.

Gjatë vitit 2010 janë implementuar versionet e reja të Raportit Statistikor Bankar (RSB), Raportit mbi Normat e Kamatës (RNK) dhe Sistemit të Raportimit të Transaksioneve

Ndërkombëtare (SRTN). Implementimi i versioneve të reja të këtyre projekteve statistikore ka qenë në funksion të përcjelljes të zhvillimeve në tregun bankar në Kosovë konsistent me standardet ndërkombëtare statistikore. Kjo ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë dhe gamës së statistikave të përpiluara dhe publikuara nga BQK-ja.

Që nga janari i vitit 2010, kanë filluar të publikohen seritë kohore në një standard të ri ku përfshihen statistikat që janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e BQK-së, siç janë: statistikat monetare dhe financiare si dhe ato të bilancit të pagesave. Po ashtu, gjatë vitit 2010 është vazhduar me publikimin e Buletinit Mujor Statistikor ku njëherësh edicioni i dhjetorit 2010 përbënë edicionin e 113-të, duke nënkuptuar ngritje të vazhdueshme si në cilësi e po ashtu edhe në sasi të informatave të prezantuara në buletin.

Konform marrëveshjes me FMN-në lidhur me programin “Stand-By”, që nga gushti 2010, janë raportuar statistikat e zgjedhura monetare dhe financiare dhe të bilancit të pagesave në FMN. Po ashtu, në kuadër të këtij programi parashihet që BQK-ja të jetë bartëse lidhur me Sistemin e Përgjithshëm të Shpërndarjes së të Dhënave (*angl. General Data Dissemination Standard: GDDS*), çështje e cila pritet të finalizohet me sukses qysh në fillim të vitit 2011.

Aktiviteti i Drejtorisë për Analiza Ekonomike (DAE) gjatë vitit 2010 u karakterizua me avancimin dhe zgjerimin e publikimeve periodike dhe joperiodike të BQK-së. Në

Me punimin e tij “Determinants of Foreign Direct Investment in South East European Countries (SEEC)”, Bejtush Kiçmari, statisticien në Drejtorinë e Statistikave të BQK-së, në vitin 2010 fitoi çmimin prestigjioz “Olga Radzyner”, i cili për çdo vit ndahet nga Banka Nacionale e Austrisë për punimet më të mira shkencore në fushën e ekonomisë.

Më parë (viti 2008), fitues i këtij çmimi ka qenë edhe Sokol Havolli nga Drejtoria për Analiza Ekonomike në BQK, me punimin e tij “Determinants of Emigrant Earnings and Remittances: Evidence from Kosovo”.

këtë kontekst, zhvillimi më i rëndësishëm ishte publikimi i numrit të parë të Raportit të Stabilitetit Financiar, i cili paraqet një vazhdimësi të Buletinit të Sektorit Financiar, por me përmbajtje të zgjeruar që mundëson prezantimin e një pasqyre më të kompletuar për sa i përket stabilitetit të sektorit financiar në vend. Përveç pjesëve ku janë përshkruar zhvillimet në ekonominë globale dhe atë vendore si dhe zhvillimet në sektorin financiar të vendit (me fokus në sektorin bankar), në Raportin e Stabilitetit Financiar po ashtu janë paraqitur një numër i analizave specifike, të cilat kanë trajtuar segmente të veçanta që ndërlidhen me operimin e sektorit financiar në vend. Gjatë vitit 2010, DAE po ashtu filloi me përpilimin e modelit makroekonomik për ekonominë e Kosovës, me çka synohet krijimi i një platforme për analizimin dhe parashikimin e zhvillimeve ekonomike në vend. Progres i theksuar është shënuar edhe për sa i përket përpilimit të “stres-testit” për sektorin bankar të Kosovës, ku në bashkëpunim me misionin e FMN-së, është arritur të inkorporohen parashikimet mbi rritjen ekonomike në vlerësimin e rrezikut kreditor si dhe është kaluar në një nivel më të avancuar të vlerësimit të rrezikut të likuiditetit.

Gjatë këtij viti, DAE ka vazhduar të përpilojë rregullisht vlerësimin e tremujorit, që publikohet në çdo tre muaj në kuadër të Buletinit Mujor Statistikor. Përmes këtij publikimi është ofruar një pasqyrë e zhvillimeve ekonomike për secilin tremujor. Në kuadër të vlerësimit të tremujorit, në vitin 2010 është filluar të prezantohen analiza specifike mbi zhvillimet në sektorë të caktuar të ekonomisë.

Buletini i Bilancit të Pagesave paraqet një publikim tjetër periodik në kuadër të aktivitetit të DAE-s, ku ofrohet një pasqyrë e zhvillimeve në bilancin e pagesave të Kosovës, duke përfshirë edhe zhvillimet në ekonominë globale si dhe zhvillimet makroekonomike në vend.

Gjatë vitit 2010, po ashtu është bërë transformimi i Treguesve të Shpejtë Ekonomik në Indikatorët të Paralajmërimit të Hershëm (IPH). IPH-të paraqesin një raport të brendshëm, i cili përpilohet në baza mujore dhe ka për qëllim informimin e organeve vendimmarrëse të BQK-së mbi zhvillimet më të reja ekonomike në vend, duke vënë theksin në identifikimin e rreziqeve të mundshme për ekonominë e vendit.

Gjatë vitit 2010, stafi i Drejtorisë së Statistikës dhe Drejtorisë së Analizave Ekonomike ka marrë pjesë në takime dhe konferenca të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë edhe disa nga konferencat e organizuara nga BQK-ja. Nga konferencat ndërkombëtare vlen të theksohet pjesëmarrja me punime të stafit të DAE në konferencën *'European Economic Integration'* të organizuar nga Banka Qendrore e Austrisë në Vjenë, pjesëmarrja në takimet e FMN-së, Eurostat-it, etj.

6. Zhvillimet e brendshme

6.1. Kontrolli i brendshëm

Shefi i Auditimit të Brendshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë e Shefit të Auditimit të Brendshëm (ShAB) janë të rregulluara dhe të përcaktuara me Ligjin e BQK-së (nenet 60 dhe 61). Edhe gjatë vitit 2010, ShAB-i ka vazhduar të jetë i fokusuar në fushat si auditimi i brendshëm, kontrolli dhe implementimi i buxhetit dhe analizat operacionale.

Auditimi i brendshëm

Auditimi i brendshëm gjatë vitit 2010 ka vepruar në bazë të planit vjetor të propozuar nga ShAB-i, ndërsa të aprovuar nga Komiteti i Auditimit si dhe vetë Bordi i Bankës Qendrore.

Plani vjetor i auditimit për vitin 2010 është hartuar duke marrë për bazë përgatitjen profesionale dhe eksperiencën e personelit të angazhuar në auditim si dhe rezultatet nga auditimet e viteve paraprake. Në këtë kontekst theks i veçantë i është kushtuar implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, pastaj përpilimit të manualit për auditimin e teknologjisë informative dhe trajnimi i auditorit për auditimin e mbikëqyrjes financiare.

Auditimet në BQK janë kryer në bazë të Planit Vjetor të punës të paraprirë nga Vlerësimi Vjetor i riskut në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të brendshëm të Institutit të Auditorëve të brendshëm-IIA (*anglisht: Institute of Internal Auditors*) si dhe në pajtim me nenin 11 të Statutit të Auditimit të brendshëm. Më konkretisht, me rastin e hartimit të Planit vjetor të auditimit, Auditimi i brendshëm është bazuar në standardet si në vijim: Standardi 1110. A1; Standardi 2010; Standardi 2010. A1; Standardi 2010. C1. Aprovimi i Planit vjetor të punës së Auditimit të brendshëm është bërë po ashtu konform Standardit 2020 që dmth. se fillimisht është aprovuar nga Komiteti i Auditimit si organ i pavarur, ndërsa aprovimi final është bërë nga Bordi i BQK-së. Plani Vjetor i Auditimit ka qenë në pajtim me dinamikën e zhvillimeve, objektivave dhe Planit Strategjik të BQK-së për periudhën 2010-2015.

Auditimet të bazuara në risk paraprijnë që auditimet të fokusohen më shpesh aty ku humbja materiale dhe reputacioni është më e madhe që do të thotë se risku në bankën qendrore shërben si pikë nisje e auditorit. Rrjedhimisht, auditimet janë kryer në çdo muaj, , gjashtëmujore dhe vjetore. Këto fusha të identifikuara në vazhdim janë konsideruar të kenë rrezik më të shprehur që mund të shihen në paraqitjen tabelare dhe grafike si më poshtë.

Përpos auditimeve konform Planit Vjetor të auditimit, gjatë vitit 2010, janë performuar edhe disa auditime “ad hoc” me kërkesën e Bordit dhe menaxhmentit. Gjatë vitit 2010, Auditimi i brendshëm ka ekzaminuar, vlerësuar dhe raportuar mbi përshtatshmërinë e sistemeve të kontrolleve të brendshme të instaluar nga menaxhmenti.

Pas ekzaminimit dhe vlerësimit të sistemeve të kontrolleve të brendshme, testimi të transaksioneve dhe verifikimit të përputhshmërisë me ligjet, rregullat dhe rregulloret në fuqi, Auditimi i brendshëm ka përgatitur raporte me shkrim të cilët kanë të bashkangjitur dhe letrat e punës që dokumentojnë gjetjet nga auditimi i kryer. Raportet fillimisht konsiderohen si draft raporte ndërsa pasi të diskutohen me menaxhmentin e fushë përkatëse dhe pasi të përfshihen edhe komentet me shkrim nga menaxhmenti raporti bëhet

final dhe nënshkruhet nga Shefi i Auditimit të brendshëm dhe i dërgohet organeve vendimarrëse në BQK, ndërsa në çdo muajgjatjet ,rekomandimet,komentet e menaxhmentit dhe përcjellja e implementimit të rekomandimeve u dërgohen Komitetit të Auditimit i cili është i përbërë nga dy anëtarë joekzekutiv të Bordit të BQK-së.

Tabela 23. Përcaktimi i fushave të auditimit në bazë të riskut për tri vitet e fundit.

Drejtorati	2010	2009	2008
Arka dhe Trezori	17.8%	16.5%	14.0%
Menaxhimi i Mjeteve	11.0%	16.9%	14.0%
Teknologjia Informative	10.0%	4.2%	
Kontabiliteti	9.9%	15.6%	18.0%
Prokurimet	9.2%	10.4%	10.0%
Shërbimet e Përgjithshme	9.1%	8.3%	
Resurset Humane	8.8%	9.4%	
Mbikëqyrja Financiare	6.4%		

Burimi: BQK 2011

Pastaj, përmes Komitetit të Auditimit njoftohet dhe Bordi i Bankës Qendrore për statusin e implementimit të rekomandimeve të bëra nga Auditimi i brendshëm.

Përveç Planit Vjetor si dhe “ad hoc” auditimeve edhe gjatë vitit 2010 është performuar auditimi në çdo javëi operacioneve të investimeve në letra me vlerë dhe depozita të afatizuara. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2010 janë përgatitur 52 raporte speciale për përcjelljen e të gjitha investimeve si në tregun e parasë po ashtu dhe në letrat me vlerë. Kësaj fushe i është dhënë rëndësi e veçantë sidomos që nga viti 2008 për shkak të krizës globale financiare.

Gjatë vitit 2010, Auditimi i brendshëm është fokusuar në aktivitetet e Teknologjisë Informative pasi që sipas metodologjisë “bazuar në risk” është vlerësuar se risku aty është i madh kur kihet parasysh se BQK-ja operon me një varg sistemesh që kërkojnë auditim gjithëpërfshirës,përderisa në monitorimin e procesit të rinumërimit të parave për dërgesa jashtë vendit Auditimi është aktivizuar vetëm gjatë tremujorit të parë të vitit 2010.

Me hyrjen e Kosovës në program “Stand-By” me FMN-në,Auditimit të brendshëm i është besuar detyra e auditimit të pavarur të barazimit të llogarive të Qeverisë së Kosovës.

Sipas Programit me FMN-në, BQK-ja raporton dy herë në muaj për të gjitha llogaritë e Qeverisë, ndërkaq Departamenti i Thesarit raporton në çdo muaj,përderisa Auditimi i brendshëm i BQK-së raporton 45 ditë pas çdo date testuese që paraqet datën e fundit të çdo tremujori. Rrjedhimisht ky lloj auditimi është duke u performuar çdo tremuj të vitit, respektivisht gjatë vitit 2010 janë performuar 2 auditime të këtij fushëveprimi dhe raportet janë dërguar në FMN ,që kanë përfshirë tremujorin e III korrik-shtator 2010 dhe tremujorin e IV tetor-dhjetor 2010. Me qëllim të kryerjes të auditimit të tillë është hartuar edhe procedura konform rekomandimeve të FMN-së.

Edhe në vitin 2010 i është kushtuar rëndësi ngritjes profesionale të personelit të Auditimit të brendshëm, përmes trajnimeve, seminareve ndërkombëtare dhe kombëtare, studimeve postdiplomike si dhe thellimit të bashkëpunimit me bankat qendrore të regjionit dhe institucionet profesionale: Instituti i Auditorëve të Brendshëm (Institute of Internal Audit- IIA) dhe Shoqata e Auditimit të Sistemeve Informative dhe Kontrollit- (Information Systems Audit and Control Association- ISACA).

6.1.1. Kontrolli dhe implementimi i buxhetit dhe analizat operacionale

Edhe gjatë vitit 2010, kontrolli dhe implementimi i buxhetit ka kontribuar në realizimin e objektivave strategjike të BQK-së nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të shfrytëzimit sa më racional dhe efektiv të resurseve në dispozicion dhe në harmoni me buxhetin e aprovuar nga Bordi i BQK-së.

Raportet e kontrollës dhe implementimit të buxhetit dhe analizat operacionale janë përgatitur për çdo muaj, ndërsa nuk është konstatuar ndonjë devijim substancial nga linjat buxhetore. Arritje të dukshme janë bërë sa i përket kontrolleve dhe implementimit të linjave të buxhetit të BQK-së në fushën e të hyrave që realizohen nga interesi në plasmanët e afatizuara në bankat e jashtme dhe nga letrat me vlerë si dhe tek mirëmbajtja dhe evidenca mujore e depozitave të klientëve si dhe e plasmanëve të BQK-së në bankat e jashtme (te hyrat dhe shpenzimet e interesit).

6.2. Burimet njerëzore


Qëllimi i burimeve njerëzore vazhdon të mbetet zhvillimi i personelit në përputhje me objektivat e BQK-së, nëpërmjet zhvillimit të politikave për marrëdhënie pune në BQK dhe Kodit të Etikës dhe Mirësjelljes, politikës dhe procedurave të trajnimit dhe zhvillimit të personelit, procesit të udhëheqjes së suksesit në punë/performancës së të punësuarve, analizës së kompetencave dhe planifikimit të objektivave individuale afariste dhe nevojave individuale të edukimit të të punësuarve, në mënyrë që të orientohet i tërë potenciali njerëzor në pajtim me arritjen e synimeve, qëllimeve dhe objektivave të BQK-së.

Me qëllim të rritjes së efektivitetit në punë përmes administrimit më efikas në punë, shërbimit më të mirë, kualitetit të informacionit, komunikimit, marrjes së vendimeve, rekrutimit *on-line* burimet njerëzore gjatë vitit 2010 kanë implementuar softuerin e burimeve njerëzore me një databazë funksionale.

Gjatë vitit 2010 numri mesatar i gjithsej të punësuarve ka qenë 165, e që është për 2.4% më i lartë se vitin paraprak. Prej tyre 54% janë me diplomë universitare, 19% me diplomë pasuniversitare dhe 27% me shkollë të lartë, të mesme dhe fillore.

Nga të punësuarit me diploma pasuniversitare tre prej tyre janë në vijim të studimeve të doktoratës (PhD) dy jashtë vendit dhe një brenda vendit.

Figura 86. Struktura e kualifikimit të punonjësve të BQK-së



Burimi: BQK (2011)

Tabela 24. Trajnimet e ndjekura gjatë vitit 2010

Trajnimet e Organizuar nga:	Numri i Pjesëmarrësve
Banka Qendrore Evropiane, Frankfurt- Gjermani	24
Stabiliteti Financiar, Battenberg, Zvicër	1
Center of Excellence in Finance, Lubjanë, Slloveni	4
Joint Vienna Institute- Austri	10
Instituti për Stabilitet Financiar-FSI	1
Banka e Luksemburgut	1
Banka Kombëtare e Polonisë	5
Banka e Francës	7
Eurostat	1
Banka Federale e Rezervave Nju Jork	4
Deutsche Bundesbank, Gjermani	2
Shoqata e Bankave të Kosovës	2
Banka e Holandës	7
Banka Kombëtare e Austrisë	2
Banka Kombëtare e Çekisë	4
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Poloni	1
Asociacioni për Auditim dhe Kontroll të Sistemeve të Informacionit- ISACA	1
Instituti i Kosovës për Marrëdhënie me Publikun- IMP	2
Banka Qendrore e Maqedonisë	1
Banka Qendrore e Turqisë	2
Organizata Ndërkombëtare për Mbikëqyrësit e Pensioneve- IOPS	1
Oracle- Londër	1
Qendra Ndërkombëtare për Trajtime-Malta	1
Fondi Monetar Ndërkombëtar	1
Bordi i Tregut të Kapitalit Turk dhe Komisioni i tregut të letrave me vlerë të SHBA-ve	1
Solvenca Il-Zvicër	1
Banka Botërore -Zagreb	1
Asociacioni Zvicëran i Aktuarëve	1
Akademia Evropiane e Aktuaristikës-Zagreb	1
Qendra e BB për Reformat e Raportimit Financiar	2
Iniciativa për Trajtime për Mbikëqyrjen Financiare -TIFS	1
BQK	32
Shoqata e Bankave të Turqisë	1

Burimi: BQK 2011

Prej 165 të të punësuarve në vitin 2010, 47% të tyre ishin të gjinisë femërore.


Femrat në pozitat udhëheqëse gjatë vitit 2010 përbënin 33% të gjithë stafit në pozita udhëheqëse, gjë që paraqet një trend rritës të pjesëmarrjes së femrave në vendimmarrje krahasuar me vitet paraprake të funksionimit të BQK-së.

Mosha mesatare e gjithësej të punësuarve gjatë vitit 2010 sillet rreth 40 vjeçare.

Me qëllim të realizimit sa më efektiv të objektivave të saj, BQK-ja investon vazhdimisht në trajnimin dhe zhvillimin e personelit të saj përmes pjesëmarrjes në kurse, seminare, takime pune (workshop) si dhe programe akademike relevante për BQK-në.

Përveç mjeteve të vetë BQK-së, në vitin 2010 BQK-ja gëzoi përkrahje financiare për trajnime edhe nga Banka Botërore, me konkretisht Projektin e Asistencës Teknike për

Figura 87. Struktura gjinore në BQK



Burimi: BQK (2011)

Sektorin Financiar (*anglisht: Financial Sector Technical Assistance Project –FSTA*) dhe nga Banka Qendrore Evropiane.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vazhdimisht u ofron mundësi studentëve nga universitetet /kolegjet si nga vendi ashtu edhe nga jashtë mbajtjen e praktikës e njohur me emrin “internship” Gjatë vitit 2010, njëmbëdhjetë (11) studentë mbaruan me sukses praktikën në drejtorate të ndryshme të BQK-së.

6.3. Aktiviteti ligjor i BQK-së

Gjatë vitit 2010 janë shënuar suksese të dukshme në drejtim të forcimit dhe modernizimit të infrastrukturës ligjore. Kështu, gjatë këtij viti është miratuar Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me të cilin ligj përcaktohen në mënyrë të qartë objektivat dhe detyrat e Bankës Qendrore, në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Me Ligjin e ri për Bankën Qendrore është përcaktuar korniza ligjore për një bankë qendrore moderne me të gjitha atributet e nevojshme për arritjen e objektivave dhe kryerjen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj. Po gjatë këtij viti është miratuar edhe Ligji mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë. Ky ligj ka për objektiva mbrojtjen e depozitorëve të vegjël, ndërsa operacionalizimi i Fondit pritet të realizohet gjatë vitit 2011.

Me qëllim të modernizimit të legjislacionit nga lëmi i sektorit financiar dhe harmonizimit të tij me parimet themelore të direktivave të Unionit Evropian dhe standardet ndërkombëtare, në vitin 2010 është vazhduar edhe me hartimin e ligjeve tjera nga lëmi i sektorit financiar. Në këtë grup të ligjeve hynë: draft-ligji për bankat, draft-ligji për fondet pensionale, draft-ligji për sigurimin e detyrueshëm të auto-përgjegjësisë, si dhe draft-ligji për pagesa. Këto projektligje të cilat parashikohet të miratohen gjatë vitit 2011 do të zëvendësojnë rregulloret përkatëse ekzistuese.

Në zbatim të ligjit të ri për BQK-në, si dhe ligjeve tjera relevante, është vazhduar edhe me miratimin e një sërë akteve nënligjore të cilat kanë për qëllim funksionalizimin praktik të dispozitave të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, aktiviteti ligjor ka vazhduar edhe me lidhje të marrëveshjeve bashkëpunimi me institucione tjera vendore dhe të huaja, me qëllim të kryerjes sa më efikase të detyrave përkitazi me çështjet brenda fushave të kompetencave reciproke të institucioneve përkatëse.

Në përgjithësi, tërë aktiviteti ligjor gjatë këtij viti ka qenë i orientuar në zhvillimin e mëtutjeshëm të kornizës ligjore që ka mundësuar vazhdimin e funksionimit të sigurt dhe efektiv të sektorit financiar në Kosovë.

6.4. Menaxhimi i financave dhe i teknologjisë së informacionit

Në fushën e menaxhimit të financave dhe të teknologjisë së informacionit, BQK-ja gjatë vitit 2010 e bëri një hap të madh përpara me implementimin e ngritjes teknike dhe funksionale të sistemit të saj bankar bazë – *Oracle Flexcube*. Në kuadër të këtij projekti është përfshirë edhe implementimi i dy komponentëve të rinj softuerikë për letra me vlerë dhe për banking online. Ky projekt u iniciua në vitin 2009 (hulumtimet e nevojshme u kryen në gjysmën e dytë të vitit 2009 ndërsa miratimi final u bë në nëntor 2009) dhe filloi të implementohet në korrik 2010. Me këtë projekt sipas objektivave është arritur avancimi i funksionaliteteve të versionit paraprak (5.1) si dhe janë realizuar funksionalitete të reja të versionit të ri (11.0) që janë të kërkuara për BQK-në. Duhet theksuar avancimet e arritura lidhur me përgatitjen e informacioneve dhe raporteve financiare, procesimin e shpenzimeve, menaxhimin e mjeteve themelore, menaxhimin e buxhetit, menaxhimin e

llogarive të klientëve, kryerjen e pagesave vendore dhe ndërkombëtare, etj. Komponenti i ri për letra me vlerë ka mundësuar automatizimin dhe standardizimin e menaxhimit të letrave me vlerë të blera nga BQK-ja, ndërsa komponenti i ri për banking online ka arritur ofrimin e një avancimi të mëtejshëm të shërbimeve për klientët e BQK-së. Ky projekt zgjati gjatë gjithë gjysmës së dytë të vitit 2010 dhe sistemi zyrtarisht është vënë në funksion më 1 janar 2011. Vlen të theksohet se ky ishte projekti më i madh i realizuar ndonjëherë në BQK dhe në të ishin të përfshirë pos drejtorateve përgjegjëse për financa dhe teknologji të informacionit edhe drejtorati i operacioneve me para të gatshme dhe të pagesave dhe drejtorati i menaxhimit të mjeteve.

Menaxhimi i financave të BQK-së bëhet në kuadër të Drejtoratit të planifikimit dhe raportimit financiar. Ky Drejtorat është përgjegjës për veprimet kontabël, shërbimet financiare administrative dhe mbështetëse, procesin e buxhetimit, përgatitjen e raporteve financiare dhe kryerjen e analizave financiare. Gjatë vitit 2010, detyrat e rregullta u kryen me sukses dhe u arritën avancime në disa aspekte. Përveç angazhimit në avancim të sistemit bankar bazë të BQK-së, vlen të përmendet edhe përgatitja e Politikës së buxhetimit të BQK-së, plotësimi dhe azhurnimi i disa udhëzimeve të punës. Me asistencë teknike të FMN-së, u draftua edhe manuali i kontabilitetit, i cili do të miratohet në vitin 2011. Po ashtu u shtuan dhe u pasuruan raportet periodike financiare dhe analizat buxhetore. Në kuadër të rolit të BQK-së si agjent fiskal gjatë vitit 2010 u shënuar një angazhim i shtuar në bashkërendimin e marrëdhënieve me FMN-në në emër të shtetit të Kosovës si dhe në menaxhimin e aranzhimeve të veçanta financiare të BQK-së me Thesarin. Teknologjia e informacionit të BQK-së menaxhohet përmes drejtoratit përkatës. Detyra kryesore e Drejtoratit të teknologjisë dhe sistemeve të informacionit është të ofrojë mbështetje efikase të orientuar në shërbim të përdoruesve për fushat e ndryshme të punës së BQK-së. Ky Drejtorat është përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha sistemeve të informacionit të BQK-së. Gjatë vitit 2010, u shënuan disa zhvillime të reja me rëndësi. Përveç avancimit të sistemit bankar bazë të BQK-së, janë avancuar edhe një numër i komponentëve softuerikë dhe harduerikë të sistemeve të tjera të informacionit dhe janë punuar disa udhëzime dhe instruksione përkatëse. Vlen të theksohet futja në përdorim e lidhjeve me fije optike në komunikime të jashtme, që ka çuar në ngritje të efikasitetit dhe të sigurisë në këtë fushë. Gjithashtu edhe aktivizimi i automatizimit të aranzhimeve rezervë jashtë ndërtesës së BQK-së për sistemet e informacionit paraqet një ngjarje të rëndësishme në modernizimin e operacioneve.

7. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

7.1. Marrëveshjet Ndërkombëtare

Edhe gjatë vitit 2010, BQK-ja vazhdoi me angazhimet e saj për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të mirëkuptimit me institucione dhe agjenci simotra të vendeve të ndryshme. Gjate vitit të kaluar u nënshkruan këto marrëveshje mirëkuptimi:

Memorandumi i bashkëpunimit midis BQK-së dhe Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimeve të Malit të Zi.

Memorandumi i mirëkuptimit midis BQK-se dhe Agjencisë Mbikëqyrëse të Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë.

Memorandumi i mirëkuptimit mbi asistencën reciproke dhe shkëmbimin e informatave për çështjen e letrave me vlerë dhe mbikëqyrjes së sigurimeve midis BQK-së dhe Komisionit të Mbikëqyrjes Financiare Bullgare.

Padyshim, këto marrëveshje reciproke do të rrisin sasinë dhe cilësinë e informacionit te nevojshëm për të siguruar një mbikëqyrje efektive dhe efikase të institucioneve financiare nga ana e palëve nënshkruese si dhe do të mundësojnë një shkëmbim të përvojave dhe trajnim reciprok të personelit në fushat përkatëse.

7.2. Promovimi dhe përfaqësimi ndërkombëtar

BQK-ja ka vazhduar edhe në vitin 2010 të jetë organizatore dhe bashkëorganizatore e ngjarjeve më rëndësi për sektorin financiar dhe ekonominë e Kosovës. Kështu, gjatë vitit të kaluar ka organizuar ngjarje me rëndësi si:

i. Konferencën me rastin e publikimit të numrit të parë të Raportit të Stabilitetit Financiar të Kosovës, ku në mesin e pjesëmarrësve ishin edhe Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë si dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

ii. Konferenca ne temën *“Promovimi i Studimit mbi remitencat në Kosovë 2010”*, e përgatitur ne bashkëpunim të ngushtë të BQK-së, USAID-it, FMN-së, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave si dhe Entit të Statistikave të Kosovës. Ky studim si dhe konferenca e organizuar lidhur me të kanë ngritur shkallën e të kuptuarit më të mirë të rrjedhës, përdorimit dhe efekteve të dërgesave të emigrantëve në jetën e njerëzve, si dhe ndikimin e tyre në ekonominë e Kosovës në përgjithësi;

iii. Konferenca ne temën *“Perspektiva e sigurimeve në dritën e zhvillimeve të ardhshme”*, organizuar në bashkëpunim me Shoqatën e Kompanive të Sigurimeve të Kosovës. Prezantues në këtë konferencë ishin përfaqësues të institucioneve të Kosovës, autoriteteve rregullative të rajonit (Slloveni, Mal i Zi, Maqedoni dhe Shqipëri) dhe industrisë së sigurimeve, përfshirë edhe përfaqësues të Komitetit Ekzekutiv të Asociacionit Ndërkombëtar të Mbikëqyrëseve të Sigurimeve.

iv. Konferenca në temën *“Burimet e financimit për rritjen ekonomike: A ka para të mjaftueshme në Kosovë?”* në bashkëpunim me Zyrën Civile Ndërkombëtare (*anglisht: International Civilian Office – ICO*). Krahas BQK-së, prezantues në këtë konferencë ishin përfaqësues të ICO-së, të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, të FMN-së, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, përfaqësues të sektorit financiar të Kosovës si dhe të instituteve që merren me analiza makroekonomike.

v. Seminari në temën *“Një hap më afër liberalizimit të sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjesisë”*, i organizuar nga BQK-ja në bashkëpunim me Bankën Botërore. Ky seminar

tuboi ekspertë me renome botërore të fushës së sigurimeve, ndërsa ne mesin e jesëmarrësve pati përfaqësues nga Banka Botërore, Turqia, Italia, Britania e Madhe , zyrtarë te Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nga Shqipëria, përfaqësues nga Shoqata e Sigurimeve të Kosovës dhe nga kompanitë e sigurimeve që veprojnë në Kosovë.

Përfaqësuesit e BQK-së kanë marrë pjesë në të gjitha takimet e rregullta vjetore (pranverore dhe vjeshtore) të FMN-së dhe të Bankës Botërore që janë zhvilluar gjatë vitit 2010. Në këtë kontekst edhe obligimet që dalin nga anëtarësimi në këto dy institucione kanë vazhduar të kryhen me efikasitet të plotë, duke përfshirë raportimet e nevojshme, procedurat e votimit mbi çështje të caktuara e deri te pjesëmarrja aktive në mbledhjet e Konstituences belgo-austriake të cilës në vitin 2010 iu bashkëngjiti edhe Republika e Kosovës. Gjithashtu, menaxhmenti i lartë i BQK-së ka marrë pjesë aktive edhe në takimet vjetore dhe tryezat e Fondit Evropian për Evropën Juglindore i njohur me shkurtesën EFSE (*anglisht: European Fund for Southeastern Europe*), përkatësisht në punën e Bordit këshillues të EFSE-s, pastaj në punën e Bordit Këshillues dhe tryezat e organizuara nga ana e qendrës për zhvillimin e financave e njohur me emrin CEF (*anglisht: Center of Excellence in Finance*) me seli në Lubjanë.

Në kuadër të pjesëmarrjes në konferenca me rëndësi të veçantë ndërkombëtare vlen për të nënvizuar përfaqësimin e BQK-së në Konferencën e 5-të dyvjetore për menaxhim të rrezikut dhe mbikëqyrje financiare, organizuar nga Instituti për Stabilitet Financiar i Bankës për Marrëveshje Ndërkombëtare (*anglisht: Bank for International Settlements – BIS*), në Bazel (Zvicër), me ç'rast në kontekst të takimeve për fuqizim të bashkëpunimit ndërkombëtar është realizuar edhe një takim me Presidentin e Autoritetit Federal për Mbikëqyrje Financiare të Gjermanisë (BaFin). Gjithashtu, vlen të theksohet edhe përfaqësimi i BQK-së në Konferencën e 6-të të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) mbi bankungun qendror në temën “Rishikimi i qasjeve ndaj politikës monetare – mësimet e nxjerra nga kriza”, në të cilën krahas guvernatorëve dhe ekspertëve eminent botëror morën pjesë edhe Drejtori Menaxhues i FMN-se, Presidenti i BQE-së dhe Presidenti i Rezervave Federale të SHBA-ve.

Në kuadër të vizitave më rëndësi në BQK vlen të përmendet edhe vizita e delegacionit të afaristëve të rinj nga Chicago e SHBA-ve si dhe vizita e delegacionit të BQK-së realizuar në Agjensionin e Mbikëqyrjes dhe Rregullimit – (BRSA), Bankën Qendrore të Turqisë, Shoqatën e Bankave të Turqisë dhe Bordin për Tregje të Kapitalit të Turqisë.

Konform sfidave dhe prioriteteve të përcaktuara për vitin 2010 janë realizuar vizita zyrtare në Bankën Qendrore të Maqedonisë dhe Bankën Qendrore të Bullgarisë ku janë diskutuar mundësitë e gjetjes së formave të reja të bashkëpunimit, si dhe është diskutuar mundësia e arritjes së marrëveshjeve të mirëkuptimit për shkëmbim informatash dhe përvojash në mes autoriteteve. Vizitë të karakterit të ngjashëm është realizuar në Komisionin e Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë (më të cilin është nënshkruara Marrëveshja e Mirëkuptimit). Gjatë vitit që lamë pas vlen të përmendet se dinamika e bashkëpunimit është rritur dukshëm (kryesisht në sferën e trajnimit të stafit) më Bankën Qendrore të Shqipërisë, Bankën Qendrore të Polonisë dhe Bankën Qendrore të Sllovenisë më të cilën kemi një marrëveshje të nënshkruar për asistencë teknike e cila u jep mundësi stafit të BQK-së për të ndjekur mësim praktik në Bankën e Sllovenisë konform nevojave që identifikohen nga ana e BQK-së. Në vazhden e përpjekjeve për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e përgjegjësisve të saj BQK-ja gjatë vitit 2010 ka realizuar një varg aktivitete për gjetjen e modaliteteve të pranueshme për të siguruar qasje në Sistemin SWIFT (*anglisht: Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication*) dhe Sistemin e Kartonit të Gjellbër (*anglisht: Green Card System*).

8. Pasqyrat financiare të BQK-së



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

PASQYRA PËRMBLEDHËSE

FAQJA

Pasqyra e gjendjes financiare	1
Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe rezerva	3
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	4
Shënime mbi pasqyrat financiare	5 - 36



KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovo

Telephone +381(38) 246 771
Telefax +381 (38) 246 772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve te pavarur

Bordit Drejtues të
Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prishtine, 27 Maj 2011

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("Banka"), të cilat përbëhen nga pasqyra e gjendjes financiare të datës 31 dhjetor 2010, pasqyra përmbledhëse të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e rrjedhës të parave për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe kontrole të brendshme të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mbi përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyre që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.



Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marre është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhëne bazat për opinionin e auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të gjendjes financiare të Bankës me 31 dhjetor 2010, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave për vitin e mbyllur, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k, - Kosovo Branch
Rruga Sulejman Vokshi, 14
Prishtine
Kosove

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës


Pasqyra e gjendjes financiare

Më 31 dhjetor


<i>Në mijë Euro</i>	Shënimi	2010	2009
Aktivët			
Paraja e gatshme	7	60,194	21,806
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	25,621	34,899
Bono thesari	9	199,275	529,652
Depozita me bankat e huaja	10	807,332	487,529
Aktive të ndërlidhura më Fondin Monetar Ndërkombëtar ("FMN")	11	154,554	124,482
Aktive afatgjata materiale	12	1,736	2,115
Aktive afatgjata jo-materiale	13	898	174
Aktive të tjera	14	429	351
Gjithsej aktivët		<u>1,250,039</u>	<u>1,201,008</u>
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave vendase	15	203,572	233,246
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	153,868	124,786
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	798,721	665,187
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	43,228	130,847
Detyrime të tjera vendase	19	2,670	2,019
Gjithsej detyrimet		<u>1,202,059</u>	<u>1,156,085</u>
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali	20	30,000	30,000
Rezerva të përgjithshme	21	14,923	11,203
Fitimet e mbajtura		3,057	3,720
Gjithsej kapitali dhe rezervat		<u>47,980</u>	<u>44,923</u>
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		<u>1,250,039</u>	<u>1,201,008</u>

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 36 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare nga faqja 1 deri në faqen 36 u miratuan nga menaxhmenti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në 5 Prill 2011 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



 Gani Gerguri
 U.d. Guvernator



 Faton Ahmetaj
 Drejtor për Planifikim dhe Raportim
 Financiar

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

<i>Në mijë Euro</i>	Shënimi	2010	2009
Të ardhura nga interesi		4,574	6,629
Shpenzime për interes		(2,852)	(2,500)
Të ardhura nga interesi, neto	22	<u>1,722</u>	<u>4,129</u>
Të ardhura nga tarifa dhe komisione		2,575	2,462
Shpenzime për tarifa dhe komisione		(248)	(269)
Të ardhura nga tarifa dhe komisione, neto	23	<u>2,327</u>	<u>2,193</u>
Të ardhura nga grantet	24	57	24
Të ardhura operative të tjera	25	1,522	1,340
Fitimi / (humbja) nga kursi i këmbimit		1,408	(303)
Të ardhura operative të tjera		7,036	7,383
Shpenzime personeli	26	(2,395)	(2,160)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13	(564)	(505)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	27	(1,020)	(998)
Shpenzimet operative		(3,979)	(3,663)
Fitimi për vitin		3,057	3,720
Të ardhurat/(humbjet) e përmbledhura të tjera:		-	-
Gjithsej të ardhurat e përmbledhura për periudhën		3,057	3,720

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 36 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe rezerva

<i>Në mijë EUR</i>	Kapitali i autorizuar	Rezerva të përgjithshme	Fitim i pashpërndarë	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2009	30,000	3,736	7,467	41,203
Gjithsej të ardhurat e përmbledhura për periudhën				
Fitimi ose humbja	-	-	3,720	3,720
Gjithsej të ardhurat e përmbledhura për periudhën	-	-	3,720	3,720
Transaksionet e kërkuara me ligj, të regjistruara direkt në ekuitet				
Transferime në rezervën e përgjithshme	-	7,467	(7,467)	-
Gjithsej bartja në rezervën e përgjithshme		7,467	(7,467)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2009	30,000	11,203	3,720	44,923
Gjendja më 1 janar 2010	30,000	11,203	3,720	44,923
Gjithsej të ardhurat e përmbledhura për periudhën				
Fitimi ose humbja	-	-	3,057	3,057
Gjithsej të ardhurat e përmbledhura për periudhën	-	-	3,057	3,057
Transaksionet e kërkuara me ligj, të regjistruara direkt në ekuitet				
Transferime në rezervën e përgjithshme	-	3,720	(3,720)	-
Gjithsej bartja në rezervën e përgjithshme		3,720	(3,720)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2010	30,000	14,923	3,057	47,980

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 36 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e rrjedhjes së parasë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

<i>Në mijë Euro</i>	Shënimi	2010	2009
Rrjedhja e parave nga aktivitetet operacionale			
Fitimi për periudhën		3,057	3,720
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi	12	478	444
Amortizimi	13	86	61
Të ardhura nga grantet	24	(57)	(24)
Fitimi nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	(11)
Të ardhura nga interesi	22	(4,574)	(6,629)
Shpenzime për interes	22	2,852	2,500
		1,842	61
Ndryshime në bono thesari		250,380	(15,959)
Ndryshime në depozita me bankat e huaja		(163,904)	(61,824)
Ndryshime në aktive me FMN		(22,477)	(124,458)
Ndryshime në aktive të tjera		(85)	31
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave vendase		(29,674)	96,088
Ndryshime në detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN		21,490	124,761
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare		132,947	(243,129)
Ndryshime në detyrimet ndaj entiteve tregtare dhe publike		(87,619)	106,648
Ndryshime në detyrimet e tjera vendase		(654)	32
		103,554	(117,749)
Interesa të marra		4,119	9,160
Interesa të paguara		(2,347)	(2,574)
Rrjedhja neto e parave nga aktivitetet operacionale		105,326	(111,163)
Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese			
Shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	11
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	12	(99)	(472)
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	13	(810)	(149)
Rrjedhja neto e parave nga aktivitetet investuese		(909)	(610)
Rrjedhja e parave nga aktivitetet financuese			
Grante të marra		53	33
Rrjedhja neto e parave nga aktivitetet financuese		53	33
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		104,470	(111,740)
Diferencat nga kursi i këmbimit		-	(303)
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		618,835	730,878
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	29	723,305	618,835

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 36 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

Shënime mbi pasqyrat financiare

1. Subjekti raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje "BQK"), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si një person juridik sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një subjekt publik i veçantë i cili ka autoritetin për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në Republikën e Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje "ligji për BQK"). Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të nxisë sigurinë, aftësinë e pagimit dhe funksionimin efikas të sistemit financiar;
- të kontribuojë në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të brendshëm të çmimeve; dhe
- të mbështesë rregullat e përgjithshme ekonomike qeveritare.

Siç është përshkruar në ligj, BQK duhet të veprojë në përputhje me parimet e një tregu të hapur me një konkurrencë të lirë, duke favorizuar ndarjen efikase të resurseve.

BQK ushtron veprimtarinë e saj nga zyrat e saj qendrore në Prishtinë. Adresa zyrtare e BQK është si më poshtë:

Garibaldi nr. 33

Prishtinë, Kosovë.

Bordi i BQK-së, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori

Në BQK vendimet merren nga: Bordi i BQK-së, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori. Sipas ligjit për BQK-në, Bordi i BQK-së përbëhet nga: Guvernatori, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit dhe tre anëtarë jo-ekzekutivë që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e implementimit të politikave, administrimit dhe operacioneve të BQK-së.

Më 31 dhjetor 2010, Bordi i BQK-së përbëhej nga këta anëtarë:

- Gazmend Luboteni – Kryetar i Bordit
- Gani Gerguri – U.d. Guvernator
- Lulzim Ismajli – Anëtar, Drejtor i Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave
- Sejdi Rexhepi – Anëtar
- Mejdi Bektashi – Anëtar

2. Baza e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

2. Baza e përgatitjes (në vazhdim)

c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare prezantohen në Euro ("EUR"), e cila është monedha funksionale e BQK-së. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në Euro është rumbullakosur në mijëshen më të afërt.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti i BQK-së që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në bazë të vazhdueshmërisë. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, në shënimin 5 jepet informacion mbi elemente të rëndësishme në vlerësimin e pasigurive dhe mbi gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare.

Polikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

3. Politika të rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj vlerësohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datat e kryerjes së veprimeve. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të rivlerësuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të tregut rivlerësohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e tregut. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga rivlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave si fitim ose humbje.

b) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose një periudhë më e shkurtër kur është e përshtatshme) deri në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet në njohjen fillestare të aktivitetit ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet a paguara apo të arkëtuara, kostot e transaksioneve, dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejt për blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave përfshijnë interesat nga aktivitetet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuara mbi bazën e interesit efektiv.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

c) Tarifa dhe komisione (ndalesat) ne shërbime

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet (ndalesat) të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat, përfshirë tarifat e transaksioneve për llogaritë operative, transferimet e fondeve dhe tarifat e licencimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

d) Përfitimet e punonjësve

i. Plan pensioni me kontribute të përcaktuara

BQK paguan kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve kur dalin në pension. Këto kontribute klasifikohen sipas planeve me kontribute të përcaktuara bazuar në legjislacionin e Kosovës. Kontributet e BQK-së njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Gjithashtu, BQK-ja bën kontribute në plane (skema) pensioni sikurse lejohet nga legjislacioni i Kosovës, ku shteti siguron përfitime pensioni për punonjësit deri në daljen e tyre në pension. Këto kontribute për planet (skemat) e pensionit i ngarkohen si shpenzim fitimit ose humbjes në momentin kur ndodhin.

e) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

BQK-ja është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin sipas ligjit për BQK-në, i cili kërkon që BQK të paguajë tepricën e të ardhurave neto direkt në llogarinë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, pasi të ketë plotësuar nivelet e fondeve rezervë. Shih shënimin 4 (f) për me hollësisht.

f) Aktivet dhe detyrimet financiare

i. Njohja

BQK-ja fillimisht njihet depozitat në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën BQK bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të cilës i shtohen, për një artikull jo me vlerën e drejtë nëpërmjet duke i vlersuar përmes fitimit apo humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të tyre.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Aktivitet dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

ii. Çregjistrimi (Mosnjohja)

BQK-ja çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të rrjedhjeve të parasë që vijnë nga aktiviteti financiar, ose kur transferon të drejtat për të marrë rrjedhjet e kontraktuara të parasë mbi aktivitetin financiar përmes një transaksion në të cilin transferohen në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivitetit financiar. Interesat në aktivitetin financiar të transferuar të cilat janë krijuar apo mbajtur nga BQK-ja njihen si një aktiv apo detyrim i veçantë. Në çregjistrimin e një aktiviteti financiar, ndryshimi në mes të vlerës kontabël të aktivitetit (ose vlerës kontabël të ndarë në pjesën e aktivitetit të transferuar), dhe shumës së (i) vlerës së marrë (duke përfshirë çdo aset të ri që ka marrë minus çdo detyrim të ri të supozuar) dhe (ii) çdo përfitim apo humbje kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera të përmbledhura, njihet si fitim ose humbje.

BQK-ja çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

iii. Netimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma paraqitet neto në pasqyrën e gjendjes financiare atëherë dhe vetëm atëherë kur BQK-ja ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivitetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standartet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme.

iv. Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktiviteti ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktiviteti ose detyrimi financiar matet në momentin e njohjes fillestare, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

v. Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një aset mund të këmbëhet, ose një detyrim të shlyhet, në mes të palëve në një transaksion të vullnetshëm në datën e matjes (vlerësimi).

Kur është e disponueshme, BQK-ja mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për këtë instrument. Një treg konsiderohet si aktiv, nëse çmimet e kuotuar janë të disponueshme në mënyrë të shpejtë dhe përfaqësojnë transaksionet që ndodhin aktualisht në treg në bazë të vullnetshme midis palëve.

Nëse tregu për instrumentin financiar nuk është aktiv, BQK krijon vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit midis palëve të mirë informuara dhe të vullnetshme, (nëse janë të disponueshme), referimin në vlerën e drejtë aktuale të instrumenteve tjera që në thelb janë të njëjta, analizat e skontimit të rrjedhave të parasë dhe modelet e vlerësimit të çmimit. Teknika vlerësuese e zgjedhur, përdor maksimalisht të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në vlerësimet specifike të BQK-së, përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do t'i marrin parasysh në vendosjen e çmimit dhe janë në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për vendosjen e çmimit të instrumenteve financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Aktivitet dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

v. Matja e vlerës së drejtë (në vazhdim)

Të dhënat e teknikave të vlerësimit përfaqësojnë pritshmëritë e tregut dhe matjet e faktorëve të pashmangshëm risk-kthim në instrumentin financiar. BQK analizon teknikat e vlerësimit dhe e teston vlefshmërinë e tyre duke përdorur çmimet e tregut të mbikëqyrur nga transaksionet aktuale në instrument të njëjtë ose duke u bazuar në të dhënat e tjera që janë në dispozicion.

vi. Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (humbjes ne vlerë)

Në çdo datë raportimi BQK vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivitetet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e tregut përmes pasqyrës së të ardhurave ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivitetet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhjet e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që aktivitetet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një depozite apo paradhënie nga BQK-ja me kushte dhe afate të cilat BQK-ja nuk do t'i kishte konsideruar, të dhëna që një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një huamarrësi ose emetuesi të letrave me vlerë, ose kushte ekonomike që lidhen me sjelljen e vështirësive financiare në BQK.

Humbja ne vlerë (zhvlerësimi) i një aktiviteti financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve të ardhshme të vlerësuara të parave që skontojnë me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provizioni përkundrejt huave dhe paradhënieve. Interesat mbi aktivitetet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme.

Kur një ngjarje pas datës së bilancit tregon për zvogëlim të zhvlerësimit, zhvlerësimi anulohet nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave ose humbjeve.

g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në trezorë, llogari rrjedhëse me bankat dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo-domethënës të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga BQK-ja në administrimin e detyrimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e gjendjes financiar me kosto të amortizuar.

h) Letra me vlerë të investimit

Letrat me vlerë që mbahen për investim, që janë bonot e thesarit, njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të transaksionit, dhe në vijim trajtohen si investime që mbahen deri në maturim.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturitet fiks, të cilat BQK-ja ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bonot e thesarit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

h) Letra me vlerë (në vazhdim)

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shitja ose riklasifikimi përpara maturimit i një sasive të konsiderueshme të letrave me vlerë që mbahen deri në maturim, larg kohës së maturimit të tyre, do të rezultojë në një riklasifikim të të gjitha letrave me vlerë që mbahen deri në maturim si të disponueshme për shitje, dhe do të parandalonte BQK-në të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si të mbajtura deri në maturim gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

i) Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë BQK-ja përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore të drejtpërdrejtë, kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendjen funksionale që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur. Programe kompjuterike të blera që janë thelbësore për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

ii. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i atij aktivi të rrjedhin në BQK, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të përditshëm të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së secilës pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën e tashme dhe krahasuese është si më poshtë:

	2010	2009
• Investimet në objektet qiranë shfrytëzim	20 vjet	20 vjet
• Pajisjet	5 vjet	5 vjet
• Kompjuterë	3 vjet	3 vjet
• Automjete	5 vjet	5 vjet

Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rivlerësohen në datën e raportimit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

j) Asetet e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga BQK-ja njihen me koston historike të zvogëluar për amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime rrisin përfitimin e ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është 3 vjet (2009: 3 vjet).

k) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të BQK-së, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për rënie në vlerë. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron rrjedhje të parasë që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga rënia në vlerë e njësive gjeneruese të parasë shpërndahen në mënyrë proporcionale midis aktiveve të tjera të njësisë për të zvogëluar vlerën kontabël të tyre.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk egziston më. Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

l) Detyrimet financiare

Burimet e financimit të BQK-së janë depozitat nga institucionet ndërkombëtare, qeveritare, publike, bankare dhe institucione të tjera financiare. Detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

m) Të ardhurat nga grantet

Grantet njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ekziston një siguri e arsyeshme se ato do të merren dhe se BQK-ja do t'i përmbahet kushteve lidhur me grantin. Grantet që BQK-ja përfiton për shpenzime njihen si fitim ose humbje në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet përkatëse. Grantet që BQK-ja përfiton për koston e një aktivi njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të aktivitetit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

n) Pagat e financuara nga donatorët

Individë të caktuar të angazhuar në BQK janë ekspertë ndërkombëtarë të caktuar dhe financuar për një afat të shkurtër nga organizata ndërkombëtare. Financimi nga këto organizata ndërkombëtare ndër të tjera përfshin, por nuk kufizohet në pagesën e pagave të këtyre ekspertëve ndërkombëtarë. Duke qenë se kjo ndihmë i paguhet personave të caktuar drejtpërdrejt nga organizatat ndërkombëtare, nivelet e pagesës nuk janë të njohura dhe as nuk janë të përfshira në pasqyrat financiare.

o) Provizionet

Provizionet njihen nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale ligjore ose konstruktive që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e skontuar rrjedhjen e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme, rrezikun specifik për detyrimet.

Provizioni për kontrata të ngarkuara njihet kur përfitimet e pritura për t'u nxjerrë nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet në vlerën aktuale me më të voglën midis kostos së pritshme të ndërprerjes së kontratës dhe kostos së pritshme neto të vazhdimit të kontratës. Përpara se të njihet një provizion, BQK njeh çdo humbje nga rënia në vlerë e aktivitetit të lidhur me atë kontratë.

p) Standarde dhe interpretime të reja

Një sërë standardesh të reja, ndryshime apo interpretime të tyre ende nuk janë bërë efektive ose të relevante për vitin që mbyllet me 31 dhjetor 2010, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Nuk pritët që të kenë efekt në pasqyrat financiare të BQK-së në përjashtim të:

- SNRF 9 *Instrumentat Financiare* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 ose më pas, aplikimi i hershëm është i lejuar). Ky standard zëvendëson udhëzimet në SNK 39, *Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja*, në lidhje me klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Standardi eliminon kategoritë ekzistuese në SNK 39 për aktivet financiare të mbajtur deri në maturim, të gatshme për shitje dhe hua dhe të arkëtueshme.

Aktivet financiare do të klasifikohen në njërin nga dy kategoritë në njohjen fillestare:

- Aktive financiare të matur me koston të amortizuar ose
- Aktive financiare të matur në vlerën e drejtë.

Një aktiv financiar mund të matet me koston e amortizuar nëse plotësohen kushtet e mëposhtme: aktivi mbahet brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet për të mbledhur rrjedhjet monetare sipas termave kontraktuale; dhe, sipas termave kontraktuale rrjedhin rrjedhje monetare në data të përcaktuara që janë pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e papaguar në fund të periudhës.

Fitimet ose humbjet nga rimatja e aktiveve financiare me vlerë të drejtë njihen në fitim ose humbje, përveç rastit të një instrumenti investimi në kapital që nuk është mbajtur për

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

p) Standarde dhe interpretime të reja

t'u tregtuar, për të cilin SNRF 9 parashikon një zgjedhje definitive në njohjen fillestare për të paraqitur të gjitha ndryshimet nga vlera e drejtë e investimit në të ardhura të tjera përmbledhëse (të ATP). Zgjedhja është e disponueshme në bazë të çdo aksioni individual. Asnjë shumë e njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse nuk mund të riklasifikohet në fitim ose humbje në një datë të mëvonshme. BQK është duke përcaktuar ndikimin që do të ketë ky standard në aktivitetet e saj.

- Rishikimi i SNK 24 *Shpalosja për Palët e Lidhura* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2011). Rishikimi përjashton njësitë ekonomike të lidhura me qeverinë nga kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me transaksionet dhe gjendjen në fund të periudhës për palët e lidhura, duke përfshirë angazhimet me (a) një qeveri e cila ka kontroll, kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme mbi njësinë ekonomike raportuese; dhe b) një njësi tjetër ekonomike e cila është palë e lidhur sepse e njëjta qeveri ka kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme mbi të dyja, njësinë ekonomike raportuese dhe njësinë tjetër. Standardi i rishikuar kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese specifike nëse një njësi ekonomike përdor avantazhin e këtij përjashtimi.

Standardi i rishikuar gjithashtu zgjeron përkufizimin e palëve të lidhura e cila rezultoi në përfshirjen e marrëdhënieve të tjera, të tilla si, ortakët e aksionerit që ka kontrollin dhe njësitë ekonomike të kontrolluara ose në kontroll të përbashkët nga personeli drejtues kryesor. BQK është duke përcaktuar ndikimin që do të ketë ky standard në aktivitetet e saj.

4. Administrimi i Rrezikut Financiar

a) Prezantim dhe të përgjithshme

BQK është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kreditimit
- rreziku operacional
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e BQK-së ndaj rreziqeve të mësipëme si dhe objektivat, politikat dhe procedurat për matjen dhe administrimin e tyre si dhe për administrimin e kapitalit të BQK-së. Shënime të tjera sasiore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Struktura e administrimit të rrezikut

Krijimi dhe mbikëqyrja e strukturës së administrimit të rrezikut të BQK-së është përgjegjësi e Bordit ekzekutiv të BQK-së. Bordi ekzekutiv i BQK-së raporton rregullisht tek Bordi i BQK mbi veprimet e lidhura me administrimin e rrezikut. Bordi ekzekutiv dhe Komiteti i investimeve janë të angazhuar në zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut të BQK-së. Këto politika implementohen më pas nga njësitë organizative përkatëse.

Politikat e administrimit të rrezikut të BQK-së janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e ndeshura nga BQK-ja, për të vendosur limite dhe kontrole të përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve të vendosura. Politikat dhe sistemet e administrimit

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

Struktura e administrimit të rrezikut (në vazhdim)

të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Me anë të trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, BQK-ja synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i auditimit të BQK-së është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë me politikën dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut lidhur me rreziqet e ndeshura nga BQK-ja. Komiteti i auditimit të BQK-së ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga Drejtorati i auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmerr auditime të kontrolleve dhe të procedurave të administrimit të rrezikut në mënyrë të rregullt dhe rastësore, rezultatet e të cilave, përmes Shefit të auditimit të brendshëm raportohen te Komiteti i auditimit.

b) Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare për BQK-në nëse një klient ose një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon të përmbushë detyrimet kontraktuale të veta, dhe shkaktohet kryesisht nga investimet e BQK-së në letra me vlerë dhe depozitat në banka të tjera.

Administrimi i rrezikut të kreditimit

i. Investimet dhe ekspozimi në banka të tjera

BQK-ja e kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit duke investuar vetëm në letra me vlerë të emtuara nga qeveritë e vendeve të BE-së dhe duke pasur depozita pranë bankave të huaja, detyrimet afatshkurtra të të cilave janë të vlerësuara në një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë ndërkombëtare të njohura për vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Duke pasur vlerësimet e larta kreditore, menaxhmenti nuk pret që ndonjë nga palët kontraktuese të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të veta.

ii. Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditimit

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2010 dhe 31 dhjetor 2009 paraqitet nga vlera e mbartur e parasë në posedim, e llogarive rrjedhëse me bankat jo-rezidente, e bonove të thesarit dhe e depozitave me bankat jo-rezidente. Për detaje mbi ekspozimin referojuni shënimeve 7, 8, 9 dhe 10.

Asnjë nga ekspozimet e BQK-së nuk është në vonesë ose me rënie në vlerë. Nuk ka ndryshime në politikën e administrimit të rrezikut nga vitet e kaluara. BQK-ja nuk mban asnjë kolateral apo ndonjë element tjetër avancues kreditor kundrejt ekspozimit ndaj rrezikut të kreditimit.

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që BQK-ja nuk do të jetë në gjendje të përmbushë në kohën e duhur obligimet e lidhura me detyrimet financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar të dëmtojë reputacionin e saj.

Politikat e monitorimit dhe adresimit të rrezikut të likuiditetit janë të vendosura nga Bordi ekzekutiv. BQK-ja menaxhon rrezikun e likuiditetit duke investuar në depozita afatshkurtra me bankat jorezidente dhe duke mbajtur shumën të mjaftueshme të mjeteve monetare në trezorët e saj. Politikat e menaxhimit të likuiditetit janë të vendosura në një mënyrë të tillë që edhe në kushte të përkeqësuar BQK-ja të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj.

Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe teste të rregullta kryhen nën skenarë të ndryshëm si për kushte të tregut normale ashtu edhe për ato më të vështira. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit janë pjesë e rishikimit dhe aprovimit të Bordit ekzekutiv të BQK-së. Raportet ditore që mbulojnë pozicionin e likuiditetit të BQK-së u kalohen anëtarëve të Komitetit të investimeve nga Drejtorati i menaxhimit të mjeteve.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Maturiteti i mbetur kontraktual për detyrimet financiare

		Vlera e	Më pak		3 muaj
	Shënimi	mbartur	se 1 muaj	1-3 muaj	deri në 1 vit
31 dhjetor 2010					
<i>Detyrimet jo-derivative</i>					
Detyrime ndaj bankave vendase	15	203,572	203,572	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	153,868	131,775	-	22,093
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	798,721	497,145	226,351	75,225
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	43,228	43,228	-	-
Detyrime të tjera vendase	19	2,419	2,419	-	-
		1,201,808	878,139	226,351	97,318
31 dhjetor 2009					
<i>Detyrimet jo-derivative</i>					
Detyrime ndaj bankave vendase	15	233,246	233,246	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	124,786	124,786	-	-
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	665,187	540,084	50,024	75,079
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	130,847	130,847	-	-
Detyrime të tjera vendase	19	2,019	2,019	-	-
		1,156,085	1,030,982	50,024	75,079

Tabela e mësipërme tregon rrjedhjet e parasë të paskontuara të detyrimeve financiare të BQK-së bazuar në mundësinë më të herëshme të maturitetit të tyre kontraktual. Për administrimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, BQK mban aktive likuide që përfshijnë para dhe ekuivalentë të saj dhe letra me vlerë për të cilat ekziston një treg aktiv dhe likuid.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

Paqëndrueshmëria në tregjet financiare botërore dhe të Kosovës

Kriza ekonomike dhe financiare botërore ka rezultuar, përveç të tjerave, në një nivel më të ulët të financimit të tregut kapital, nivel më të ulët të likuiditetit në sektorin bankar, ulje të normave të interesit nga bankat qendrore për të ndihmuar huamarrësit, injektime të kapitalit nga qeveritë, norma më të larta ndërbankare interesi dhe paqëndrueshmëri në tregun e aksioneve. Zhvillimet e mëtejshme të pafavorshme që rezultojnë nga kriza mund të kenë ndikim në pozicionin financiar dhe të likuiditetit të BQK-së.

d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe normat kreditore (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të huamarrësit/emetuesit) do të ndikojë në të ardhurat e BQK-së apo vlerën e instrumenteve financiare të mbajtura nga ajo. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Administrimi i rrezikut të tregut

Operacionet e BQK-së i nënshtrohen rrezikut të luhatjes së normave të interesit në masën që aktivet dhe detyrimet që bartin interes maturohen ose riçmohen në kohë apo shuma të ndryshme. Aktivet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë të ekspozuara ndaj rrezikut bazë, i cili është ndryshimi në karakteristikat e riçimitit të indekseve të shumëllojshme me norma të ndryshueshme.

Veprimtaritë e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut konsistente me strategjitë e veprimit të BQK-së.

Ekspozimi i BQK-së ndaj rrezikut të tregut lidhet vetëm me portofolet jo të tregtueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut - portofolet jo të tregtueshme

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e rrjedhjeve të ardhshme të parasë apo e vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e tregut. Rreziku i normës së interesit kryesisht menaxhohet duke monitoruar diferencat midis normave të interesit dhe duke pasur limite paraprakisht të miratuara për intervalet e riçimitit. Komiteti i investimeve është autoriteti që monitoron zbatimin e këtyre limiteve. Një përmbledhje e pozicionit të BQK-së lidhur me diferencën midis normave të interesit të portofoleve jo të tregtueshme paraqitet si më poshtë:

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

Shënimi	Vlera e mbartur	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	
31 Dhjetor 2010						
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	25,621	25,621	-	-	
Bono thesari	9	199,275	69,902	94,665	34,708	
Depozita me bankat e huaja	10	807,332	567,765	103,143	136,424	
Aktive me FMN	11	154,554	132,461	-	22,093	
Gjithsej		1,186,782	795,749	197,808	171,132	22,093

Detyrime ndaj bankave vendase	15	(203,572)	(203,572)	-	-	-
Detyrime ndaj FMN	16	(153,868)	(131,775)	-	-	(22,093)
Detyrime ndaj insitucionve qeveritare	17	(798,721)	(527,101)	(100,222)	(171,398)	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(43,228)	(43,228)	-	-	-
Detyrime të tjera vendore		(2,419)	(2,419)	-	-	-
Gjithsej		(1,201,808)	(908,095)	(100,222)	(171,398)	(22,093)
Ndryshimi		(15,026)	(112,346)	97,586	(266)	-

Shënimi	Vlera e mbartur	Më pak se 3 muaj	3 - 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	
31 Dhjetor 2009						
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	34,899	34,899	-	-	-
Bono thesari	9	529,652	149,940	379,712	-	-
Depozita me bankat e huaja	10	487,529	412,270	50,208	25,051	-
Aktive me FMN	11	124,482	124,482	-	-	-
Gjithsej		1,176,562	721,591	429,920	25,051	-
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(233,246)	(233,246)	-	-	-
Detyrime ndaj FMN	16	(124,786)	(124,786)	-	-	-
Detyrime ndaj insitucionve qeveritare	17	(665,187)	(590,108)	(50,028)	(25,051)	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(130,847)	(130,847)	-	-	-
Detyrimet tjera vendore	19	(2,019)	(2,019)	-	-	-
Gjithsej		(1,156,085)	(1,081,006)	(50,028)	(25,051)	-
Ndryshimi		20,477	(359,415)	379,892	-	-

Aktivitet dhe detyrimet financiare që nuk mbartin interes nuk janë përfshirë në tabelën më lartë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

Rreziku i përgjithshëm jo-tregtar i normave të interesit jo të tregtueshme menagjohet nga Drejtorati i menaxhimit të mjeteve, i cili përdor investimet në letra me vlerë dhe depozitat në banka për të menaxhuar rrezikun e përgjithshëm që lind nga aktivitetet jo tregtare të BQK-së.

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limitit të hendekut të normave të interesit, kompletohet duke vëzhguar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standardë dhe jo-standardë të normave të interesit. Skenarët standardë të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë një rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit, prej 100 pikësh baze (bp). Një analizë e ndjeshmërisë së BQK-së ndaj një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

2010

	100 bp	100 bp
	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	141	(141)

2009

	100 bp	100 bp
	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	124	(124)

Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/valutore të portofoleve jo të tregtueshme

BQK-ja është e ekspozuar ndaj “Të Drejtave të Veçanta të Tërheqjes” (DVT) lidhur me aktivet dhe detyrimet e saj në FMN, të cilat i monitoron në vazhdueshmëri. Ekspozimi i BQK ndaj rrezikut të valutave të huaja është si vijon:

2010

	100 bp	100 bp
	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	7	(7)

2009

	100 bp	100 bp
	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	3	(3)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

31 Dhjetor 2010	EUR	DVT	Totali
Aktive			
Paraja e gatshme	60,194	-	60,194
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	25,621	-	25,621
Bono thesari	199,275	-	199,275
Depozita me bankat e huaja	807,332	-	807,332
Aktive me FMN	-	154,554	154,554
Aktive të tjera	429	-	429
Gjithsej	1,092,851	154,554	1,247,405
Detyrime			
Detyrime ndaj bankave vendase	203,572	-	203,572
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	72,982	80,886	153,868
Detyrime ndaj insitucionve qeveritare	798,721	-	798,721
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	43,228	-	43,228
Detyrime të tjera vendase	2,670	-	2,670
Gjithsej	1,121,173	80,886	1,202,059
Pozicioni neto për valuta të huaja	(28,322)	73,668	45,346
31 Dhjetor 2009	EUR	DVT	Totali
Aktive			
Paraja e gatshme	21,806	-	21,806
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	34,899	-	34,899
Bono thesari	529,652	-	529,652
Depozita me bankat e huaja	487,529	-	487,529
Aktive me FMN	-	124,482	124,482
Aktive të tjera	351	-	351
Gjithsej	1,074,237	124,482	1,198,719
Detyrime			
Detyrime ndaj bankave vendase	233,246	-	233,246
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	49,099	75,687	124,786
Detyrime ndaj insitucionve qeveritare	665,187	-	665,187
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	130,847	-	130,847
Detyrime të tjera vendase	2,019	-	2,019
Gjithsej	1,080,398	75,687	1,156,085
Pozicioni neto për valuta të huaja	(6,161)	48,795	42,634

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Menagjimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (në vazhdim)

BQK-ja kryesisht kryen veprime me Euro, ndërsa valutat e huaja me të cilat merret BQK-ja janë kryesisht DVT. Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 ishin si vijon:

	2010	2009
	EUR	EUR
1 DVT	1.159	1.088

DVT-të janë aktive plotësuese të rezervave valutore që përcaktohen dhe mbahen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Edhe pse DVT-të nuk janë valutë në vete, ato përfaqësojnë një kërkesë potenciale në valuta të vendeve anëtare të FMN-së me të cilat mund të këmbehen. DVT-të janë krijuar në vitin 1969 si pasojë e mungesës së aktiveve në valutat e preferuara të kohës si dollari amerikan dhe ari, vlera e DVT - ve përcaktohet si mesatare e shportës së katër valutave kryesore: euro, dollari amerikan, funta britaneze dhe jeni japonez.

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte apo indirekte që shkaktohen nga një shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e BQK-së, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën si dhe faktorët e tjerë të jashtëm përveç rrezikut kreditor, të tregut dhe likuiditetit, siç janë kërkesat ligjore dhe rregullatore si dhe standardet e pranura gjerësisht të sjelljes korporative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e BQK-së dhe prek të gjitha njësitë organizative. Objektivi i BQK-së është të menaxhojë rrezikun operacional si dhe të balancojë evitimin e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të BQK-së me administrimin efektiv të kostove. Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për monitorimin e rrezikut operacional i përket stafit menaxhues të çdo njësie organizative. Kjo përgjegjësi shoqërohet me respektimin e të gjitha standardeve të BQK-së për manaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, duke përfshirë këtu edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për rakordime dhe monitorime të transaksioneve;
- përshtatshmëria me kërkesat rregullatore dhe ligjore;
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për administrimin e këtij rreziku;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operative dhe propozimit të veprimeve korrigjuese;
- zhvillimin e planeve kontingjente;
- trajnimin dhe zhvillimin profesional;
- standardet etike dhe të mirësjelljes; dhe
- shmangien e rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin kur kjo është efektive.

Përshtatshmëria me standardet e BQK-së mbështetet nga një program vlerësimesh periodike të ndërmarra nga Auditimi i brendshëm. Gjetjet e vlerësimeve të Auditimit të brendshëm diskutohen me menaxherët e njësisë organizative me të cilat ato janë të lidhura dhe konkluzionet i dërgohen Komitetit të auditimit dhe menaxhmentit të BQK-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (në vazhdim)

f) Menaxhimi i Kapitalit

Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, aprovuar më datë 22 Korrik 2010 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përcakton kërkesat e kapitalit të BQK-së. Sipas këtij ligji, kapitali i autorizuar i BQK-së është 30 milionë Euro. Kapitali mund të rritet me shuma të tilla siç propozohet nga BQK dhe aprovohet nga Qeveria. Asnjë reduktim i kapitalit të BQK nuk do të lejohet në asnjë kohë.

Sipas ligjit nr.03/L-209, e ardhura neto ose humbja neto e BQK llogaritet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

E ardhura neto shpërndahet çdo vit në rezervën të përgjithshme derisa shuma totale e kapitalit fillestar dhe rezervat e përgjithshme barazohen me pesë për qind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore.

Pjesa prej 50% e balancës neto e të ardhurave të realizuara që mbeten pas përmbushjes së kriterit të 5% të përmendur më lart, duhet t'i transferohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financës. Ndërsa 50% që mbetet nga e ardhura e realizuar duhet t'i alokohet llogarisë së rezervës së përgjithshme të BQK.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti i BQK-së diskuton me Bordin e BQK-së zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të BQK-së, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shënimi 4).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Fonde të lejuara për humbje nga rreziku kreditor

Aktivitetet e regjistruara me kosto të amortizuara vlerësohen për të identifikuar rënie në vlerë të aktivitetit, në bazë të politikave të përshkruara në 3(f)(vi). Përbërësi specifik në totalin e provizioneve për rënie në vlerë të aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, bazohet në vlerësimin më të mirë të rrjedhjeve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave menaxhmenti i BQK-së gjykon mbi situatën financiare të palës në transaksion dhe vlerës neto të realizueshme të çdo kolaterali përcaktues. Çdo aktiv me rënie në vlerë, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e rrjedhjeve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavarur nga menaxhmenti.

Gjykime kritike kontabël në aplikimin e politikave kontabël të BQK-së

Gjykimet kritike kontabël të kryera gjatë aplikimit të politikave kontabël të BQK-së përfshijnë:

Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Politikat kontabël të BQK-së krijojnë mundësinë që aktivitetet dhe detyrimet të vendosen që në fillim në kategori të ndryshme kontabël sipas rrethanave të caktuara.

Në klasifikimin e aktiveve si të mbajtura deri në maturim, BQK-ja ka treguar se ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë për t'i mbajtur aktivitetet deri në datën e maturimit, siç kërkohet nga politikat kontabël 3 (h).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

6. Aktivët dhe detyrimet financiare (Klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta)

Tabela më poshtë paraqet klasifikimin për çdo klasë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të BQK-së, si dhe vlerat e drejta të tyre.

<i>Në mijë Euro</i>	Shënimi	Kredi dhe llogari të arkëtueshme	Të mbajtura deri në maturim	Të tjera me kosto të amortizuar	Vlera totale e mbartur	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2010						
Paraja e gatshme	7	60,194	-	-	60,194	60,194
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	25,621	-	-	25,621	25,621
Bono thesari	9	-	199,275	-	199,275	198,490
Depozita me bankat e huaja	10	807,332	-	-	807,332	807,332
Aktive me FMN	11	154,554	-	-	154,554	154,554
		1,047,701	199,275	-	1,246,976	1,246,191
Detyrime ndaj bankave vendase	15	-	-	203,572	203,572	203,572
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	-	-	153,868	153,868	153,868
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	-	-	798,721	798,721	798,721
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	-	-	43,228	43,228	43,228
Detyrime të tjera vendase	19	-	-	2,419	2,419	2,419
		-	-	1,201,808	1,201,808	1,201,808
31 dhjetor 2009						
Paraja e gatshme	7	21,806	-	-	21,806	21,806
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	34,899	-	-	34,899	34,899
Bono thesari	9	-	529,652	-	529,652	529,275
Depozita me bankat e huaja	10	487,529	-	-	487,529	487,529
Aktive me FMN		124,482	-	-	124,482	124,482
		668,716	529,652	-	1,198,368	1,197,991
Detyrime ndaj bankave vendase	15	-	-	233,246	233,246	233,246
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	-	-	124,786	124,786	124,786
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	-	-	665,187	665,187	665,187
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	-	-	130,847	130,847	130,847
Detyrime të tjera vendase	19	-	-	1,745	1,745	1,745
		-	-	1,155,811	1,155,811	1,155,811

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

7. Paraja e gatshme

Paraja e gatshme shprehet e gjitha në Euro.

8. Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja

Këto llogari mbahen në bankat e mëposhtme:

	2010	2009
Deutsche Bundesbank	25,068	34,369
Raiffeisen Zentralbank	234	145
Commerzbank	315	381
Banque de France	4	4
Gjithsej	25,621	34,899

Të gjitha këto kanë një vlerësim kreditor prej dhe mbi A-1/P-1 për vitin 2010, sipas vlerësimit të bërë në vitin më 31 dhjetor 2010 (vlerësimet sipas Standard & Poors/Moody's).

9. Bono thesari

Bonot e thesarit janë letra të borxhit qeveritar nga vendet e Bashkimit Europian. Ato kanë maturitet deri në dymbëdhjetë muaj dhe janë për t'u mbajtur deri në maturim. Të gjitha bonot janë në Euro dhe kanë norma efektive interesi nga 0.141% deri në 1.346% (2009: 0.199% deri në 1.490%)

Bonot e thesarit lëshohen nga qeveritë e vendeve të Bashkimit Europian si më poshtë:

	2010	2009
Gjermani	-	99,924
Francë	-	164,952
Holandë	-	99,929
Itali	84,613	-
Portugali	34,787	-
Belgjikë	79,875	164,847
Gjithsej	199,275	529,652

BQK-ja investon në bono thesari me një vlerësim minimal kreditor A-2 / P-2 (vlerësimet sipas Standard & Poor's / Moody's).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)

9. Bono thesari (në vazhdim)

Bonot e thesarit më 31 dhjetor 2010 përfshijnë një vlerë prej 84,692 mijë Euro (2009: EUR zero) e cila përfaqëson bono thesari të blera prej BQK-së për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të firmosur me Ministrinë, BQK-ja luan rolin e një menaxheri të investimeve për fondet e Ministrisë. Në janar 2010 palët kanë bërë disa ndryshime në Memorandumin e Mirëkuptimit, neni III – *Alokimi i rrezikut*. Bazuar në këtë ndryshim për investimet që kryhen sipas Memorandumit të Mirëkuptimit, të cilat janë në përputhje me dispozitat për menaxhimin e rrezikut sipas Politikës së Investimeve të BQK-së, rreziqet përkatëse do të mbarten nga BQK dhe këto investime do të rregjistrohen në llogaritë e BQK-së. Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit, BQK gjithashtu merr përsipër përgjegjësinë për funksionimin e duhur të Drejtoratit të menaxhimit të mjeteve si njësi e BQK-së, si dhe blerjen në kohë, shlyerjen, pagesën dhe regjistrimin kontabël për të gjitha shumat e investuara të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

10. Depozita me bankat huaja

Depozitat me bankat huaja janë të përbëra si më poshtë:

	2010	2009
Depozita me afat		
Raiffeisen Zentralbank	94,600	56,500
ING Bank	150,088	-
KBC	20,003	48,835
Rabobank	136,064	10,003
Danske Bank	97,392	87,097
Commerzbank	53,800	4,100
Banque de France	144,387	150,824
Banque Centrale du Luxembourg	110,379	130,057
	806,713	487,416
Interesi i përlogaritur në depozitat me afat		
Raiffeisen Zentralbank	35	-
ING Bank	132	-
KBC	1	52
Rabobank	358	-
Danske Bank	2	2
Commerzbank	58	-
Banque de France	14	31
Banque Centrale du Luxembourg	19	28
	619	113
Gjithsej	807,332	487,529

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)

10. Depozita me bankat huaja (në vazhdim)

Depozitat e vendosura me bankat e huaja janë të përcaktuara në Euro dhe fitojnë interes me normë efektive që varion nga 0.10% deri në 1.20% (2009: 0.05% - 2.05%) si dhe kanë maturitet fillestar nga 1 në 366 ditë (2009: nga 1 në 186 ditë). Të gjitha depozitat kanë një vlerësim kreditor prej A-1/P-1, sipas vlerësimit të bërë në vitin 2010 (vlerësimet sipas Standard & Poor's/Moody's).

11. Aktive me FMN

	2010	2009
Kuota e FMN-së	68,420	64,205
Titujt DVT	63,993	60,253
Interesi i përlogaritur	48	24
FMN	132,461	124,482
Qeveria		
Kërkesa ndaj qeverisë lidhur me shfrytëzimin e fondeve të FMN-së (SBA)	22,093	-
Gjithsej	154,554	124,482

Aktivitet e listuara më sipër lidhen me pranimin e Kosovës në FMN në qershor 2009. Në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në FMN, BQK-ja vepron si depozitar dhe agjent fiskal. Kjo është në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin nr. 03/L-152 për Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Kuota në FMN përfaqëson kuotën e regjistrimit që është përcaktuar në bazë të rregullave të FMN-së në kohën e pranimin dhe është e shprehur në DVT.

Titujt DVT përfaqësojnë aktive të aprovuara nga Bordi i guvernatorëve të FMN-së sipas alokimeve DVT ndaj vendeve anëtare të FMN-së (vendime marrë më 28 gusht 2009 dhe 9 shtator 2009). Aktivitet DVT përmbajnë norma vjetore të interesit të cilat variojnë nga 0.25% deri në 0.36% (2009: 0.22% - 0.31%).

